




**Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut
nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit
Bashkia Fier**



➤ **Grupi i punës Bashkia Fier**

1. Andius Olldashi - Zëvendës Kryetar i Bashkisë
2. Nasip Bani - Drejtor i Mbrojtjes Civile
3. Ladimir Mecani - SNL Mbrojtja Civile
4. Drinald Memushi- SNL Mbrojtja Civile
5. Gramoz Binjaku- SNL Mbrojtja Civile
6. Fation Myrto- SNL Mbrojtja Civile
7. Julian Pocaç - Drejtor i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit;
8. Arben Dimo- Drejtor i Policisë Bashkiake
9. Agim Hoxha - Drejtor i Drejtorisë për Kontrollin dhe Ruajtjen e Pronës
10. Ludovik Tare - Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike
11. Arjan Ndreu - Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike
12. Fation Elezi - Drejtor i Ndërmarrjes së Pastrimit
13. Emiliano Skënda - Drejtor i Ndërmarrjes së Gjellbërimit dhe Shërbimit të Varrimit;
14. Entela Kola - Drejtor i Ndërmarrjes së Pastrimit të Kanaleve Kulluese dhe Vaditëse
15. Tarion Rexho - Drejtor i MZSH
16. Sokol Hoxha - Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sistemit të Adresave
17. Esmeralda Kapllanaj - Drejtor i Drejtorisë Juridike
18. Ferrik Avdiaj - Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së tokës Bujqësore dhe Veterinarisë
19. Pëllumb Llakaj - Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Fondit Pyjor, Kullotave dhe Mbrojtjes së Mjedisit
20. Rozeta Memo - Drejtore e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
21. Haxhi Avdullai - Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Projekteve dhe Infrastrukturës
22. Erinda Jovani - Drejtor i Drejtorisë së Integritimit Evropian, Hartimit të projekteve për Investimet e Huaja dhe Diasporës
23. Silvana Basha - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Kontrollit të Punëve Publike dhe Investimeve
24. Pranvera Cina - Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit
25. Albion Behari - Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Pronave
26. Bilbil Cela - Kryetar i Nj.A. nr. 1
27. Aduart Sollaku - Kryetar i Nj.A. nr. 2

28. Erson Goga - Kryetar i Nj.A. nr. 3
29. Ermelinda Çepele - - Kryetare e Nj.A. nr. 4
30. Ferdinand Korcari - Kryetar Nj.A. Cakran
31. Dashnor Troka - Kryetar Nj.A. Frakull
32. Ahmet Bahaj - Kryetar Nj.A. Levan
33. Eraldi Qirjo - Kryetar Nj.A. Qëndër
34. Shpëtim Gremi - Kryetar Nj.A. Mbrostar
35. Pandeli Bozhaj - Kryetar Nj.A. Portëz
36. Kadri Fasko - Kryetar Nj.A. Dërmenas
37. Themie Doko - Kryetar Nj.A. Libofshë
38. Aleksandër Kola - Kryetar Nj.A. Topojë

➤ **Grupi i punës METROPOLIS SH.P.K & Co-PLAN**

39. Prof. Emeritus Pantoleon D. Skayannis
40. Dr. Ledio Allkja
41. MSc. Erni Kocani
42. MSc. Imeldi Sokoli 43. MSc. Rea Muka
44. MSc. Greta Shehu
45. Dr. Kejt Dhrami
46. Dr. Fiona Imami
47. Dr. Merita Toska

➤ **Grupi i Punës UNDP**

48. Elvita Kabashi – Specialiste Programi, Drejtuese e Departamentit të Mjedisit, Energjisë dhe Klimës të UNDP në Shqipëri
49. Doreid Petoshati- Koordinator Kombëtar i Projektit RESEAL të UNDP në Shqipëri
50. Maksimiljan Dhima- Konsulent Kombëtar i Projektit RESEAL të UNDP në Shqipëri

➤ **Grupi i punës AKMC**

51. Haki Cako- Drejtori i Përgjithshëm
52. Adisa Bala- Drejtor i Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit
53. Megi Zaganjori- Përgjegjës Sektori, Drejtorja e Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit
54. Andi Pogaci, Specialist, Drejtorja e Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit
55. Ambra Fusha, Specialist, Drejtorja e Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit
56. Anxhela Arapi Specialist, Drejtorja e Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit

Falënderime

Ekipi i konsulentëve shpreh mirënjohje dhe falënderime për Kryetarin e Bashkisë Fier, z. Armando Subashi, i cili ka qenë personalisht i angazhuar në procesin e hartimit të dokumentit duke dhënë drejtimin strategjik lidhur me prioritetet e bashkisë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Falënderojmë gjithashtu Zëvendës Kryetarin e Bashkisë, Drejtorin e Mbrojtjes Civile si dhe të gjithë anëtarët e grupit të punës të cilët kanë kontribuar në mënyrë aktive në përcaktimin e vizionit, objektiveve strategjike dhe aktiviteteteve kryesore të cilat do të drejtojnë vendimmarrjen në sektorin e mbrojtjes civile për 5 vitet e ardhshme në Bashkinë e Fierit.

Një falënderim i veçantë shkon edhe për grupin e punës i cili zbaton projektin “Forcimi i Aftësive Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL”, UNDP dhe përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të cilët kanë bërë të mundur një bashkërendim shumë të mirë të aktorëve të përfshirë në procesin e hartimit të strategjisë si dhe kanë mbështetur procesin në të gjitha hapat e tij duke kontribuar me ekspertizën dhe njohuritë e tyre në fushën e mbrojtjes civile.

Ky material u përgatit nga Bashkia Fier me mbështetjen teknike të METROPOLIS SH.P.K & Co-PLAN,
Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Projekti ‘Hartimi i Planeve Strategjike për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Bashkitë e Qarkut Fier’ financohet nga UNDP në kuadër të projektit: “Forcimi i aftësive ripërtëritëse në Shqipëri” RESEAL dhe mbështetet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Projekti RESEAL financohet nga Qeveria Suedeze dhe ajo Portugeze. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument i përkasin autorëve realizues dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit”.

Mbështetur nga: Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri _ Projekti RESEAL, UNDP në Shqipëri



Shënim: Ky dokument është pronësi intelektuale e Bashkisë Fier dhe përdorimi i të dhënave në përmbajtje të këtij dokumenti duhet të kryhet gjithnjë duke cituar burimin e informacionit dhe vendosur referencat përkatëse.

PËRMBAJTJA

Lista e figurave	6
Lista e grafikëve.....	6
Lista e tabelave	6
Lista e shkurtimeve	7
1. Hyrje	9
1.1 Korniza Institucionale dhe Ligjore	11
1.2 Procesi për përgatitjen e strategjisë.....	12
1.3 Dokumente Strategjike në nivel Kombëtar dhe Lokal.....	13
2. Konteksti i bashkisë për ZRF.....	17
2.1 Vlerësimi i riskut.....	17
2.2 Risku nga Përmbytjet	21
2.3 Vija Bregdetare	21
Risku nga Rrëshqitjet	22
Risku nga Zjarret në Pyje.....	23
Risku Sizmik	24
Risku Teknologjik.....	25
Risku Biologjik	26
2.4 Kapacitetet financiare të bashkisë.....	27
2.5 Donatorë, projekte, programe dhe mundësi të tjera financimi.....	31
3. Vizioni, qëllimi dhe objektivat strategjike.....	33
3.1 Vizioni.....	33
3.2 Misioni	33
4. Projektet strategjike dhe masat	34
5. Plani i veprimit dhe hapësira financiare.....	50
6. Zbatimi i strategjisë.....	63
7. Monitorimi	63
8. Referenca	65
9. Anekse.....	66

Aneks 1 – Projekte të ekstraktuara nga plane dhe strategji kombëtare dhe sektoriale	66
Aneks 2 – Minutat e takimeve të realizuara me kryetarët e 6 bashkive të Qarkut Fier	69
Aneks 3 – Minutat e takimeve të zhvilluara me grupin e punës në bashki.....	74
Aneks 4 – Pyetësor për validimin e të dhënave në bashki	80
Aneks 5- Kuadri- Ligjor.....	85
Aneks 6- Kuadri Institucional	89

Lista e figurave

Figura 1: Sistemet territoriale të Bashkisë Fier.....	19
Figura 2: Paraqitje grafike e projekteve strategjike për OS1	38
Figura 3: Paraqitje grafike e projekteve strategjike për OS2	41
Figura 4: Paraqitje grafike e projekteve strategjike për OS3	49

Lista e grafikëve

Grafiku: 1 Niveli i riskut për bashkinë Fier.....	23
Grafiku: 2 Niveli i riskut nga Përmytjet	25
Grafiku: 3 Niveli i riskut nga Rrëshqitjet	26
Grafiku: 4 Niveli i riskut nga Zjarret në Pyje.....	27
Grafiku: 5 Niveli i riskut Sizmik	28
Grafiku: 6 Niveli i riskut Teknologjik.....	29
Grafiku: 7 Niveli i riskut Biologjik	30
Grafiku: 8 Ecuria e të ardhurave totale.....	32
Grafiku: 9 Përdorimi i burimeve financiare.....	33
Grafiku: 10 Shpenzimet sipas funksioneve	33
Grafiku: 11 Transferta e kushtëzuar nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” (viti 2022)	36

Lista e tabelave

Tabela 1: Shpërndaja e ndërtesave sipas periudhës së ndërtimit për çdo njësi administrative.....	17
Tabela 2: Shpërndarja e humbjeve mesatare vjetore	20

Lista e shkurttimeve

AAL-BD - Average Annual Loss - Bashkia Divjakë (Humbjet mesatare vjetore)
AAL-QF - Average Annual Loss - Qarku Fier (Humbjet mesatare vjetore)
AKBN - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKMC - Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AMBU - Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ASIG - Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
BB - Banka Botërore
BE - Bashkimi Evropian
BKU - Banesa me Kosto të Ulët
BSQ - Programi i Banesave Sociale me Qira
EVCA - Vlerësimi i cënueshmërisë dhe kapaciteteve
FAU - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
FGJM - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave
FIN - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
FSHZH - Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FTI - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
GES - Gaze të efektit serrë
GIS - Sistemi i Informacionit Gjeografik
IADSA - Programi i Shkëmbimit të Borxhit Italo-Shqiptar për Zhvillim (Italian-Albanian Debt for Development Swap Programme)
IAP - Ionian Adriatic Pipeline (Gazsjellësi Jon Adriatik)
IPA - Instrument for Pre-accession Assistance (Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit)
IGJEO - Instituti i Gjeoshkencave
ISHTI - Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
JICA - Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (Japan International Cooperation Agency)
KKSh - Kryqi i Kuq Shqiptar
KMC - Komiteti i Mbrojtjes Civile
MAS - Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB - Ministria e Brendshme
MBZhR - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MC - Mbrojtje Civile
MFE - Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
ML - Ministrinë e linjës
MMC BE - Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së
MM - Ministria e Mbrojtjes
MRF - Menaxhimi i risqeve nga fatkeqësitë
MShMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

NbS - Zgjidhje me bazë natyrën/Nature-Based Solutions
NDC - National Determined Contribution (Kontributi i Dakordësuar Kombëtar)
NjA - Njësi Administrative
OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara
OS - Objektiv Strategjik

7

OSHC - Organizata të Shoqërisë Civile
PBB - Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKEC - Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
PNUD - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PPK - Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Zhvillimit të Territorit
PPKB - Programi i Përmirësimit të Kushteve të Banimit
PPV - Plani i Përgjithshëm Vendor
QKKSH - Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit
SB - Strategjia Bashkëkohore
SFDRR - Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive
SHGJSH - Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
ShMZSh - Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit
ShUM - Shërbimi i Urgjencës Mjekësore
SKZRF - Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SKZHIE - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European
SVZRF - Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SZRF - Strategjia për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
TAP - Trans Adriatic Pipeline (Gazsjellësi Trans Adriatik)
UPT - Universiteti Politeknik i Tiranës
UNFCCC - Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave
VRF - Vlerësimi Riskut nga Fatkeqësitë
VSM - Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZRF - Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive

8

1. Hyrje

Rajoni i Mesdheut për shkak edhe të tipologjisë së tij është një rajon i cili konsiderohet si shumë i cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Për shkak të përqendrimit të aktivitetit njerëzor rajoni ka pësuar ndryshime të shumta duke akomoduar një popullsi totale prej rreth 500 milion njerëzish të cilët janë përqendruar kryesisht në vendbanime urbane në afërsi të bregdetit¹. Ky rajon vlerësohet i cenueshëm kryesisht nga mungesa e ujit, thatësitrat, rritja e temperaturave, rritja e nivelit të deteve, erozioni bregdetar, përmbytjet, zjarret të cilat me gjasë do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik e social të vendeve mesdhetare.

Shqipëria, si një prej vendeve të rajonit të Mesdheut, pozicionohet në Ballkanin Perëndimor dhe referuar Indeksit të Riskut Botëror (World Risk Index 2023), për shkak të tërmetejeve, cunamit, përmbytjeve bregdetare dhe të lumenjve, cikloneve, thatësirave dhe rritjes së nivelit të detit për të 193 vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara, bazuar në ekspozimin dhe cenueshmërinë (ndjeshmërinë dhe kapacitetet përshtatëse), Shqipëria ka një indeks risku “të lartë”- dhe renditet e 6-ta në Evropë dhe e 76-ta në botë. Skenarët e ardhshëm klimatikë për Shqipërinë parashikojnë ndryshime, si prirjet në rritje të temperaturave vjetore dhe sezonale, si në vlera minimale ashtu edhe maksimale, ulje të reshjeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme. Sipas Komunikatës së Tretë Kombëtare (NCC) të Konventës Kuadër së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), deri në verën e vitit 2050, zona bregdetare nuk ka gjasa të përjetojë temperatura mesatare nën 25°C; Deri në vitin 2100, temperatura mesatare deri në 30°C pritet të dominojnë të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, të gjithë skenarët parashikojnë një ulje të mundshme të reshjeve sezonale në të gjitha stinët krahasuar me vlerat e vitit 1990.

Në këtë drejtim për të mbështetur Qeverinë Shqiptare, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri po zbaton projektin Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri, RESEAL, i cili synon të forcojë sistemin ZRF të Shqipërisë dhe të mbështesë përpjekjet e vendit për t'u bërë një anëtar i plotë i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së. Përveç kësaj, ky projekt do të mbështesë zhvillimin e kornizës së zvogëlimit të riskut të fatkeqësive (ZRF) në nivel bashkiak, në përputhje me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SFDRR).

Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030 u miratua në Konferencën e tretë Botërore të KB në Sendai, Japoni, më 18 Mars 2015. Kuadri Sendai artikulon nevojën për të kuptuar më mirë riskun nga fatkeqësitë në të gjitha dimensionet si ekspozimi, ndjeshmëria dhe karakteristikat e rrezikut. Gjithashtu advokon për forcimin e qeverisjes duke përfshirë platformat kombëtare si dhe rritjen e përgjegjësisë për menaxhimin e gatishmërinë për të "Ndërtuar më mirë" pas një fatkeqësie.

Kuadri Sendai propozon 4 prioritete përsa i përket ZRF:

¹ Cross-Chapter Paper Leads: Mediterranean Region. IPCC Sixth Assessment Report

- Prioriteti 1: Kuptimi i riskut të fatkeqësisë. o Prioriteti 2: Forcimi i qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të menaxhuar riskun.
- Prioriteti 3: Investimi në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive për të rritur aftësinë ripërtëritëse.
- Prioriteti 4: Rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive për përgjigje efektive dhe për të "Rindërtuar më mirë" në rimëkëmbje, rehabilitim dhe rindërtim.

Me qëllim marrjen e masave parandaluese për ti bërë ballë ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, Qeveria Shqiptare në vitin 2023 miratoi draftin përfundimtar të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë për periudhën 2023-2030 (Strategjia Kombëtare

ZRF), një dokument thelbësor për sektorin e Mbrojtjes Civile, i cili do të shërbejë si udhërrëfyes për

vendimmarrësit por edhe që bashkitë të hartojnë Plane Strategjike për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare ZRF është të orientojë aktivitetet dhe investimet e ardhshme për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në mënyrë gjithëpërfshirëse e ndër-sektoriale. Gjithashtu për të identifikuar rreziqet është kryer një analizë e cila ka vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të cilat mund të vijnë për shkaqe natyrore por edhe ato të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor të cilat janë pasqyruar në dokumentin, Vlerësimi Kombëtar i Riskut 2022.

Me miratimin e ligjit 45/2019 ‘Për Mbrojtjen Civile’ dhe krijimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në vitin 2019, ka pasur edhe një ndryshim në qasje lidhur me menaxhimin e emergjencave nga ana e Qeverisë Shqiptare duke kaluar nga menaxhimi i fatkeqësive tek marrja e masave për parandalimin e tyre. Për të zbatuar këtë qasje dhe marrë masa për parandalimin, përgatitjen, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë autoritetet vendore kanë një rol kryesor në këtë proces.

Bashkitë janë institucionet e para që qytetarët i drejtohen në rast fatkeqësie kjo për faktin se janë ato që ofrojnë shërbime bazë për qytetarët dhe janë më të lidhura me komunitetet lokale. Ndër vite, Bashkitë nuk kanë qenë të përgatitura, si teknikisht ashtu edhe financiarisht, për tu përballuar me fatkeqësitë dhe aq më pak për të hartuar programe apo plane për të parandaluar apo minimizuar ndikimin që këto fatkeqësi kanë në komunitet. Nga ana tjetër, ka pasur një mungesë të përgjithshme të të kuptuarit të politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel lokal, duke rezultuar në zhvillim të painformuar nga perspektiva e riskut nga fatkeqësitë.

Qarku i Fierit e veçanërisht Bashkia Fier për shkak edhe të pozicionit të saj në ultësirën perëndimore të vendit si dhe burimeve ujore të cilat e përshkojnë, Lumi Seman dhe Vjosa, ndër më të mëdhenjtë në vend konsiderohet si një Bashki e ekspozuar ndaj rrezikut nga fatkeqësitë natyrore. Në Komunikimin e Katërt Kombëtar për Ndryshimet Klimatike për UNFCCC, parashikohet një rritje e nivelit të detit me 27 cm deri në 2050 dhe deri në 80 cm në 2100, referuar skenarit më të keq të projekteve të bëra. Gjithashtu parashikohet se për shkak të pozicionit të saj gjeografik dhe faktit që përshkohet nga baseni i Lumit të Vjosës, Bashkia e Fierit dhe ajo e Vlorës kanë riskun më të lartë nga përmbytjet.

Referuar Raportit të Vlerësimit të Riskut në Shkallë Vendore, i hartuar nga Bashkia Fier me mbështetjen e projektit RESEAL, evidentohet se të gjashta risqet vlerësohen me shkallë të lartë ndikimi, ku në shkallën e vlerësimit 9 (ekstrem) vlerësohet risku sizmik ndërsa 5 risqet e tjera vlerësohen me 8 (i lartë), të cilat paraqiten në mënyrë grafike më poshtë. Këto vlerësime tregojnë edhe një herë kompleksitetin e problematikës dhe nevojën për një bashkëpunim ndër-sektorial, ndër-institucional dhe ndër-bashkiak duke qenë se fatkeqësitë nuk njohin kufij territorial dhe veprimet apo mosveprimet e një bashkie/komuniteti mund të ndikojnë në bashkinë kufitare.

Për këtë arsye është e nevojshme që bashkitë të marrin hapa konkret për parandalimin e riskut duke qenë në përputhje me ligjin, nr. 45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile” dhe Strategjinë ZRF duke vijuar me hartimin e Strategjive vendore për ZRF të cilat janë hapi i parë i adresimit të problematikës në mënyrë institucionale. Strategjia vendore për ZRF është mjete gjithëpërfshirës i planifikimit strategjik bashkiak që përcakton qëllimet dhe objektivat e përgjithshme në periudha të ndryshme kohore, duke marrë në konsideratë periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, e duke përqafuar njëkohësisht një perspektivë afatgjatë. Ky dokument synon të parandalojë risqet e reja dhe të zvogëlojë risqet ekzistuese, të ofrojë alternativa për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë dhe të forcojë aftësinë ripërtëritëse ekonomike, sociale, shëndetësore dhe mjedisore të banorëve. Strategjia ndërtohet mbi kontekstin lokal dhe profilin e riskut, duke përcaktuar qëllimet e përgjithshme, objektivat, parimet, udhëzimet, prioritetet për veprim, kostot dhe afatin kohor përkatës.

Ky dokument do ti lejoj bashkisë të hartoj edhe Planet Vendore për ZRF si dhe koordinojë nevojën për investime e rritje kapacitetesh në këtë sektor për të siguruar jetën e qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bashkisë.

1.1 Korniza Institucionale dhe Ligjore

Vitet e fundit Shqipëria ka përditësuar dhe miratuar kornizën ligjore dhe institucionale që adreson çështjet e mbrojtjes civile, duke i dhënë një theks të veçantë vlerësimit dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë. Përgatitja dhe miratimi i kësaj kornize ligjore dhe institucionale është kryer në kuadër të proceseve të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Për ngritjen e kësaj pakete është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse me qëllim ngritjen dhe përforcimin e kapaciteteve të strukturave institucionale përkatëse.

Ligji bazë është Ligji nr. 45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, i cili ka vënë në zbatim pjesërisht edhe disa Direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian që kanë të bëjnë me mbrojtjen civile dhe vlerësimin e zvogëlimin e riskut të fatkeqësive sikurse janë:

Direktiva e Këshillit 2008/ 114/KE, datë 8.12.2008, “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre”. Numri CELEX 32008L0114, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 345/75, datë 23.12.2008, faqe 75-82.

Direktiva 2007/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23.10.2007, “Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmytjeve”, numri CELEX 32007L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 288/27, datë 6.11.2007, faqe 27-34.

Direktiva 2012/18/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 4.7.2012, “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, që ndryshon dhe më pas shfuqizon direktivën e Këshillit 96/82/KE. Numri CELEX 32012L0018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 197/1, datë 24.7.2012, faqe 1-37.

Direktiva 2002/22/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 7.3.2002, “Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike” e ndryshuar, (Direktiva e Shërbimit Universal), numri CELEX 32002L0022, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 108, datë 24.4.2002, faqe 51-77.

Vendimi nr. 1313/2013/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013, “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian”, i ndryshuar. Numri CELEX 3213D1313, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, tat- 20.12.2013, faqe 924-947.

Vendimi zbatues i Komisionit 2014/762/BE, datë 16.10.2014, që përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr. 1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian” dhe që shfuqizon vendimet e Komisionit 2004.277/KE, Euroatom dhe 2007/606/KE, Euroatom:, i ndryshuar. Numri CELEX 32014Do762, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 320, datë 6.11.2014, faqe 1-45.

Kjo kornizë ligjore përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve (qendrore dhe vendore), subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve në tërësi, përsa i përket çështjeve të vlerësimin dhe zvogëlimi të riskut të fatkeqësive.

Gjithashtu, për përgatitjen e strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë janë marrë në konsideratë edhe ligje apo akte nënligjore të cilat adresojnë në mënyrë direkte apo indirekte çështje që lidhen me mbrojtjen civile. Në këtë kornizë ligjore përcaktohen institucionet dhe strukturat vendore përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes civile, të cilat janë prefekti i qarkut, komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkitë. Brenda ligjit gjithashtu nënvizohen edhe detyrimet përkatëse të këtyre strukturave institucionale. Ligji thekson që bashkitë kanë detyrimin

për hartimin dhe miratimin e dokumentit të vlerësimit të riskut të fatkeqësive, strategjisë të zvogëlimit të riskut dhe të planit për emergjencat civile.

1.2 Procesi për përgatitjen e strategjisë

Me qëllim për tu njohur mirë me profilin e bashkisë Fier dhe ekspozimin e cenueshmërinë e saj ndaj fatkeqësive natyrore ekspertët e angazhuar zhvilluan një punë përgatitore duke u konsultuar fillimisht me raportet e Vlerësimit të Riskut të hartuar për këtë bashki në kuadër të projektit RESEAL, dokumente të cilat kanë qenë edhe baza kryesore e të dhënave për profilin e bashkisë, ekspozimin ndaj fatkeqësive, periodicitetin e tyre dhe projeksionet mbi efektet socio-ekonomike e mjedisore që kjo bashki do të përballej në rast fatkeqësie. Për të bërë të mundur dakordësimin mbi të dhënat referencë që do të përdreshin për hartimin e Strategjisë, ekspertët e angazhuar, përdorën dy mënyra: zhvillimin e takimeve me persona kyç në bashki dhe plotësimin e pyetësorëve për përfitim të të dhënave (pyetësori gjendet në Aneks 4), të cilat në përfundim të procesit ju paraqitën grupit të punës në bashki në formën e një raporti përmbledhës.

Si një hap i dytë tepër i rëndësishëm për procesin e hartimit të Strategjive Vendore për ZRF për Qarkun e Fierit një takim në nivel drejtuesish, ndërmjet kryetarëve të 6 bashkive (minutat e takimit gjenden në Aneks 2) në prezencën edhe të Prefektit të Qarkut Fier, u zhvillua me qëllim nisjen e një procesi gjithëpërfshirës e ndër-bashkiak si dhe ndërgjegjësimin për nevojën e marrjes së masave strategjike në nivel vendor por edhe rajonal. Ky takim shërbeu gjithashtu për të marrë mbështetjen e kryetarëve të bashkive të cilët shprehën vullnetin e tyre për të çuar përpara këtë proces tepër të nevojshëm për një territor i cili historikisht është i ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore.

Gjatë takimeve të zhvilluara u pa nevoja e përditësimit të grupit të punës për shkak të lëvizjeve të stafit por edhe nevojës për të përfshirë sektorë të tjerë në bashki, dhe përtej saj, të cilët janë tepër vendimtar në procesin e marrjes së masave për parandalimin e riskut. Më pas procesi vijoi me disa takime të tjera ndërmjet ekspertëve të përfshirë në projekt dhe stafit të bashkisë të cilët kanë zhvilluar takime të përbashkëta për të koordinuar punën por edhe individuale me sektorë të ndryshëm për tu ndalur specifikisht tek problematika të tilla si përmytjet, zjarret apo përparimi i detit në zonën perëndimore të bashkisë. Takimet dhe konsultimet (minutat e takimit gjenden në Aneks 3) ishin tepër të vlefshme pasi lejuan hartimin e objektivave strategjike dhe aktivitetëve të cilat synojnë ndërmarrjen e veprimeve konkrete për parandalimin e riskut nga fatkeqësitë.

Pjesë e aktivitetëve të zhvilluara ishte edhe zhvillimi i një trajnimi për përfaqësuesit e 61 bashkive të vendit ku u trajtuan dy tema kryesore: a) procesi i hartimit të Strategjive Vendore ZRF, proces ky i cili është i detyruar për të gjitha bashkitë e vendit; si dhe b) hartimi i projekt propozimeve si një mënyrë për të thithur fonde nga institucionet vendore por edhe ato të huaja. Ky i fundit është një hap shumë i rëndësishëm duke marrë në konsideratë se buxheti i bashkisë nuk mund të përballojë financiarisht zbatimin e plotë të Strategjisë Vendore.

Një hap tjetër i rëndësishëm i cili shërbeu për të konsoliduar punën e kryer ishte edhe zhvillimi i një takimi me kryetarët e të 6 bashkive (minutat e takimit gjenden në Aneks 2), me qëllim ilustrimin e vizionit, objektivave, aktiviteteve kryesore me fokus ato ndër-bashkiake dhe theksimin e nevojës për bashkëpunim dhe angazhim nga të gjithë aktorët për të marrë masa paraprake për parandalimin e fatkeqësive natyrore pasi ato nuk njohin kufij territorialë. Përfshirja aktivekryetarëve të bashkive dhe Prefektit të Qarkut duhet evidentuar si një vlerë e shtuar në këtë proces pasi tregon vullnetin e tyre për të ndryshuar qasjen në raport me masat dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive natyrore.

Pas konsolidimit të dokumentit të Strategjisë Vendore ZRF dhe dakordësimit ndërmjet grupit të punës, ekspertëve të përfshirë, AKMC dhe UNDP mbi të dhënat e objektivat e paraqitur në dokumentin procesi ndoqi procedurat e konsultimit publik dhe prezantimin në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Fier.

1.3 Dokumente Strategjike në nivel Kombëtar dhe Lokal

Duke iu referuar ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 12, dokumenti i Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, qoftë në nivel kombëtar qoftë në nivel vendor, ka prioritet ndaj strategjive apo planeve të tjera. Në fjalë të tjera, çdo dokument tjetër, në nivel qendror dhe vendor, duhet të jetë i harmonizuar me SZRF. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të kuptojmë dhe të evidentojmë këto dokumente që janë relevante për ZRF. Gjithashtu, SZRF vendore duhet të jetë në linjë me SZRF kombëtare për të siguruar një kohezion të mirë ndër-institucional dhe ndër-sektorial, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 (SKZRF) – është dokumenti kryesor në sektorin e mbrojtjes civile me anë të të cilit do të orientohen aktivitetet dhe investimet e ardhshme të Shqipërisë për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke përfshirë parapërgatitjen, përgjigjen, rimëkëmbjen dhe planifikimin e zhvillimit. Strategjia vendos disa objektiva strategjike të cilët do të lejojnë më pas edhe zbatimin e saj të fokusuar në 5 elementë kryesorë: a) menaxhimi i risqeve ekzistuese dhe parandalimi i risqeve të rinj; b) rritja e ndërgjegjësimit, njohurive dhe shkëmbimit të informacionit lidhur me Menaxhimin e Riskut nga Fatkeqësitë (MRF) dhe MC me një vëmendje të veçantë kundrejt personave me aftësi të kufizuara, barazisë gjinore dhe grupeve të tjera të cenueshme; c) rritja e kapaciteteve të përgjigjes dhe përfshirjes së inovacionit; d) harmonizimi i politikave, kuadrit ligjor dhe rregullator të ZRF; e) përforcimi i aftësive menaxhuese të riskut nga fatkeqësitë me qëllim anëtarësimin në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së (MMC BE).

Vlerësimi Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror 2022 (VKRF) – është një dokument i cili mbështet qeverinë shqiptare në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë me synimin për të dhënë informacion dhe njohuri mbi proceset e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet grupeve kombëtare e ndërkombëtare si dhe adresimin e sfidave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Ky dokument evidenton 8 risqe potenciale për Shqipërinë të cilat janë: përmytjet, rrëshqitjet, zjarret, tërmetet, risku

teknologjik, risku biologjik, ortekët, dhe çarja e digave. Sipas vlerësimit, më problematikët shfaqen të jenë përmbytjet, risku teknologjik dhe ai biologjik. Nga analiza e ekspozimit nga risqet e shumëfishta, qarqet më të ekspozuara janë Tirana dhe Vlora (risk i lartë), Fieri, Elbasani, Shkodra dhe Durrësi (risk mesatar në të lartë). Vlerësimi sugjeron rritjen e kapaciteteve në tre drejtime kryesore: zbutjen e risqeve; hartimin e strategjisë për menaxhimin e fatkeqësive; ndërmarrja e vlerësimeve periodike në kontekstin e ZRF. Përsa i përket qarkut të Fierit, riskun më të lartë nga fatkeqësitë e përfaqësojnë përmbytjet dhe risqet teknologjike.

Fushat e rëndësishme të ngritjes së kapaciteteve të MRF-së në këtë qark përfshijnë a) menaxhimin e riskut nga përmbytjet, b) menaxhimin e riskut nga zjarret masive dhe c) monitorimin dhe zbutjen e risqeve teknologjike.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile 2023 (PKEC) – synon të ndihmojë në kryesisht në fazat e përgjigjes dhe rimëkëmbjes në rastin e një fatkeqësie duke ngritur procedurat e nevojshme për të kaluar nga një situatë e përditshme në një situatë emergjence me humbje minimale. Objektivat strategjike të planit janë: harmonizimi me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rajonale; dhënia e informacioneve mbështetëse për të gjitha grupet e interesit me qëllim përdorimin e terminologjisë, përkufizimeve dhe koncepteve të përbashkëta; njohja me procedurat dhe informacionet me qëllim koordinimin e burimeve në mënyrë të sigurt, efektive dhe efikase gjatë përgjigjes ndaj emergjencave; dhënia e kontekstit për kalimin në fazën e rimëkëmbjes pas emergjencave dhe dhënia e ndihmës për vazhdimësinë e veprimtarisë së qeverisë, bizneseve dhe shërbimeve.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Fier, PPV, 2015 – 2030 – është dokumenti kryesor i planifikimit në nivel vendor i cili drejton zhvillimin e ekonomik, social e mjedisor të bashkisë Fier. Në dokument evidentohet se koncepti i zhvillimit shkon përtej atij ekonomik duke synuar zbutjen e pabarazive sociale dhe mbrojtjen e burimeve natyrore. PPV parashikon edhe disa objektiva strategjike: a) diversifikimi dhe bashkëjetesa e sektorëve të ndryshëm ekonomikë; b) mbrojtja e tokës bujqësore dhe konsolidimi i saj; c) ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit natyror, ujor e bregdetar; d) projektimi i shtrirjes dhe densifikimi urban në përputhje me popullsinë e pritshme dhe kapacitetin mbajtës të zonave; e) lidhja e mirë e territorit nëpërmjet akteve rrugore e hekurudhorë. Ndër të tjera ky dokument parashikon një sërë masash në kuadër të mbrojtjes së burimeve natyrore dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm të cilat janë në linjë me projektet e parashikuara në Strategjinë për ZRF.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Bashkisë Fier, VSM, 2015-2030 – është hartuar në kuadër të hartimit të PPV Fier me qëllim sigurimin e masave mbrojtëse për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm duke u siguruar për përfshirjen e çështjeve mjedisore gjatë hartimit të PPV-së dhe adresimin e efekteve potenciale në fazat e ardhshme të vendim-marrjes lidhur me procesin e planifikimit. Gjatë hartimit të VSM janë caktuar një sërë objektivash mjedisore të cilët synojnë të shërbejnë si udhëzues për zhvillimet e ardhshme duke përmendur këtu: monitorimin e cilësisë së

ajrit, mbrojtjes së burimeve ujore dhe minimizimi i efekteve negative nga aktiviteti njerëzor, mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tokës, pyjeve, biodiversitetit, ekosistemeve, peizazhit, trashëgimisë kulturore dhe marrjen e masave për zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike.

Aktorët

Për të adresuar fatkeqësitë në të gjitha fazat e menaxhimit (parandalim, gatishmëri, përgjigje, rimëkëmbje) është e rëndësishme një njohje e mirë e aktorëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë që operojnë në mënyrë direkte apo indirekte në këtë fushë. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi është një hap themelor në rastin e fatkeqësive. Linja e parë për menaxhimin e fatkeqësive janë institucionet qeveritare, kombëtare dhe lokale, që e kanë detyrim dhe përgjegjësi këtë detyrë. Më pas janë organizatat e shoqërisë civile që operojnë në territor dhe kanë përgjithësisht marrëdhënie të mira me komunitetet lokale. Donatorët gjithashtu janë të rëndësishëm, të cilët hapin thirrje të ndryshme për projekte që mund të shfrytëzohen për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Media mund të përdoret si një kanal i rëndësishëm komunikimi që përcjell informacionet e duhura tek komuniteti në rastin e ZRF. Rol kyç luan edhe komuniteti nga i cili formohen grupet vullnetare, të gatshme të përgjigjen në rastin e emergjencave. Më poshtë listohen disa aktorë thelbësor në kontekstin e ZRF:

- *Ministria e Mbrojtjes (MM)* – një nga grupet kryesore të interesit dhe një vendimmarrës në zhvillimin e sistemit të MRF-së. Aktualisht, AKMC është në varësi të MM. Si e tillë, MM luan një rol të rëndësishëm në marrjen e vendimeve mbi detyrat dhe funksionet e AKMC-së. Ligji “Për mbrojtjen civile” parashikon se Forcat e Armatosura angazhohen në operacione të ciklittë menaxhimit të fatkeqësive, nëse kapacitetet në dispozicion janë të pamjaftueshme për këtë qëllim, për të mbështetur institucionet, autoritetet qendrore e vendore dhe komunitetin. Një strukturë tjetër e rëndësishme në varësi të MM-së është Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (QKKS).
- *Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)* – aktori kryesor për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. AKMC-ja është agjencia udhëheqëse me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të garantuar zhvillimin e kapaciteteve të MRF-së në vend dhe angazhimin e grupeve të tjera kryesore të interesit në fusha të caktuara funksionale. AKMC është përgjegjëse për bashkërendimin e punës, për hartimin e strategjisë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, për planit kombëtar për emergjencat civile dhe vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. AKMC organizon punën për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, si dhe për trajnimin e strukturave shtetërore, subjekteve private dhe vullnetare. Në nivel vendor, sipas ligjit “Për mbrojtjen civile”, AKMC është e organizuar dhe vepron në nivel rajonal përmes 4 qendrave të mbrojtjes civile në qark. AKMC ka koordinuar dhe bashkërenduar punën, ndër të tjera, për hartimin e VRF në nivel qendror, SKZRF, PKEC dhe krijimin e bazës së unifikuar të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në të gjitha nivelet e qeverisjes.
- *Komiteti i Mbrojtjes Civile (KMC)* – roli potencial i KMC-së është përshkruar në ligjin 45/2019, si një strukturë rregullatore dhe e koordinimit të përgjithshëm sikurse edhe në PKEC.

- Ministria e Brendshme (MB) – është një tjetër aktor thelbësor në fushën e MRF. Krahas sigurisë publike, Ministria e Brendshme është përgjegjëse për a) koordinimin me Institucionin e Prefektit të qarkut; b) hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit; c) mbrojtjen dhe kontrollin e territorit, ajrit, ujit dhe pyjeve nga ndotja, dëmtimi apo ndërhyrjet e paligjshme të çdo lloji. MB kontribuon në menaxhimin e emergjencave përmes strukturave në varësi të saj, si Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Rendin, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.
- Ministria e Financave – angazhimi i këtij grupi interesi në sistemin e MRF-së është e lidhur kryesisht me menaxhimin e burimeve financiare, zbatimin e procedurave doganore ligjore, adresimin e nevojave të përgjigjes dhe rimëkëmbjes në subjektet private, infrastrukturën publike dhe kritike. MF është burimi kryesor i mbështetjes financiare për sistemin e MRF-së.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) - si struktura përgjegjëse kryesore përsa i përket infrastrukturës kritike dhe që bashkëpunon për vlerësimin e riskut dhe zvogëlimin e tij, veçanërisht në zonat me një shtrirje të madhe të aktivitetit teknologjik e industrial në fushën e sektorit energjetik e hidrokarbur, infrastrukturës së transportit, si dhe për infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe të industrisë jo ushqimore.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) – MBZHR ka si mision hartimin e zbatimin e politikave në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutorë. Disa nga funksionet më kryesore të MBZHR janë: Mbrojtja e tokës nga erozioni; mbrojtja e burimeve dhe e rezervave ujore; mbrojtja e kafshëve nga sëmundjet dhe parandalimi i përhapjes së tyre; garantimi i qëndrueshmërisë, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi sipas rregullave të rezervuarëve; inspektimi kushteve optimale të prodhimit, magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve ushqimore, blegtorale dhe bujqësore; inspektimi i kushteve të magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të preparateve të mbrojtjes së bimëve; ushtrimi i kontrollit në vendkalimet kufitare, për parandalimin e transmetimit të sëmundjeve në bimë dhe në kafshë; mirëmbajtja, monitorimi dhe vënia në gatishmëri e sistemit të kanalizimeve, pritave, argjinaturave dhe sistemeve të pompimit; Riaftësimin e zonave të përmytura.
- Ministritë e linjës (ML) – pothuajse të gjitha ministritë e linjës mund të angazhohen me efikasitet në sistemin e MRF-së. Roli i tyre në ciklin e menaxhimit të emergjencave/ fatkeqësive (parandalimi, gatishmëria, përgjigja dhe rimëkëmbja) përcaktohet në dokumentin e PKEC. Është e rëndësishme të identifikohen strategjitë e duhura për angazhimin më të mirë të ministrive në zhvillimin e sistemit të MRF-së dhe në integrimin e qasjes së MRF-së në të gjitha funksionet e tyre. Ministritë e linjës në vijim janë angazhuar në sistemin e MRF-së në Shqipëri:
- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) – përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) – Agjencia qendrore që është pjesë e strukturës ekzekutive të MTM dhe është përgjegjëse për krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të informacionit mjedisor dhe monitorimit të ndotjes në territor duke përfshirë edhe subjektet private.
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) – si institucioni qendror që është përgjegjës edhe për aktivitetin e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve, ku bashkitë e qarkut Fier përfshijnë vendburimet kryesore të naftës dhe gazit në vend.
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) – është organi qendror përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Menaxhimi në këtë rast ndodh në shkallë baseni ujor duke përfshirë territore të gjera: Baseni Drin – Bunë; Baseni Mat; Baseni Ishëm; Baseni Erzen; Baseni Shkumbin; Baseni Seman; Baseni Vjosë.
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) – këshilltar shtetëror teknik dhe shkencor dhe institucioni publik në fushën e Shkencës së Tokës, i cili trajton edhe çështjet e rrëshqitjeve të tokës dhe fenomene të tjera gjeologjike.
- Shërbimi i Urgjencës Mjekësore (ShUM) – përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem shtetëror të unifikuar. Ai funksionon bazuar në ligjin nr. 147/2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”. Zvogëlimi dhe gatishmëria ndaj riskut të fatkeqësive janë elementë të rëndësishëm në misionin e këtij institucioni. Gjatë një emergjence, ky shërbim bëhet pjesë thelbësore e forcave operacionale dhe duhet të koordinojë veprimet me ta në mënyrë që të mundësojë një përgjigje efektive (bazuar në ligjin “Për mbrojtjen civile”. Gjithashtu, mund të japë informacione të dobishme për identifikimin e riskut të fatkeqësive, veçanërisht për sa i përket riskut biologjik.
- Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) – si institucioni qendror që mbulon kontrollin dhe inspektimin e gjithë instalimeve dhe pajisjeve teknologjike e industriale, të cilat janë bazë dhe mbështetje për aktivitetet përkatëse në shumicën e bashkive të Qarkut Fier.
- Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSh) – Aktiviteti i KKSh-së bazohet në ligjin nr. 7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, i ndryshuar. Roli i KKSh-së në MRF është shumë i ngjashëm me atë të ShUM-it. Në rastin e një emergjence civile, KKSh krijon qendra informacioni, realizon vlerësime të dëmeve dhe nevojave, ofron asistencë/shërbim psiko-social dhe të dhënies së ndihmës së parë, shpërndan paketa ushqimore dhe garanton kushte jetese normale për popullsinë e prekur.
- Policia e Shtetit – Strukturë aktive dhe operacionale gjatë një emergjence. Bazuar në nivelin e emergjencës, Policia e Shtetit mund të aktivizohet nga drejtuesi i operacioneve ndërkohë që forcat e tyre komandohen nga eprorët përkatës.
- Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (ShMZSh) – ka rol thelbësor për gatishmërinë dhe përgjigjen. Detyrat e ShMZSh janë standardizimi, kontrolli i zbatimit të të gjithave akteve ligjore në rastin e zjarreve masive dhe koordinimi i strukturave zjarrfikëse në nivel vendor.
- Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile – kjo është një strukturë vullnetare, e cila është në proces formimi dhe zhvillimi (krijuar në vitin 2013). Aktualisht, shërbimi është një strukturë e

përgjigjes operacionale. Gjithashtu, ai ofron shërbime të urgjencës mjekësore me ambulanca gjatë një emergjence.

- *Prefektura e Fierit* – janë ndër partnerët kryesorë për zhvillimin e sistemit të decentralizuar të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në vend. Është e përfshirë në të gjitha fushat funksionale të menaxhimit të riskut. Ligji 45/2019 adresoi mangësitë në funksionimin e autoriteteve në nivel qarku dhe bashkie gjatë emergjencave të kaluara, duke e vënë më tepër theksin te roli i prefektëve dhe kryetarëve të bashkive në koordinimin e strukturave për përgjigjen ndaj emergjencave në nivel qarku dhe bashkie. Ligji 45/2019 e përforcoi rolin e qarkut përsa i përket bashkërendimit dhe bashkëveprimit në rast emergjencash.
- *Bashkitë* – një nga grupet kryesore të interesit në sistemin e MRF-së. Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, “Bashkitë janë përgjegjëse për mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”. Përvoja e sistemeve të suksesshme të MRF-së tregon se bashkitë janë duke luajtur një rol thelbësor në garantimin e aftësive ripërtëritëse në nivel vendor dhe gatishmërisë ndaj fatkeqësive të mundshme. Janë të përfshira në të gjitha fushat kryesore funksionale të MRF-së. Bashkitë kanë përgjegjësinë e përgatitjes së vlerësimeve të riskut të fatkeqësive në nivel vendor, hartimin e strategjisë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në bashki dhe planin vendor për emergjencat civile. Planet e tjera të bashkisë, si PPV-ja, planet e strehimit social, planet e mobilitetit etj, duhet të harmonizohen me këto vlerësime dhe strategji të riskut.
- *Partnerët ndërkombëtarë, OJO-të dhe donatorët* – ky grup interesi ka luajtur një rol kyç që nga ngritja e sistemit të emergjencave civile në vitin 2001 në Shqipëri. Tre donatorët kryesorë, janë BE, BB dhe OKB, që kanë ndihmuar Shqipërinë veçanërisht në përpjekjet e rimëkëmbjes pas fatkeqësive (përmytjet e shpeshata dhe tërmeti i kohëve të fundit). Përveç tyre, në Shqipëri operojnë edhe donatorë të tjerë që hapin thirrje të ndryshme për projekte që lidhen me menaxhimin e fatkeqësive si GIZ, IADSA, JICA, AISC etj. Rol të rëndësishëm luajnë edhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të cilët operojnë ngushtësisht me komunitetin në punën e tyre dhe si pasojë janë të rëndësishëm në aktivitetet e informimit, ndërgjegjësimin dhe trajnimin të komuniteteve.
- *Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)* – një aktor i rëndësishëm në fushën e kërkimit, zhvillimit të njohurive dhe kuptimit mbi elementët e riskut të fatkeqësive. UPT përmes njësive të tij kryesore (IGJEO, FGJM, FIN, FAU, FTI etj.) prodhon të dhëna të rëndësishme për ngjarjet e rrezikshme natyrore dhe territoret ku ato ndodhin, të dhëna për modelet e ekspozimit dhe tipologjitë ndërtimore të zhvilluara në territor si dhe të dhëna për modelet e cenueshmërisë së stokut të ekspozuar ndaj rreziqeve. Gjithashtu, IGJEO është identifikuar si struktura kombëtare e monitorimit dhe paralajmërimit për aktivitetin meteorologjik, hidrologjik dhe sizmologjik në Shqipëri. IGJEO ofron informacion për AKMC-në dhe agjencitë e tjera përmes “Qendrës kombëtare për parashikimin dhe monitorimin e rreziqeve natyrore” dhe qendrës kombëtare për monitorimin e veprimtarisë sizmike.
- *Universitetet* – janë aktorë të rëndësishëm në aktivitete kërkimore dhe studimore që lidhen me fatkeqësitë. Falë laboratorëve të tyre mund të kryejnë analiza të detajuara, të prodhojnë të

dhëna të rëndësishme për komponentë të caktuar, të kryejnë kërkime shkencore të cilat mund të shfrytëzohen në kontekstin e menaxhimit të fatkeqësive për hallka të ndryshme të tij.

2. Konteksti i bashkisë për ZRF

2.1 Vlerësimi i riskut

Bashkia e Fierit është qendra më e madhe administrative e qarkut me të njëjtin emër e cila ka një sipërfaqe prej 620 km² e përbëhet nga 10 Njësi Administrative, NjA të cilat janë: Fier, Libofshë, Topojë, Qendër, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Portëz dhe Mbrostar. Bashkia kufizohet në veri me Bashkinë e Divjakës në lindje me Bashkitë e Lushnjës, Roskovecit, Patosit e Mallakastrës ndërsa në jug me Bashkinë e Selenicës dhe Vlorës dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Njësia Administrative e Fierit është njësia kryesore e kësaj bashkie në të cilin është i vendosur edhe qyteti i Fierit i cili konsiderohet si zona më urbane e bashkisë.

Referuar të dhënave të INSTAT (Census 2011), Bashkia e Fierit ka një popullsi prej 120, 655 banorësh dhe pjesa më e madhe e tyre rreth 55, 845 banojnë në NjA Fier, e cila ka dhe dendësinë më të lartë me rreth 4,961 banorë/km² për shkak se kjo njësi ka edhe sipërfaqen më të vogël në raport me njësitë e tjera të kësaj bashkie.

Sa i përket aktivitetit ekonomik, peshën më të madhe në nivel bashkie e zë **sektori i shërbimeve me 61.74%**, bujqësisë dhe blegtorisë me 29.39% dhe industria me 6.43%.

Në Bashkinë Fier ka një total prej 33,082 banesash të cilat janë kryesisht për qëllime banimi. Nga të dhënat e paraqitura edhe në tabelën e mëposhtme vërehet se pjesa më e madhe e banesave, rreth 11, 886 në këtë bashki janë ndërtuar ndërmjet viteve 1961 – 1990 gjatë periudhës së regjimit komunist dhe janë rreth 70 vite të vjetra.

Tabela 1: Shpërndaja e ndërtesave sipas periudhës së ndërtimit për çdo njësi administrative

Njësia administrative	Periudha e ndërtimit				
	Deri 1960	1961 - 1990	1991 - 2000	2001 - 2011	Pas 2011
CAKRAN	850	1741	663	579	212
DËRMENAS	407	913	444	274	890
FIER	1473	2982	2102	1272	1181
FRAKULL	326	1030	418	448	109
LEVAN	388	1242	612	464	394

LIBOFSHË	330	963	373	352	967
MBROSTAR URA	266	712	543	454	132
PORTËZ	475	1142	474	439	432
QENDËR	166	434	223	172	1211
TOPOJË	221	727	123	120	217

Burimi: Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë, Bashkia Fier, 2023

Ndërsa sa i përket infrastrukturës publike në territorin e bashkisë gjenden 4 diga (Lalarit, Turbullit, Petovës, Libofshës), 11 monumente kulture, 24 ura të cilat mund të jenë të ekspozuara ndaj rreziqeve, 100 godina të sistemit arsimor dhe 23 godina të sistemit shëndetësor përfshi këtu spitale apo poliklinika.


Kjo bashki karakterizohet nga një reliev kryesisht fushor për rreth 69% dhe kodrinor për rreth 31% të territorit të kësaj bashkie dhe një lartësi maksimale prej 550 m mbi nivelin e detit.

Bashkia e Fierit ka një sipërfaqe pyjore totale prej **6,304 ha** nga të cilat 3,920 ha ose **62% e tyre administrohen nga bashkia** ndërsa pjesa tjetër janë pronësi private, pjesë e fondit pyjor janë edhe Pylli i Levanit (199 ha) dhe Pylli i Pishë Poros (1,575 ha) të cilët janë deklaruar edhe si rezervate natyrore ose parqe natyrore të menaxhuara.

Rrjeti hidrografik i kësaj bashkie mund të konsiderohet relativisht i pasur pasi në territorin e saj e përshkojnë lumi Seman dhe Vjosa dhe lumi i Gjanicës i cili kalon përmes qytetit të Fierit, gjithashtu në territorin e saj gjenden edhe 4 rezervuar.


Bashkia ka një rrejt të dendur kanalesh vaditëse me rreth 781 km dhe 691 km rrjet kullues si dhe 114 ha ligatina. Duke qenë se në pjesën perëndimore bashkia kufizohet me Detin Adriatik, kjo bashki ka edhe një vijë bregdetare prej rreth 30 km të gjatë.

Figura 1: Sistemet territoriale të Bashkisë Fier



Burimi: PPV Fier dhe përpunim i autorëve

Referuar Raportit të Vlerësimit të Riskut në nivel vendor janë vlerësuar 6 risqe kryesore dhe është vlerësuar ndikimi i tyre për secilën nga NjA të Bashkisë Fier duke evidentuar se risku sizmik vlerësohet me 9 (ekstrem) ndërsa risqet e tjera vlerësohen me 8 (i lartë). Vlera këto të cilat evidentojnë se Bashkia Fier është tepër e ekspozuar dhe e cenueshme nga fatkeqësitë natyrore të cilat në rast se ndodhin mund të ndikojnë në mirëqenien e banorëve dhe zhvillimin ekonomik të bashkisë.



Grafiku: 1
Niveli i riskut për bashkinë Fier

Burimi: Vlerësimi i riskut të fatkeqësive, Bashkia Fier, 2023

Burimi: Vlerësimi i riskut të fatkeqësive, Bashkia Fier, 2023

Niveli i riskut		Bashkia Fier	Risku Biologjik	Risku nga Rrëshqitjet	Risku Sizmik	Risku nga përmbytjet	Risku Teknologjik	Risku nga Zjarret në Pyje
Shumë i ulët								
I ulët		Ndikimi në njerëz						
I mesëm		Ndikimi ekonomik						
I lartë		Ndikimi mjedisor						
Ekstrem		Ndikimi politiko-social						

Sa i përket humbjeve në vlera monetare, në nivel Qarku parashikohet një humbje mesatare vjetore në intervalin 10-15 milion Euro nga risku nga fatkeqësitë, nga të cilat 41.2% e tyre përlllogaritet të janë në Bashkinë e Fierit ose rreth 6,150,000 Euro mesatarisht në vit (15 milion Euro shifra e marrë për referencë).

Tabela 2: Shpërndarja e humbjeve mesatare vjetore

Bashkia	Risku Biologjik	Risku nga Rrëshqitjet	Risku Sizmik	Risku nga Përmbytjet	Risku Teknologjik	Risku nga Zjarret në Pyje	Shuma
CAKRAN	2.06%	2.32%	3.17%	1.61%	0.59%	1.70%	11.45%

DËRMENAS	1.37%	0.16%	1.27%	2.36%	0.33%	1.51%	7.00%
FIER	9.80%	0.07%	16.96%	0.40%	12.79%	0.37%	40.39%
FRAKULL	1.20%	1.03%	1.50%	1.53%	0.83%	0.02%	6.10%
LEVAN	1.43%	1.25%	1.72%	2.91%	0.87%	1.80%	9.97%
LIBOFSHË	1.08%	0.25%	0.87%	1.28%	0.42%	0.09%	3.99%

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

<i>Bashkia</i>	<i>Risku Biologjik</i>	<i>Risku nga Rrëshqitjet</i>	<i>Risku Sizmik</i>	<i>Risku nga Përmbytjet</i>	<i>Risku Teknologjik</i>	<i>Risku nga Zjarret në Pyje</i>	<i>Shuma</i>
MBROSTARURA	1.31%	0.46%	2.03%	1.48%	0.51%	0.10%	5.90%
PORTËZ	1.45%	1.75%	1.68%	1.55%	1.40%	0.09%	7.92%
QENDËR	0.74%	0.17%	0.80%	1.19%	0.34%	0.02%	3.26%
TOPOJË	0.74%	0.00%	0.59%	2.10%	0.25%	0.34%	4.02%
Shuma	21.17%	7.46%	30.57%	16.41%	18.34%	6.05%	

Burimi: Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë, Bashkia Fier, 2023


Risku nga Përmbytjet

Në Bashkinë e Fierit në të kaluarën ka pasur disa përmbytje të cilat janë shkaktuar kryesisht nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm e dalja e lumit Vjosa e Seman nga shtrati duke përmbytur kështu zonat fushore në NjA Mbrostar, Libofshë, Cakran përgjatë rrjedhës së Vjosës dhe pjesën perëndimore të NjA. Dërmenas, Levan e Topojë. Referuar edhe të dhënave lidhur me riskun nga përmbytjet të paraqitur edhe në grafikun më poshtë, rezulton se pjesa më e madhe e NjA të bashkisë vlerësohen me 8, i lartë, dhe me 6, mesatar, vlerësohet vetëm NjA Fier. Nga këto të dhëna mund të themi se kjo bashki ka një nivel të lartë risku nga përmbytjet.

Vija Bregdetare

Bashkia e Fierit ka një vijë bregdetare prej rreth 30 km dhe referuar të dhënave, shekullin e kaluar ka pasur një përparim të vijës bregdetare me 15 cm në drejtim të tokës, përparim i cili pritët të rritet me 40 cm deri në vitin 2100. Si pasojë e përparimit të detit do të shtohet sipërfaqja e tokave të përmbytura si dhe probleme me kripëzimin e tokave bujqësore. Fenomeni i depërtimit të ujërave të kripur është vënë re në akuiferin kuarternar të Vjosës në të cilin ndodhen edhe pusshpimet e Kafaraj në të cilin janë vërejtur përmbajtje të lartë të klorit gjë e cila ndikon në cilësinë e ujërave të cilat përdoren për furnizimin me ujë të popullatës.²¹

Grafiku: 2 Niveli i riskut nga përmytjet




Burimi: Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë, Bashkia Fier, 2023

Risku nga rrëshqitjet

Për shkak edhe të relievit zona lindore e bashkisë Fier është kryesisht e prekur nga fenomeni i rrëshqitjes ku gjatë viteve janë regjistruar rreth 380 rrëshqitje të cilat kanë ndodhur kryesisht në NjA Cakran (107), Frakull (88) dhe Levan (72). Referuar të dhënave të paraqitura edhe në grafikun e mëposhtëm lidhur me nivelin e riskut nga rrëshqitjet NjA. Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz vlerësohen me 8, i lartë, në 4 njësi të tjera të bashkisë risku vlerësohet me 6, i mesëm, ndërsa në NjA Fier dhe Topojë ai vlerësohet me 4 dhe 3, i ulët.

Grafiku: 3 Niveli i riskut nga Rrëshqitjet



Burimi: Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë, Bashkia Fier, 2023


Risku nga Zjarret në Pyje

Ndryshimet Klimatike pritet të prekin edhe Bashkinë e Fierit duke ndikuar në rritjen me 30% të numrit të zjarreve deri në 2100. Referuar të dhënave të disponueshme numri i përgjithshëm i zjarreve për periudhën 1978 – 2022 ka qenë 127 nga të cilët vetëm 52.5% e zjarreve kanë qenë në fondin pyjor dhe 47.5% në sipërfaqe jopyjore. Përgjatë këtyre viteve rezultojnë se është djegur një sipërfaqe pyjore prej 403.12 ha, të dhëna të cilat sugjerojnë një sipërfaqe mesatare prej 4.03 ha të djegur në vit me një frekuencë prej afro 3 zjarre në vit. Nga të dhënat e paraqitura edhe në grafikun e mëposhtëm rezultojnë se NjA Cakran, Dërmenas dhe Levan vlerësohen me 8, pra me nivelin e lartë të rrezikimit për zjarr në pyje, 5 NjA vlerësohen me 6, rrezik i mesëm dhe 2 NjA respektivisht Fieri dhe Qendër vlerësohen me 4, rrezik i ulët nga zjarret.

Grafiku: 4 Niveli i riskut nga Zjarret në Pyje

Risku nga Zjarret në Pyje


10



Risku Sizmik

Qarku i Fierit njihet si një zonë me sizmicitet të lartë për shkak edhe të pozicionit të saj gjeografik (në brezin sismogjen Adriatiko Jonik) e historikut, pasi në të kaluarën ka pasur disa tërmete të forta të cilat kanë shkaktuar dëme në banesa e njerëz. Për shkak të ekspozimit dhe cenueshmërisë së infrastrukturës niveli i riskut sizmik vlerësohet me 9, ekstrem, në NjA Fier dhe me 8, i lartë, në gjitha NjA të kësaj bashkie. Duke qenë se pjesa më e madhe e stokut të banesave të ndërtuara ndërmjet viteve 1960 – 1990 është e përqendruar në NjA të Fierit si dhe duke marrë në konsideratë dendësinë e popullatës në këtë njësi ajo vlerësohet si më e ekspozuar dhe e cenueshme lidhur me risqet sizmike e për këtë arsye duhet të kryhen vlerësime më të qenësishme për të evidentuar gjendjen strukturore të këtyre banesa.²⁴

Grafiku: 5 Niveli i riskut Sizmik




Burimi: Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë, Bashkia Fier, 2023

Risku teknologjik

Bashkia e Fierit është një nga bashkitë e cila njihet për burimet natyrore të cilat gjenden në territorin e saj, kryesisht në sektorin teknologjik e më specifikisht në aktivitete për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve si dhe rrjetin për ruajtjen dhe transportin e tyre si dhe në sektorin e industrisë agro-ushqimore. Në pjesën lindore të bashkisë shtrihen pjesërisht disa nga vendburimet më të rëndësishme të naftës siç janë vendburimi i Patos – Marinëz, Visokë dhe ai i Cakran – Mollaj, ndërsa shtrihen plotësisht në territorin e kësaj bashkie vendburimet e gazit natyror e më saktësisht ai i Frakullës dhe i Povelçës. Duke qenë se vendburimet e hidrokarbureve gjenden në disa bashki të Qarkut të Fierit nevojitet një bashkëpunim dhe bashkërendim i projekteve strategjike në sektorin teknologjik ndërmjet bashkive për të rritur efektivitetin e ndërhyrjeve dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive natyrore. Në territorin e kësaj bashkie kryejnë aktivitetin e tyre një sërë subjektsh që i përkasin sektorit teknologjik/industrial siç janë: kompania “Trans Adriatik Pipeline” AG që administron aktivitetin e gazsjellësit TAP, ndodhet Stacioni i Kompresorëve të TAP; shoqëria e kërkim-prodhimit të hidrokarbureve “Albpetrol” sh.a; Uzina e

Përpunimit të Naftës e administruar nga shoqëria “Alglobal Oil” sh.a.; shoqëria “EDG Natural Gas” sh.p.k”. e cila në kuadër të Marrëveshjes Hidrokarbure me “Albpetrol” sha. po kryen operacione hidrokarbure për zhvillimin e vendburimeve të gazit në Frakull dhe Povelçë. Përtej subjekteve në territorin e bashkisë shtrihet edhe një pjesë e infrastrukturës e cila shërben për transportin e hidrokarbureve dhe gazit të cilat lidhin ‘Impiantin Qendror të Trajtimit’ në vendburimin Patos – Marinëz me pikën e lëvrimin në territorin e ish-“Zonës Industriale Fier”. Gjithashtu duke parë aktivitetin industrial ndër vite në territorin e NjA Fier shtrihet edhe Zona Industriale me një sipërfaqe 60 ha e cila përfshin ‘Parkun Industrial të Prodhimit të Azotit’, zonën e “Uzinës së Përpunimit të Naftës si dhe ish-TECin të cilat mund të konsiderohen edhe si pika të nxehta mjedisore për shkak të groposjes së mbetjeve të lëndëve si bakër e amoniak. Sa i përket nivelit të riskut teknologjik për shkak edhe të sektorit teknologjik të zhvilluar bashkia në tërësi ka nivel mesatar risku, NjA Levan dhe Portëz kanë nivel të lartë risku të vlerësuar me 8, ndërsa NjA Fier vlerësohet me 9, nivel ekstrem risku. Një ndër sektorët më të ekspozuar dhe cenueshëm nga rreziku teknologjik është ai bujqësor pasi çdo lloj rrjedhje apo shpërthimi që mund të ndodhë në sektorin teknologjik impakton drejtpërdrejt sektorin më të zhvilluar të bashkisë, atë bujqësor. Gjithashtu i ekspozuar është edhe sektori i furnizimit me ujë duke qenë se uji për pjesën më të madhe të bashkisë sigurohet nga puse të cilat e marrin ujin nga Lumi Vjosë dhe një ndotje e tij automatikisht do ta bënte atë të pa përdorshëm duke kompromentuar furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm.

Grafiku: 6 Niveli i riskut Teknologjik




Burimi: Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë, Bashkia Fier, 2023

Risku biologjik

Niveli i riskut biologjik vlerësohet me 8, i lartë, për pjesën më të madhe të NjA të kësaj bashkie, dhe me 9, ekstrem, për NjA Fier kjo edhe për shkak të kapaciteteve të ulta të sistemit shëndetësor për të përballuar pandemi të ngjashme me atë të shkaktuar nga virusi SARS COV 2, COVID 19, por edhe ato të shkaktuara nga Gripi sezonal (fatal në disa raste) apo Fruthi i cili për shkak të uljes së vaksinimit të popullsisë këto vitet e fundit, i cili ka rënë në 89.2% për vitin 2021, është më e cenueshme ndaj këtij virusi. Nga ana tjetër në këtë bashki risku biologjik është relativisht i lartë pasi duke qenë së në territorin e saj është i zhvilluar sektori i teknologjik gjasat për ndotjen e burimeve ujore apo sëmundjeve të shkaktuara nga ndotësit e lëshuar në ajër mund të rrisin ekspozimin e cenueshmërinë e banorëve të kësaj bashkie. Një nga zonat e konsideruar edhe si pikë e nxehtë mjedisore është zona industriale në Fier ose ish Azotiku i Fierit. Në territorin e kësaj zone janë depozitar mbetje kimike të ndryshme të cilat pa monitorimin e nevojshëm mund të ndotin tokat përreth apo ujërat nëntokësore duke ekspozuar të gjithë banorët e kësaj njësie.

Grafiku: 7 Niveli i riskut Biologjik



Burimi: Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë, Bashkia Fier, 2023


2.2 Kapacitetet financiare të bashkisë

Analizë financiare

Burimet financiare në dispozicion të bashkisë Fier paraqesin luhatje përgjatë periudhës në analizë. Në fund të vitit 2022, burimet financiare në dispozicion të bashkisë Fier shënuan një

nivel prej rreth 2.9 miliardë lekë, në rritje me rreth 2% në terma vjetorë. Zgjerimi i burimeve financiare në dispozicion u përcaktua nga rritja e të hyrave nga transfertat ndërqeveritare me rreth 3%, kategori që përfaqëson rreth 79% të burimeve totale. Në të kundërt, të ardhurat nga burimet e veta vendore ndoqën prirje rënëse gjatë vitit 2022 (ndikuar kryesisht të ardhurat nga taksat vendore). Të ardhurat nga tarifat vendore kontribuuan pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave nga burimet e veta vendore duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2021 (+75% në terma vjetorë). Kontribut pozitiv në këtë drejtim dhanë veçanërisht të ardhurat nga tarifat për shërbimet publike vendore. Transfertat e kushtëzuara janë një tjetër kategori e burimesh financiare të cilat shënuan një nivel prej rreth 1.1 miliardë lekë në vitin 2022 (nivel ky pothuajse i njëjtë me atë të shënuar një vit më parë). Kjo kategori e burimeve financiare përfshin transfertën e kushtëzuar për emergjencat civile.


Grafiku: 8 Ecuria e të ardhurave totale



Burimi: www.financatvendore.al dhe përpunime të autorëve

Zgjerimi i burimeve financiare u pasqyrua në rritjen e shpenzimeve të kryera nga bashkia Fier në vitin 2022 me rreth 2% në terma vjetorë. Sipas natyrës ekonomike, bashkia Fier përdori rreth 89% të burimeve financiare në dispozicion për vitin 2022 për mbulimin e shpenzimeve korrente, shpenzime personeli, operative dhe të tjera. Në terma vjetorë, shpenzimet e alokuara për paga, operative dhe të tjera shënuan rritje gjatë vitit të fundit. Investimet apo shpenzimet kapitale përfaqësuan vetëm 11% të shpenzimeve totale në fund të vitit 2022. Pas vitit 2017, niveli i investimeve në bashkinë Fier është ngushtuar në mënyrë të vazhdueshme dhe në vitin 2022 rezultoi në rreth 299 milionë lekë, në rënie vjetore me rreth 30%. Kjo vlerë përfshin investime të kryera me fonde të veta të bashkisë (nga burimet e veta vendore dhe me fonde të kushtëzuara).

Grafiku: 9 Përdorimi i burimeve financiare




Burimi: www.financatvendore.al dhe përpunime të autorëve

Në klasifikimin sipas funksioneve të qeverisjes, shpenzimet rezultojnë të jenë përqendruar në masën 34% në funksionin “mbrojtja sociale” dhe shënuan rritje me rreth 12% krahasuar me vitin e mëparshëm. Në funksionin “shërbime të përgjithshme publike”, bashkia Fier shpenzoi rreth 27% të burimeve financiare në dispozicion, ndjekur nga 16% të tyre në funksionin “strehim dhe komoditete të komunitetit”. Mesatarisht në tre vitet e fundit, bashkia Fier ka shpenzuar rreth 1% të buxhetit në dispozicion në funksionin “rendi dhe siguria publike” ku janë të përfshira ndër të tjera shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, parandalimi dhe menaxhimi të fatkeqësive natyrore (emergjencat civile).

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

Grafiku: 10 Shpenzimet sipas funksioneve



Burimi: www.financatvendore.al dhe përpunime të autorëve

Në financimin e shërbimit të emergjencave civile, bashkitë në Shqipëri përdorin disa burime: fonde të cilat vijnë si transfertë e kushtëzuar nga ministria përgjegjëse e linjës, fonde të parashikuara në buxhetin vjetor deri në masën 1% të tij dhe fonde të tjera nga burimeve të veta vendore. Bazuar në ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, bashkitë kanë në drejtë të përftojnë një fond për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile (fond i cili vjen si një transfertë e kushtëzuar). Bazuar në këtë ligj, specifikisht neni 65 parashikon që *“bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 % të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.”*

Për vitin 2022 u parashikua alokimi i një fondi prej rreth 1 miliardë lekë për 61 bashkitë në vend dhe ndarë bashkive duke përdorur si kriter peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Për vitin 2022, bashkia Fier vlerësohet të ketë patur në dispozicion rreth 3.3% të këtij fondi. Megjithatë, nisur nga niveli aktual i shpenzimeve për funksionin “rendi dhe siguria publike”, vlerësohet se bashkia Fier nuk e ka përdorur tërësisht fondin e kushtëzuar në dispozicion. Për vitin 2023, bashkia Fier parashikoi alokimin e një fondi prej rreth 61 milionë lekë për emergjencat civile².


Krahas tyre, bashkitë duhet të planifikojnë në buxhetin vjetor, fonde për mbrojtjen civile deri në 1% të buxhetit të tyre³.

²

Burimi: Bashkia Fier, Vendim Nr. 122 datë 14/12/2023 Për miratimin e buxhetit të bashkisë Fier për vitin 2023.

3 Burimi: Shkresë dërguar Bashkive, Thesarit dhe Këshillit të Qarkut nga Drejtoria e Financave Vendore
22/12/2021, prot. nr. 23026.

Grafiku: 11 Transferta e kushtëzuar nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" (viti 2022)



Burimi: <https://arkiva.financa.gov.al/> dhe përpunime të autorëve

2.3 Donatorë, projekte, programe dhe mundësi të tjera financimi

Duke marrë në konsideratë kapacitetet e ulta financiare të bashkive në Shqipëri, veçanërisht për sektorin e mbrojtjes civile, ato nuk mund të financojnë me burimet e tyre projektet e parashikuara në këtë strategji apo edhe në strategji të përgatitura në sektorë të tjerë. Për këtë arsye Bashkia Fier mund të gjejë mundësi financimi në programe/projekte të mbështetura nga qeveria/institucionet Shqiptare apo donatorë të huaj. Më poshtë paraqitet një listë joshtruese e programeve, institucioneve të cilat financojnë projekte të lidhura me mbrojtjen civile.

Programe të AKMC: AKMC çdo vit hap thirrje për projekte nga bashkitë në fushën e mbrojtjes civile. Të gjitha bashkitë e territorit të Shqipërisë mund të aplikojnë për financimin e projekteve të ndryshme. Gjithashtu, AKMC në vitin 2024 ka hapur dhe një program të ri e të fokusuar në Diga. Kjo është një nismë e shkëlqyer edhe për bashkitë e Qarkut Fier duke marrë në konsideratë digat e ndryshme që gjenden në territorin e tyre si dhe nevojën imediate për ndërhyrje.

IPA South Adriatic: Programi ndërkuftar midis Shqipërisë – Italisë dhe Malit të Zi ofron mundësi të mira për bashkitë në të gjithë territorin e Shqipërisë për të qenë pjesë e projekteve dhe partneriteteve me institucione nga dy vendet e tjera pjesë e programit. Programi për periudhën 2021-2027 ka një buxhet total prej 81.258.768,19 Euro. Pjesë e aksioneve prioritare të programit është dhe prioriteti 2 i cili synon të promovojë Agjendën e Gjelbër për Adriatikun Jugor. Objektivi Strategjik 2.1 është drejtpërdrejtë i fokusuar tek përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimi i riskut të fatkeqësive. Gjithashtu, prioriteti 2 ka të alokuar dhe pjesën më të madhe të buxhetit të programit, përkatësisht çka nënkupton mundësi të mira për bashkitë për të avancuar agjendat e tyre në zvogëlimin e riskut. Në kuadër të këtij program priten të hapen

dhe dy thirrje për projekte, një thirrje e cila do të hapet në vitin 2024 për projekte standarde dhe një thirrje e pritshme të hapet në vitin 2025 për projekte në shkallë të vogël. Kjo do të thotë që bashkitë e Qarkut Fier, të cilat janë të lejuara të aplikojnë për këto projekte, kanë mundësi të mira për të

31

jetësuar disa nga masat e strategjive nëpërmjet këtyre thirrjeve. Është e rëndësishme që të kihet parasysh norma e bashkë-financimit e cila për projekte të tilla është minimumi 15%.

INTERREG Adrion: Është një tjetër program i rëndësishëm ku bashkitë e Qarkut Fier mund të marrin pjesë duke u bashkuar në partneritete të ndryshme në përgjigje të thirrjeve përkatëse. Në krahasim me programet ndërkufitare, INTERREG është më kompleks pasi kërkon partneritete më të zgjeruara dhe një kapacitet më të lartë institucional, gjithsesi, kjo nuk do të thotë që bashkitë nuk mund të aplikojnë apo nuk mund të llobojnë për të qenë pjesë e projekteve të ndryshme. Projektet janë të natyrave të ndryshme dhe përfshijnë si aktivitete për ngritje kapacitetesh ashtu edhe projekte të cilat synojnë ndërhyrje pilot. Në ngjashmëri me IPA South Adriatic, edhe në këtë rast, prioriteti 2 fokusohet tek Tranzicioni i Gjelbër, dhe veçanërisht objektivi 2.1 fokusohet tek rritja e aftësisë ripërtëritëse, ndryshimet klimatike dhe zvogëlimi i riskut të fatkeqësive.

INTERREG Euro-MED: Është një ndër programet më të rëndësishme të BE për bashkëpunimin ndër-rajonal. Ky program përfshin të gjitha vendet e Mesdheut dhe ka një buxhet mbi 290 milion Euro. Prioriteti 2 i programit “Mesdheu i Gjelbër”, fokusohet tek ndryshimet klimatike dhe zvogëlimi i riskut. Ashtu si INTERREG Adrion është një program kompleks por sërish bashkitë e Qarkut Fier mund të bëhen pjesë e partneriteteve të ndryshme. Parashikohen që të hapen thirrje për projekte në gjysmën e dytë të vitit 2024 dhe dy thirrje të tjera në vitin 2026, çka përbëjnë një mundësi të mirë për bashkitë për tu angazhuar në gjetjen e partnerëve dhe aplikimin për projekte të ndryshme. Fakti që bashkitë e Qarkut Fier do të kenë një Strategji të miratuar për Zvogëlimin e Riskut është një avantazh për të konkuruar dhe bërë pjesë e partneriteteve.

INTERREG Balkan-Med: Është një program relativisht i ri i BE i cili synon të mbështesë vendet e Ballkanit në Mesdhe. Shqipëria si pjesë e vendeve të cilat synojnë të futen në BE është pjesë e këtij programi dhe në të mund të aplikojnë për projekte bashki dhe institucione nga i gjithë territori. Ky program ka një buxhet më të reduktuar krahasimisht me Euro-MED por është një mundësi e mirë për bashkitë duke qenë se konkurrenca është më e vogël në krahasim me programin tjetër. Edhe në këtë rast, prioriteti 2 i cili fokusohet tek mjedisi ka objektiva të dedikuara për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.

Horizon Europe: Është programi më i madh i Bashkimit Evropian i cili financon kërkimin shkencor në fusha të ndryshme. Ky është një program shumë ambicioz dhe relativisht i vështirë për bashkitë që të bëhen pjesë. Gjithësesi, një mundësi e mirë në këtë rast është bashkëpunimi i bashkive të Qarkut Fier me institucione akademike e kërkimore në mënyrë që të futen në partneritet për të konkuruar. Kuptohet që duke qenë një program me një fokus kryesor në kërkim shkencor dhe inovacion roli i bashkive mund të jetë kryesisht në formën e pilotimit të

37

nismave të ndryshme dhe ngritjen e kapaciteteve. Veçanërisht në këtë kuadër janë të rëndësishme nisma nën ombrellën e BAUHAUS.

DG-ECHO: Është Departamenti i Komisionit Evropian për Mbrojtjen Civile dhe Ndhimën e Operacionet Humanitare. Shpesh, DG-Echo hap thirrje të ndryshme të cilat synojnë mbështetjen në rritjen e kapaciteteve apo të projekteve për përshtatjen për zvogëlimin e riskut. Në këtë rast, duke qenë se Shqipëria është pjesë e Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile, bashkitë kanë të drejtë që të jenë pjesëmarrëse në projekte. Gjithsesi, strategjikisht do të ishte mirë që bashkitë të koordinohen me AKMC në mënyrë që të jenë pjesë e projekt aplikimeve të përbashkëta. Bashkitë e Qarkut Fier duke pasur të hartuara Strategjitë e Zvogëlimin të Riskut kanë një avantazh konkurrues ndaj bashkive të tjera. Po ashtu, programet e DG-ECHO janë shumë të rëndësishme për të ofruar trajnime e mbështetje në rritjen e kapaciteteve.

IADSA: Është programi për Shkëmbimin e Borxhit midis Qeverisë Italiane dhe asaj Shqiptare. Në këtë program, bazuar në thirrje të ndryshme, bashkitë kanë të drejtë që të aplikojnë me projekte. Pjesë e prioritetëve të këtij programi është dhe mbështetja e bashkive për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike etj. Bashkitë në përgjithësi kanë eksperiencë me këtë program dhe mund të aplikojnë sipas thirrjeve të ndryshme.

Agjenci Zhvillimi Ndërkombëtare dhe Donatorë: Agjenci të ndryshme zhvillimi ndërkombëtare operojnë në Shqipëri prej vitesh si UNDP, GIZ, Sida, SDC, JICA etj. të cilat në programet e tyre synojnë edhe përmirësimin e kushteve të mjedisit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e riskut. Mbështetja mund të ofrohet nëpërmjet ndihmës së drejtpërdrejtë, ku bashkitë përzgjidhen nga vetë institucionet për mbështetje ose nëpërmjet aplikimeve apo granteve konkurruese. Bashkitë duhet të jenë të kujdesshme për të aplikuar në projekte të tilla ose për të lobuar për tu bërë pjesë e mbështetjes që ofrohet nga këto institucione. Gjithashtu, bashkitë duhet të koordinojnë me OSHC të cilat operojnë në territorin e tyre për ti orientuar që projektet të jenë në sinergji me objektivat strategjike e zhvillimore të bashkive.

3. Vizioni, qëllimi dhe objektivat strategjike

Vizioni i Strategjisë Vendore për ZRF në bashkinë Fier, shkon përtej kohëzgjatjes së kësaj strategjie dhe synon të udhëzojë vendimmarrësit dhe politikën lokale e sektoriale për marrjen e masave për parandalimin, përgjigjen dhe rimëkëmbjen e shpejtë nga fatkeqësitë. Nga ana tjetër vizioni vendos në fokusin e saj komunitetin dhe ndërveprimin e tij me autoritetet vendore si dy aktorët kryesor të cilët mund të marrin masa për parandalimin e risqeve në nivel vendor.

3.1 Vizioni

Bashkia Fier, një bashki me aftësi ripërtëritëse, komuniteti i të cilës ndërvepron, fuqizohet dhe përshtatet, për një zhvillim të qëndrueshëm e i aftë për të marrë masa parandaluese për ti bërë ballë fatkeqësive.

Një bashki e cila udhëheq me largpamësi, përkushtim, inovacion dhe bashkëpunon ndër-institucionalisht duke nxitur një kulturë të menaxhimit proaktiv të parandalimit të riskut, e vendosur standardet për përgatitjen efektive, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë duke siguruar një të ardhme të sigurt dhe të qëndrueshme për të gjithë banorët e saj.

3.2 Misioni

Misioni i strategjisë është bashkëpunimi me komunitetin dhe koordinimi i përpjekjeve dhe burimeve me qëllim mbrojtjen e jetës së qytetarëve, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, trashëgiminë kulturore dhe bërë ballë sfidave që sjellin ndryshimet klimatike.

Të fuqizojë strukturat institucionale dhe rrisë bashkëpunimin ndër-institucional të sistemit të mbrojtjes civile, me qëllim marrjen e masave për përgatitjen, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë duke u mbështetur tek një komunitet i fuqizuar dhe i ndërgjegjësuar për të marrë përsipër rol aktiv në të gjitha fazat e menaxhimit të risqeve dhe fatkeqësive.

Në përputhje me vizionin dhe misionin e Strategjisë Vendore dhe me Strategjinë Kombëtare ZRF 2023-2030, bashkia Fier ka hartuar objektivat strategjike të paraqitur si më poshtë:

OS1 - Rritja e kapaciteteve teknike, operacionale dhe forcimi i qëndrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF.

OS2 - Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet e cenueshme dhe gjithëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për parandalimin dhe përbalimin e fatkeqësive.

OS3 – Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbjen pas fatkeqësisë.

4. Projektet strategjike dhe masat

Me qëllim zbatimin dhe monitorimin e objektivave strategjike bashkia Fier ka hartuar dhe projektet strategjike të cilat paraqiten si më poshtë. Çdo projekt strategjik ka një sërë masash të parashikuara për realizimin e tij, masat janë kategorizuar në: a) masa (organizative), të cilat mund të realizohen nga stafi i bashkisë pa kosto; b) masa jo strukturore, të cilat mund të realizohen nga stafi i bashkisë dhe/ose ofruet shërbimesh por të cilat në të gjitha rastet kanë kosto për realizimin e tyre; c) masa strukturore, janë ndërhyrje në territor të cilat kanë një kosto specifike.

OS1	Rritja e kapaciteteve teknike, operacionale dhe forcimi i qëndrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF.
PS 1.1	Forcimi i kapaciteteve financiare të bashkisë për ZRF
Përshkrimi i projektit: Ky projekt ka për qëllim forcimin e kapaciteteve financiare të bashkisë me qëllim disbursimin e plotë të transfertës së kushtëzuar për ZRF dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë për përthithjen e fondeve për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.	

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

Masa		Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 1.1.1	Trajnimi i stafit për menaxhimin financiar i cili lidhet me ZRF.	Masë jo strukturore.	Nr. i punonjësve të trajnuar në vit. Nr. i trajnimeve të zhvilluara në vit.
M1.1.2	Identifikimi i bizneseve lokale, OSHC-ve dhe donatorëve të huaj për të gjetur mundësi financimi për projekte/mjete për ZRF	Masë jo strukturore.	Një bazë të dhënash e ngritur dhe e aksesueshme nga i gjithë stafi i bashkisë.
M 1.1.3	Kërkimi/aplikimi për grante për financimin e projekteve të cilat adresojnë Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.	Masë jo strukturore.	Nr. i projekt propozimeve të hartuara për ZRF në vit. Nr. i projekt propozimeve për ZRF të fituara në vit.
M 1.1.4	Studim për vendosjen e taksave/tarifave të përkohshme për adresimin e masave për parandalimin e risqeve.	Masë jo strukturore.	Propozimi dhe miratimi në KB për vendosjen e një takse të përkohshme për ZRF. Të ardhurat e përfuara në vit nga taksa.
M 1.1.5	Integrimi i ZRF në Planin Buxhetor Afatmesëm. Parashikimi në PBA për disbursimin e buxhetit për ZRF për tre vite.	Masë jo strukturore	Plani për disbursimin e ZRF për tre vite i përfshirë në PBA.
M 1.1.6	Parashikimi në buxhet për incentivimin monetar të grupit të vullnetarëve.	Masë jo strukturore.	Nr. i vullnetarëve të mbështetur financiarisht nga bashkia.
M 1.1.7	Parashikimi për pagesa shtesë për sigurimin e jetës për zjarrfikësit.	Masë jo strukturore.	Nr. i zjarrfikësve të cilët përftojnë pagesë shtesë.
M 1.1.8	Organizimi i konferencave të donatorëve për ZRF në nivel Qarku.	Masë jo strukturore.	Nr. i konferencave të organizuar në vit. Nr. i donatorëve që marrin pjesë.
M 1.1.9	Sigurimi i aseteve (objekte dhe tokë) dhe makinerive në pronësi të bashkisë. Masë jo strukturore Sigurimi i aseteve do të ulte ndjeshëm kostot për bashkinë në rast fatkeqësie.	Masë jo strukturore	Nr. i aseteve të siguruar në vit. % e buxhetit e cila shkon për sigurimin e aseteve në vit.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024-2030		

Prioritete: Për projektin strategjik 1 do të konsiderohej si prioritare rritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë për menaxhimin financiar të ZRF, aplikimi për grante/projekte si dhe sigurimi i aseteve të bashkisë me qëllim uljen e kostove në rast fatkeqësie.

OS1	Rritja e kapaciteteve teknike, operacionale dhe forcimi i qëndrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF.		
PS2	Forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të stafit të bashkisë për ZRF.		
Përshkrimi i projektit: Ky projekt synon forcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike të stafit me qëllim rritjen e ndërveprimit ndërmjet tyre dhe njohurive lidhur me masat paraprake dhe parandalimin e risqeve në bashkinë Fier.			
Masa		Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 1.2.1	Trajnimi i vazhduar i stafit të bashkisë dhe Komisionit të Mbrojtjes Civile për ZRF në fusha të tilla si: përdorimin e programit GIS, shkrimin e projekt propozimeve, menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve etj.	Masë jo strukturore.	Nr. i punonjësve të trajnuar në vit. Nr. i trajnimeve të zhvilluar në vit. Tipologjia e trajnimeve të zhvilluara në vit.
M 1.2.2	Rishikimi i PPV-së, strategjive dhe planeve sektoriale me fokus përshtatjen për ZRF.	Masë jo strukturore.	Nr. i dokumenteve të ripunuar duke përfshirë masat për ZRF.
M 1.2.3	Ngritja e bazës së të dhënave digjitale referuar metodologjisë së raportimit të AKMC	Masë jo strukturore.	Një bazë të dhënash në linjë me metodologjinë e AKMC e ngritur dhe funksionale.
M 1.2.4	Raportimi në bazë mujore për fatkeqësitë natyrore të ndodhura në territorin e bashkisë tek AKMC në formatin e përcaktuar.	Masë jo strukturore.	Nr. i raportimeve drejt AKMC në vit.
M 1.2.5	Formalizimi i kanaleve të komunikimit ndërmjet sektorit të mbrojtjes civile në bashki dhe atij në qark. (Rritja e komunikimit formal, nëpërmjet një formulari digjital të dakordësuar, të sektorit MC në bashki dhe Qark/Prefekturë do të lejonte gjurmimin e komunikimeve dhe plotësimin e bazës së të dhënave në kohë reale dhe rriste eficiencën e këtyre institucioneve në planifikim dhe përgjigje.	Masë jo strukturore.	Format i digjitalizuar i dakordësuar dhe funksional. Nr. i komunikimeve formale ndërmjet institucioneve në vit.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

Prioritete: Për projektin strategjik 2 do të konsiderohej si prioritare rritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë, hartimi dhe plotësimi i bazës së të dhënave pasi do të lejonte identifikimin e problematikave në kohë të shpejtë si dhe rishikimin e dokumenteve strategjike në nivel vendor për tu përshtatur me SVZRF.

OS1	Rritja e kapaciteteve teknike, operacionale dhe forcimi i qëndrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF.		
PS3	Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave të bashkisë Fier.		
Përshkrimi i projektit: Ky projekt synon ti mundësojë bashkisë një sërë dokumentesh, mjetesh të cilat i mundësojnë një përgjigje të shpejtë në rast emergjence.			
Masa		Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 1.3.1	Hartimi dhe përditësimi i planit të evakuimit për godinën e bashkisë Fier.	Masë jo strukturore	Plan evakuimi i hartuar dhe përditësuar.
M 1.3.2	Hartimi i planit të evakuimit në Teatrin Bylis.	Masë jo strukturore	Plan evakuimi i hartuar dhe përditësuar.
M 1.3.3	Hartëzimi i fatkeqësive dhe dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë ndër vite në aplikacionin GIS. Në bashkëpunim me ASIG për fenomene të ardhshme.	Masë jo strukturore	Fatkeqësitë dhe dëmet e shkaktuara prej tyre ndër vite të hartëzuara/digjitalizuara. Nr./lloji i fatkeqësive plotësisht të hartëzuara. Nr. i NjA të mbuluara me hartëzimin e plotë të fatkeqësive.
M 1.3.4	Hartimi dhe monitorimi i Planit për Emergjencat Civile në bashkinë Fier.	Masë jo strukturore	Plan për Emergjencat Civile i hartuar dhe miratuar.
M 1.3.5	Hartimi i planeve të evakuimit për të gjitha godinat e sistemit shkollor parauniversitar dhe parashkollor (kopshte dhe çerdhe).	Masë jo strukturore	Nr. i godinave të sistemit shkollor parauniversitar me plan evakuimi. Nr. i godinave të sistemit parashkollor me plan evakuimi.
M 1.3.6	Hartimi i planeve të evakuimit për të gjitha godinat e qendrave shëndetësore dhe spitaleve në territorin e bashkisë Fier.	Masë jo strukturore.	Nr. i godinave të qendrave shëndetësore dhe spitaleve me plan evakuimi.

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

M 1.3.7	Ngritja e sistemeve të alarmit të hershëm për zjarret në pyje në koordinim me kërkesat e AKMC. Prioritare NjA Cakran, Dërmenas, Levan.	Masë strukturore.	Një sistem i alarmit të hershëm i dakordësuar dhe funksional. Nr. i sensorëve të vendosur në territor. Sipërfaqja e mbuluar me sënsoresë. Nr. i ekonomive pyjore me sistem alarmi të hershëm. Sipërfaqja e ekonomive pyjore e mbuluar me sistem paralajmërimi.
M 1.3.8	Koordinimi ndërmjet bashkisë dhe bizneseve/industrive në sektorin teknologjik për paralajmërimin e hershëm të fatkeqësive.	Masë jo strukturore	Nr. i marrëveshjeve të bashkëpunimit të firmosura.
M 1.3.9	Krijimi i rezervave për emergjencat (rezerva ushqimore, çadra, tenda, shtretër). Krijimi i rezervave ushqimore dhe materialeve ndihmëse për akomodimin e qytetarëve në rast fatkeqësie.	Masë strukturore	Ton ushqime rezervë. Nr. i çadrave, shtretërve, tendave rezervë.
M 1.3.10	Ngritja e një Qendre Operacionale të mbrojtjes civile në Bashkinë Fier.	Masë strukturore	Një qendër operacionale e mbrojtjes civile e ngritur dhe funksionale.
M 1.3.11	Plotësimi i sektorit të mbrojtjes civile me pajisje teknologjike të tilla si	Masë strukturore.	Zyra e sektorit të MC e mobiluar dhe pajisur me mjete pune.
	pajisje kancelarie, kompjuter, tavolina pune dhe mjete motorike.		Nr. i mjeteve motorike të blera për sektorin e MC.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		


Prioritete: Për projektin strategjik 3 do të konsiderohej si prioritare plotësimi i sektorit të mbrojtjes civile me staf dhe pajisje, ngritja e një qendre operacionale e cila do të lejonte marrjen e masave në kohë si dhe hartimi e monitorimi i Planit për Emergjencat Civile në bashkinë Fier.





Figura 2: Paraqitje grafike e projekteve strategjike për OSI

OS1 Rritja e kapaciteteve teknike, operacionale dhe forcimi i qendrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF


PS1.1 PS1.2 PS1.3 PS1.4

PS1.1 - Forcimi i kapaciteteve financiare dhe alokuese të bashkisë për ZRF



-  Trajnimi i stafit për menaxhimin financiar i cili lidhet me ZRF.
-  Sigurimi i asteve (objekte dhe tokë) dhe makinerive në pronësi të bashkisë
-  Parashikimi për pagesa shtesë për sigurimin e jetës për për zjarfikësit
-  Parashikimi në buxhet për incentivimin monetar të grupit të vullnetarëve


PS1.2 - Forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të stafit të bashkisë për ZRF




Trajnimi i vazhduar i stafit të bashkisë dhe Komisionit të Mbrojtjes Civile për ZRF në fusha të tilla si:

- Përdorimin e programit GIS,
- Shkrimin e projekt propozimeve,
- Menaxhimine qendrueshëm të pyjeve

PS1.3 - Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave të bashkisë Fier



- Hartimi dhe monitorimi i Planit të Emergjencave Civile në bashkinë Fier
- Ngritja e një Qendre Operacionale të mbrojtjes civile në Bashkinë Fier
- Krijimi i rezervave për emergjencat



- Hartimi i planeve të evakuimit për:
- kopshtet dhe çerdhet
- shkollat 9-vjeçre
- shkollat e mesme
- qendrat shëndetësore
- institucionet në varësi të bashkisë

PS1.4 - Projekte ndërkufitare në nivel vendor për ZRF



Organizimi i konferencave të donatorëve për ZRF në nivel Qarku

Burimi: Punim i autorëve

OS.2.	Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet e cenueshme dhe gjithëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për të parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë.		
PS 1	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit.		
Përshkrimi i projektit: Ky projekt ka për qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit lidhur me masat për parandalimin, përgjigjen dhe rimëkëmbjen ndaj riskut të fatkeqësive.			
	Masa	Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 2.1.1	Trajnimi i komunitetit për ZRF në fusha të tilla si: pastrimin e kanaleve tretësore, menaxhimin e ekonomive pyjore, evakuimin e sigurt nga banesa, përgjigjen në rast tërmeti, zjarri, përmbytjeje etj.	Masë jo strukturore.	Nr. i qytetarëve të trajnuar në vit. Nr. i trajnimeve të zhvilluara në vit. Nr. i temave të trajtuara në vit.

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

M 2.1.2	Fushata ndërgjegjësimi për pastrimin e kanaleve tretësore, menaxhimin e pyjeve, përgjigjen në rast fatkeqësie.	Masë jo strukturore	Nr. i fushatave të ndërmarra. Nr. i popullatës së ndërgjegjësuar. Nr. çështjeve të mbuluara.
M 2.1.3	Hartimi dhe aprovimi i një kalendar për zhvillimin e trajnimeve/workshopeve me grupet e interesit.	Masë jo strukturore	Një kalendar i hartuar, aprovuar dhe funksional për zhvillimin e trajnimeve
M 2.1.4	Hartimi dhe aprovimi i moduleve/protokolleve të unifikuara të trajnimit të grupeve të interesit në bashkëpunim me AKMC.	Masë jo strukturore	Nr. i moduleve të hartuar. Nr. i moduleve të aprovuar.
M 2.1.5	Zhvillimi i fushatave informuese derë më derë, me fokus tek zonat e ekspozuara ndaj risqeve, për të informuar qytetarët për procedurat të cilat duhet të ndiqen në rast fatkeqësie.	Masë jo strukturore	Nr. i fushatave derë më derë të zhvilluara. Nr. i personave të informuar.
M 2.1.6	Zhvillimi, në mënyrë periodike i orëve mësimore, të lidhura me Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë me qëllim ndërgjegjësimin e brezave të ardhshëm.	Masë jo strukturore.	Nr. i orëve mësimore të zhvilluara në vit. Nr. i temave të trajtuara në vit. Nr. i shkollave në të cilat është zhvilluar trajnimi në vit. Nr. i nxënësve të ndërgjegjësuar.
M 2.1.7	Rritja e bashkëpunimit me TV dhe Radio lokale të cilat mund të shërbejnë për njoftimin e popullatës në rast fatkeqësie.	Masë jo strukturore	Nr. i daljeve në TV/Radio i punonjësve të MC për të informuar qytetarët në vit. Nr. i kornikave intervistave në TV/Radio të zhvilluara në vit.
M 2.1.8	Përdorimi i rrjeteve sociale të bashkisë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për paralajmërimin në rast fatkeqësie.	Masë jo strukturore	Nr. publikimeve në rrjetet sociale në vit.
M 2.1.9	Trajnimi i kryepleqve të fshatrave për të rritur kapacitetet e tyre në lidhje me ZRF.	Masë jo strukturore.	Nr. i trajnimeve të zhvilluara në vit. Nr. i kryepleqve të trajnuar në vit.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjat	2024 - 20230		

Prioritete: Për projektin strategjik 1 do të konsiderohej si prioritare ndërgjegjësimi i komuniteteve me fokus kryesor ato komunitetet të cilat gjenden pranë zonave të ekspozuara ndaj rrezikut, zhvillimi i orëve mësimore në shkolla për ndërgjegjësimin e brezave të ardhshëm dhe hartimi i moduleve të trajnimit në bashkëpunim me AKMC.

OS.2.	Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet e cënueshme dhe gjithëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për të parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë.
PS2	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve të cënueshme dhe gratë.

Përshkrimi i projektit: Ky projekt ka për qëllim ndërgjegjësimin dhe edukimin e grupeve të cënueshme dhe grave synon të ofrojë trajnime të përshtatura për nevojat specifike të grupeve të cënueshme, veçanërisht të grave, duke pasur në konsideratë se popullatat e cënueshme, duke përfshirë gratë, shpesh përballen me sfida dhe barriera unike për aksesin në shërbime dhe ndërgjegjësim për çështje të ndryshme si shëndeti, siguria, të drejtat dhe mundësitë.			
Masa		Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 2.2.1	Trajnime të cilat kanë në fokus grupet e cënueshme dhe gratë mbi përgjigjen në rast fatkeqësie.	Masë jo strukturore	Nr. i trajnimeve të zhvilluar. Nr. i temave të mbuluara. Grupet e cënueshme të trajnuar. Nr. i grave të trajnuara.
M 2.2.2	Zhvillimi i seanca praktike trajnimi mbi ndihmën e parë, procedurat e evakuimit nga ndërtesat publike e private me fokus të veçantë tek gratë dhe grupet e cënueshme.	Masë jo strukturore.	Nr. i seancave praktike të zhvilluara. Nr. i personave të përfshirë.
M 2.2.3	Zhvillimi i fushatave specifike ndërgjegjësuere për ZRF të cilat targetojnë grupet e cënueshme dhe gratë.	Masë jo strukturore	Nr. i fushatave të zhvilluara në një vit.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

Prioritete: Projekti strategjik 2 konsiderohet si prioritar pasi ka nevojë për më shumë aktivitetet trajnuese dhe ndërgjegjësuere të cilat kanë në fokus grupet e cënueshme dhe gratë.

OS.2.	Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet e cënueshme dhe gjithëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për të parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë.		
PS 3	Konsolidimi dhe trajnimi i grupeve vullnetare ne bashki.		
Përshkrimi i projektit: Ky projekt synon të konsolidojë grupin e vullnetarëve të cilët mund të përfshihen nga bashkia në aktivitete të ndryshme në rast fatkeqësie dhe trajnimin e tyre për të rritur kapacitetet për tu përgjigjur në kohë dhe mënyrën e duhur emergjencave.			
Masa		Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 3.2.1	Ngritja e një baze digjitale të dhënash për regjistrimin e grupeve vullnetare për ZRF.	Masë jo strukturore	Një bazë digjitale e ngritur dhe e populluar.
M 3.2.2	Trajnimi i grupeve vullnetare mbi ZRF në koordinim me modulet e përgatitura nga AKMC.	Masë jo strukturore	Nr. i vullnetarëve të trajnuar në vit. Nr. i trajnimeve të zhvilluara në vit.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

Figura 3: Paraqitje grafike e projekteve strategjike për OS2

OS2 Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet më të cënueshme dhe githëpërfshirjen, për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për të parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë



PS2.1 - Ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit mbi ZRF



Zhvillimi i trajnimeve me qytetarët e grup-moshave të ndryshme, me fokus ZRF, të tilla si:

- Trajnimi i qytetarëve mbi risqe specifike
- Trajnimi i komunitetit mbi pastrimin e kanaleve tretësore
- Trajnimi i komunitetit mbi menaxhimin e ekonomive pyjore
- Trajnimi i komunitetit për shërbimet e ekosistemit me fokus shkollat 9 vjeçare dhe të mesme
- Trajnimi i kryepleqve të fshatrave për të rritur kapacitetet e tyre në lidhje me ZRF



Fushata ndërgjegjësimi

PS2.2 - Ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vulnerable dhe grave



Trajnime të cilat kanë në fokus grupet vulnerable dhe gratë mbi reagimin në rast fatkeqësie



Zhvillimi i seanca praktike trajnimi mbi ndihmën e parë, procedurat e evakuimit nga ndërtesat publike e private me fokus të veçantë tek gratë dhe grupet vulnerable



Zhvillimi i fushatave specifike ndërgjegjësuere për ZRF të cilat targetojnë grupet vulnerable dhe gratë

PS2.3 - Konsolidimi dhe tajnimi i grupeve vullnetare në bashki



Ngritja e një baze digjitale të dhënash për regjistrimin e grupeve vullnetare për ZRF



Trajnimi i grupeve vullnetare mbi ZRF në koordinim me modulet e përgatitura nga AKMC

Burimi: Punim i autorëve

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

OS.3.	Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë.		
PS 1	Rritja e gatishmërisë dhe kapaciteteve parandaluese ndaj përmbytjeve		
Përshkrimi i projektit: Projekti synon marrjen e masave të cilat synojnë parandalimin dhe zbutjen e riskut nga përmbytja në Bashkinë Fier. Nën këtë projekt parashikohen një sërë masash të cilat përmirësojnë infrastrukturën, rrisin kapacitetet menaxhuese të punonjësve dhe i japin atyre mjetet e nevojshme për të parandaluar e menaxhuar riskun nga përmbytjet në bashki.			
Masa		Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 3.1.1	Hartimi i një protokollit të standardizuar për monitorimin e vazhdueshëm të kanaleve kulluese dhe vaditëse në pronësi të bashkisë.	Masë jo strukturore.	Një protokoll monitorimi i hartuar dhe i aprovuar (AKMC/Bashki) për monitorimin e kanaleve kulluese e vaditëse.
M 3.1.2	Monitorimi periodik i kanaleve parësore (në pronësi të bashkisë), dytësore dhe tretësore duke u bazuar në një kalendar të unifikuar (sektori i mbrojtjes civile, drejtoria e bujqësisë, bordi i kullimit dhe ujitjes).	Masë jo strukturore.	Një kalendar monitorimi i hartuar dhe i miratuar; Nr. i monitorimeve të kryera në vit.
M 3.1.3	Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së argjinaturave të lumit Seman dhe Vjosë. Vlerësim përshkrues nga ana e stafit të bashkisë e cila më pas i dërgohet në formë zyrtare bordit të kullimit në nivel Qarku	Masë jo strukturore.	Nr. i monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera në vit në lumin Seman dhe Vjosë.
M 3.1.4	Hartimi i një plani evakuimi të banorëve të fshatit Ferras në rast përmbytjeje. Në rast përmbytje, përmbyten mesatarisht 300-400 ha tokë. (kërkesë nga banorët)	Masë jo strukturore.	Një plan evakuimi i hartuar për fshatin Ferras.
M 3.1.5	Hartimi i pasaportës së gjendjes së rezervuarve dhe digave në pronësi të bashkisë; (Një vlerësim vizual nga ana e stafit të bashkisë për gjendjen e digës)	Masë jo strukturore.	Nr. i digave në pronësi të bashkisë me pasaportë të gjendjes së tyre.
M 3.1.6	Vlerësimi teknik i digave dhe rezervuarëve në pronësi të bashkisë	Masë jo strukturore.	Nr. i digave dhe rezervuarëve të vlerësuar.
M 3.1.7	Vlerësimi teknik i digës së rezervuarit të Libofshës. Në rast pamundësie për ti kryer për të gjithë digat në territorin e bashkisë nga vlerësimi i riskut kjo digë është cilësuar si prioritare nga ana e banorëve.	Masë jo strukturore.	Një vlerësim teknik për rezervuarin dhe digën e Libofshës i hartuar.
M 3.1.8	Vlerësimi teknik i digës së rezervuarit të Lalarit. Në rast pamundësie për ti kryer për të gjithë digat në territorin e	Masë jo strukturore.	Një vlerësim teknik për rezervuarin dhe digën e Lalarit i hartuar.

	bashkisë nga vlerësimi i riskut kjo digë është cilësuar si prioritare nga ana e banorëve.		
M 3.1.9	Studim inxhinierik për gjendjen e urave në pronësi të bashkisë.	Masë jo strukturore	Nr. i urave të bashkisë të cilat kanë një studim inxhinierik për vlerësimin e gjendjes së tyre.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

Prioritete: Për projektin strategjik 1 do të konsiderohej si prioritare vlerësimi i strukturës së digave dhe rezervuarëve në territorin e bashkisë e më pas marrja e masave për adresimin e problematikave duke qenë se dështimi i digave do të sillte pasoja për komunitetet dhe mjedisin. Gjithashtu një vlerësim i gjendjes së urave në pronësi të bashkisë konsiderohet një prioritet pasi në rast shembjeje mund të ndërpresë komunikimin me një apo disa territore të bashkisë.

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

OS.3.	Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë.		
PS 2	Zvogëlimi, zbutja e pasojave të mundshme negative të rrëshqitjeve		
Përshkrimi i projektit: Projekti synon marrjen e masave të cilat zvogëlimin dhe zbutjen e pasojave të rrëshqitjeve në territorin e bashkisë Fier duke kombinuar vlerësimin e riskut në Nj.A. të cilat janë më të ekspozuara dhe marrjen e masave inxhinierike për parandalimin e riskut.			
	Masa	Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 3.2.1	Studim gjeologjik i strukturës së tokës me rrezik rrëshqitje, referuar të dhënave historike në NjA Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz;	Masë jo strukturore.	Një studim i strukturës së tokës në zonat me rrezik rrëshqitje.
M 3.2.2	Aplikimi i masave për reduktimin e rrëshqitjeve në NjA Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz.	Masë strukturore	Nr. i projekteve të zbatuara për reduktimin e rrëshqitjeve në NjA Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz. Sipërfaqja e rrezikuar e NjA në të cilat janë marrë masa në raport me sipërfaqe totale të rrezikuar.
M 3.2.3	Aplikimi i masave për zbutjen e erozionit në njësitë NjA Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz.	Masë strukturore	Nr. i ndërhyrjeve në NjA për zbutjen e erozionit.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

Prioritete: Për projektin strategjik 2 do të konsiderohej si prioritare aplikimi i masave për reduktimin e erozionit dhe rrëshqitjeve në NjA Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz.

OS.3.	Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë.		
PS 3	Parandalimi dhe përmirësimi i menaxhimit të riskut nga zjarri		
Përshkrimi i projektit: Projekti synon marrjen e masave të cilat parandalojnë dhe përmirësojnë menaxhimin e zjarreve nëpërmjet plotësimit të dokumentacionit për menaxhimin e pyjeve dhe zbatimin e ndërhyrjeve në territorin e bashkisë Fier.			
	Masa	Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 3.3.1	Përgatitja e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve;	Masë jo strukturore	Nr. i ekonomive pyjore të cilat kanë plan menaxhimi.

M 3.3.2	Hartimi i planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor.	Masë	Një plan masash për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve.
M 3.3.3	Ndërtimi i kullave të vëzhgimit në zonat më problematike të territorit të NjA Cakran, Dërmenas, Levan.	Masë strukturore	Nr. i kullave për ekonomi pyjore. Sipërfaqja e ekonomisë pyjore e mbuluar me kulla vrojtimi në raport me totalin e ekonomisë.
M 3.3.4	Ripyllëzimi i zonave të dëmtuara nga zjarret ndër vite.	Masë strukturore	Sipërfaqja e zonave të mëtura të mbjella. Nr. i projekteve të ripyllëzimit të zbatuara.
M 3.3.5	Pajisja e sektorit të Shërbimeve të Mbrojtjes nga Zjarri, MZSH me mjete si pompa shpine, motosharra, sëpata, lopata, veshje mbrojtëse, makina.	Masë strukturore	Lloji dhe sasia e mjeteve në dispozicion të MZSH
M 3.3.6	Pozicionimi i hidrantëve për furnizim me uji të mjeteve të MZSH në brendësi të zonave të mbrojtura.	Masë Strukturore.	Nr. i hidrantëve të vendosur në brendësi të ZM. Nr. i ZM-ve i pajisur me hidrantë.
M 3.3.7	Hapja e rrugëve pyjore të për të aksesuar më lehtësisht ekonomitë pyjore.	Masë strukturore.	Nr. i ekonomive pyjore me rrugë pyjore. Rrugë pyjore të hapura në vit.
M 3.3.8	Trajnimi I stafit të MZSH.	Masë jo strukturore.	Nr. i punonjësve të trajnuar në vit. Nr. dhe lloji i trajnimeve të zhvilluara në vit.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

Prioritete: Për projektin strategjik 3 do të konsiderohej si prioritare hartimi i planeve të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, hapja e rrugëve pyjore dhe pajisja me mjete e sektorit të MZSH.

PS4	Rritja e gatishmërisë dhe përgjigjes së bashkisë Fier ndaj riskut sizmik		
Përshkrimi i projektit: Projekti synon rritjen e gatishmërisë dhe përgjigjes të bashkisë ndaj risqeve sizmike duke u fokusuar në vlerësimin e infrastrukturës (godina, banesa individuale, godina në pronësi të bashkisë, monumentet e kulturës etj.) dhe ndërgjegjësimin e komunitetit me qëllim përgjigjen e shpejtë në rast fatkeqësie.			
Masa		Lloji i masës	Tregues Monitorimi
M 3.4.1	Studim inxhinjrik për ndërtesat me moshë mbi 50 vjeçare me fokus kryesor NjA Fier (Rreth 4,455 ndërtesa të ndërtuara përpara vitit 1990 vetëm në NjA Fier).	Masë jo strukturore.	Nr. i ndërtesave për të cilat ka një vlerësim.
M 3.4.2	Studim inxhinjrik për ndërtesat me rëndësi të veçantë (godina në pronësi të bashkisë, monumente kulturore, infrastruktura kritike)	Masë jo strukturore	Nr. i ndërtesave për të cilat ka një studim për secilën tipologji.
M 3.4.3	Studim sizmik për ndërtesat informale në territorin e bashkisë.	Masë jo strukturore	Nr. i ndërtesat informale për të cilat ka një studim.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

OS.3.	Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë		
PS5	Zbutja e impaktit të ngjarjeve me shumë risqe/multirisik		
Përshkrimi i projektit: Projekti synon rritjen e ndërgjegjësimin të grupeve të interesit lidhur me ngjarjet me shumë risqe duke kombinuar masa për vlerësimin e pikave të nxehta teknologjike, monitorimin e parametrevë mjedisor dhe ndërgjegjësimin komunitar.			
Masa			Tregues Monitorimi
M 3.5.1	Vlerësimi dhe hartëzimi i pikave të nxehta/hot-spoteve teknologjike në territorin e bashkisë Fier.	Masë jo strukturore	Nr. i pikave të nxehta teknologjike i digitalizuar dhe i hartëzuar. Nr. i pikave të nxehta

			teknologjike të vlerësuara.
--	--	--	-----------------------------

M 3.5.2	Vendosja e këndeve të informimit në qendrat e fshatrave për afishimin e njoftimeve për ZRF.	Masë strukturore	Nr. i këndeve informues të vendosur në territorin e bashkisë. Nr. i fshatrave në të cilin janë vendosur kënde informimi.
M 3.5.3	Kryerja në mënyrë periodike e matjes së cilësisë së ajrit, ndotjes së tokave bujqësore dhe ujërave sipërfaqësore nga bashkia Fier.	Masë jo strukturore	Nr. i monitorimeve të kryera në vit për komponent specifik.
M 3.5.4	Kryerja e një studimi pilot për të evidentuar problematika të shëndetit të banorëve të cilët banojnë pranë vendburimeve të naftës me fokus të veçantë gratë dhe grupet e cenushme.	Masë jo strukturore	Një studim mbi impaktin e ndotjes nga industria e hidrokarbureve në shëndetin e qytetarëve i realizuar.
M 3.5.5	Vlerësim i impaktit mjedisor i puseve të shpimit në territorin e bashkisë Fier	Masë jo strukturore	Nr. i pus-shpimeve të cilët kanë një vlerësim mjedisor.
M 3.5.6	Krijimi i rezervave ujore në rast fatkeqësie. Duke qenë se një pjesë e territorit të bashkisë Fier furnizohet me ujë nga burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore pranë lumenjve kryesor të bashkisë ato mund të jenë subjekt ndotje teknologjike e bakteriologjike. Ndotja e tyre do të linte një pjesë të popullsisë pa ujë sanitar. Marrja e masave për krijimin e rezervave ujore për fshatrat NjA më të ekspozuara do të ishte një masë parandaluese e cila do të adresonte problematikën e ujit sanitar për banorët.	Masë strukturore.	Nr. i depozitave ujore të ngritura/ndërtuara. Litra ujë sanitar i disponueshëm për banorë.
M 3.5.7	Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve shëndetësore në territorin e bashkisë Fier për përballimin e një epidemie të mundshme (bashkëpunim sektori i mbrojtjes civile, shëndetësia).	Masë jo strukturore	Një raport vlerësimi mbi kapacitetet përballuese të institucioneve shëndetësore në bashkinë Fier në rast epidemie.

M 3.5.8	Vlerësimi teknik i stacioneve të pompimit për sigurimin e ujit të pijshëm. (kjo mund të bëhet edhe nga bashkia)	Masë jo strukturore	Nr. i stacioneve të pompimit të ujit të pijshëm të vlerësuar.
M 3.5.9	Vlerësimi mjedisor i gjendjes së Ish Uzinës së Plehrave Azotike në Fier për shkak se në të janë depozituar mbetje të lëndëve si bakër dhe amoniak.	Masë jo strukturore	Një vlerësim mjedisor për Ish Uzinës së Plehrave Azotike në Fier i hartuar.
M 3.5.10	Vlerësimi i zonës përreth ish Zonës Industriale Fier, në të cilën ushtron aktivitetin Rafineria e Naftës.	Masë jo strukturore	Një vlerësim mjedisor për ish Zonës Industriale Fier i hartuar
M 3.5.11	Vlerësimi i të gjithë pus shpimeve, në pronësi të bashkisë, për ujë të pijshëm në territorin e bashkisë Fier për të vlerësuar cilësinë e ujërave	Masë jo strukturore	Nr. i pus-shpimeve të vlerësuar për gjendjen e tyre funksionale.
M 3.5.12	Vlerësim i ndotjes së tokave bujqësore dhe kalimit të elementëve të ndotjes potenciale tek zinxhiri ushqimor.	Masë jo strukturore	Nr. i monitorimeve të tokës bujqësore në vit. Nr. i studimeve për ndotjen e tokës bujqësore në vit.
M 3.5.13	Vlerësimi i impaktit të risqeve nga fatkeqësitë në objektet e trashëgimisë kulturore në varësi të bashkisë.	Masë jo strukturore.	Nr. i objekteve të vlerësuar.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

Prioritete: Për projektin strategjik 5 do të konsiderohej si prioritare vlerësimi i hotspotëve mjedisore (kryesisht të lidhur me industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve) dhe impaktit që ato kanë në shëndetin e qytetarëve dhe në mjedis. Gjithashtu si prioritare do të konsiderohej edhe vlerësimi i puseve të shpimit (në pronësi të bashkisë) që furnizojnë me ujë të pijshëm komunitetin, ku në rast kontaminimi do të kishim një epidemi të mundshme.

M 3.6.1	Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në burimet natyrore (toka, uji, pyjet) të bashkisë Fier	Masë jo strukturor e	Një raport mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në burimet natyrore të bashkisë Fier.
M 3.6.2	Vlerësimi i impaktit të ndikimit të rritjes së nivelit të detit në komunitetet bregdetare në Bashkinë e Fierit. Fokus i veçantë përparimi i detit në grykëderdhjen e lumit Seman.	Masë jo strukturor e	Një vlerësim mbi inpaktin mbi ndryshimet e nivelit të detit në komunitetet
M 3.6.3			Një vlerësim për riskun ndaj thatësirave dhe inpaktit në sektorin e bujqësisë.

	Vlerësimi i riskut të thatësirave, në sektorin e bujqësisë, në kontekstin e ndryshimeve klimatike në bashkinë Fier.	Masë jo strukturor e	
--	---	----------------------	--

OS.3.	Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë
-------	---

PS6	Vlerësimi i impaktit të ndryshimeve klimatike në territorin e bashkisë dhe aplikimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë për zbutjen e impakteve negative
-----	--


Përshkrimi i projektit: Projekti synon të vlerësojë impaktin e ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm të bashkisë Fier si një nga bashkitë e cila vlerësohet si e ekspozuar ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Gjithashtu në fokus është edhe paraqitja e masave për zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike duke zbatuar praktika miqësore me natyrën/zgjidhje të bazuara në natyrë.

Masa		Tregues Monitorimi
------	--	---------------------------

M 3.6.4	Vlerësimi i ndikimit të ishujve të nxehtë urban në bashkinë Fier	Masë jo strukturor e	Një raport mbi ndikimin e ishujve të nxehtë urbanë në qytetin e fierit.
M 3.6.5	Studim mbi implementimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë (NbS) për reduktimin e riskut nga rrëshqitjet, përmytjet, erozionin lumor etj.	Masë jo strukturor e	Një raport mbi potencialet dhe përfitimet e zbatimit të zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe praktika të mira për aplikimin e tyre.
M 3.6.6	Hartimi i Planit Lokal të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike	Masë jo strukturor e	1 Plan Lokal i hartuar dhe i konsultuar me grupet e interesit.
Buxheti	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2024 - 2030		

Prioritete: Për projektin strategjik 6 do të konsiderohej si prioritare vlerësimi i përparimit të detit me fokus kryesor në grykëderdhjen e lumit Seman, hartimi i Planit Lokal të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe impakti që kanë thatësirat në sektorin e bujqësisë.

Figura 4: Paraqitje grafike e projekteve strategjike për OS3



Burimi: Punim i autorëve

5. Plani i veprimit dhe hapësira financiare

Nr.	Objektivi Strategjik	Projekte Strategjike	Masa Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030		Koha	Institucionet	Kosto		Gepi financiar		
			(vit)	Bashkia	Institucionet kontribuuese	EUR	USD	EUR	USD		
1		Forcimi i kapaciteteve financiare dhe disbursuese të bashkisë për ZRF	M 1.1.1	Trajnimi i stafit për menaxhimin financiar i cili lidhet me ZRF.	2024 - 2030	Fier	AKMC, UNDP, Donatorë	20000		15000	
			M 1.1.2	Identifikimi i bizneseve lokale, OSHC-ve dhe donatorëve të huaj për të gjetur mundësi financimi për projekte/mjete për ZRF	2024 - 2030	Fier		0		0	
			M 1.1.3	Kërkimi/aplikimi për grante për financimin e projekteve të cilat adresojnë Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.	2024 - 2030	Fier	AKMC, OSHC	0		0	
			M 1.1.4	Studim për vendosjen e taksave të përkohshme për adresimin e masave për parandalimin e risqeve	2024 - 2030	Fier		20000		20000	
			M 1.1.5	Integrimi i ZRF në Planin Buxhetor Afatmesëm. Parashikimi në PBA për disbursimin e buxhetit për ZRF për tre vite.	2024 - 2030	Fier		0		0	
			M 1.1.6	Parashikimi në buxhet për incentivimin monetar të grupit të vullnetarëve.	2024 - 2030	Fier	Donatorë	20000		10000	
			M 1.1.7	Parashikimi për pagesa shtesë për sigurimin e jetës për zjarrfikësit.	2024 - 2030	Fier		50000		50000	
			M 1.1.8	Organizimi i konferencave të donatorëve për ZRF në nivel Qarku.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë	10000		10000	

Rritja e kapaciteteve teknike, operationale dhe forcimi i qendrueshmërisë financiare për të marrë masa paraprake, përgatitur dhe përgjigjur në mënyrë efektive për ZRF.

Forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të	M 1.1.9	Sigurimi i asetëve (objekte dhe tokë) dhe makinerive në pronësi të bashkisë. Sigurimi i asetëve do të ulte ndjeshëm kostot për bashkinë në rast fatkeqësie.	2024 - 2030	Fier		50000		50000
	M 1.2.1	Trajnimi i vazhduar i stafit të bashkisë dhe Komisionit të Mbrojtjes Civile për ZRF në fusha të tilla si: përdorimin e programit GIS, shkrimin e projekt propozimeve, menaxhimine qëndrueshëm të pyjeve etj.	2024 - 2030	Fier	AKMC, UNDP, Donatorë	30000		15000

M 1.2.2	Rishikimi i PPV-së, strategjive dhe planeve sektoriale me fokus përshtatjen për ZRF.	2024 - 2026	Fier	Bashkia	0		0	
M 1.2.3	Ngritja e bazës së të dhënave digjitale referuar metodologjisë së raportimit të AKMC	2024 - 2025	Fier	Bashkia, AKMC	0		0	
M 1.2.4	Raportimi në bazë mujore për fatkeqësitë natyrore të ndodhura në territorin e bashkisë tek AKMC në formatin e përcaktuar.	2024 - 2030	Fier	AKMC	0		0	
M 1.2.5	Formalizimi i kanaleve të komunikimit ndërmjet sektorit të mbrojtjes civile në bashki dhe atij në qark. (Rritja e komunikimit formal, nëpërmjet një formulari digjital të dakordësuar, të sektorit MC në bashki dhe Qark/Prefekturë do të lejonte gjurmimin e komunikimeve dhe plotësimin e bazës së të dhënave në kohë reale dhe rriste eficiencën e këtyre institucioneve në planifikim dhe përgjigje.	2024 - 2030	Fier	Prefektura, Këshilli i Qarkut	0		0	
M 1.3.1	Hartimi dhe përditësimi i planit të evakuimit për godinën e bashkisë Fier.	2024 - 2026	Fier		0		0	
M 1.3.2	Hartimi i planit të evakuimit në Teatrin Bylis.	2024 - 2026	Fier		5000		5000	

Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave të bashkisë Fier.

M 1.3.3	Hartëzimi i fatkeqësive dhe dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë ndër vite në aplikacionin GIS. Në bashkëpunim me ASIG për fenomene të ardhshme.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, ASIG	0		0	
M 1.3.4	Hartimi dhe monitorimi i Planit për Emergjencat Civile në bashkinë Fier.	2024 - 2026	Fier	Bashkia, UNDP, RESEAL, AKMC	0		0	

1.3.5	Hartimi i planeve të evakuimit për të gjitha godinat e sistemit shkollor parauniversitar dhe parashkollor (kopshte dhe çerdhe).	2024 - 2026	Fier	Donatorë, Bashkia, Drejtoria Rajonale Arsimore,	20000		20000	
1.3.6	Hartimi i planeve të evakuimit për të gjitha godinat e qendrave shëndetësore dhe spitaleve në territorin e bashkisë Fier.	2024 - 2026	Fier	Donatorë, Bashkia, Drejtoria Rajonale e Shëndetit	20000		20000	
1.3.7	Ngritja e sistemeve të alarmit të hershëm për zjarret në pyje në koordinim me kërkesat e AKMC.	2024 - 2030	Fier	Donatorë, Agjencia kombëtare e Pyjeve, AKMC	75000		75000	
1.3.8	Koordinimi ndërmjet bashkisë dhe bizneseve/industrive në sektorin teknologjik për lajmërimin e hershëm të fatkeqësive.	2024 - 2026	Fier	Bashkia, Industritë dhe bizneset lokale	0		0	
1.3.9	Krijimi i rezervave për emergjencat (rezerva ushqimore, çadra, tenda, shtretër). Krijimi i rezervave ushqimore dhe materialeve ndihmëse për akomodimin e qytetarëve në rast fatkeqësie.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë, Biznese lokale	50000		50000	
1.3.10	Ngritja e një Qendre Operacionale të Emergjencave civile në Bashkinë Fier.	2024 - 2027	Fier	Bashkia, AKMC, UNDP	0		0	
1.3.11	Plotësimi i sektorit të mbrojtjes civile me pajisje teknologjike të tilla si pajisje kancelarie, kompjuter, tavolinë pune dhe mjete motorike.	2024 - 2026	Fier	Bashkia, Donatorë, Biznese	30000		30000	

2

për të nxitur një kulturë bashkëpunimi për të parandaluar dhe përballuar fatkeqësitë.

Ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit.

2.1.1	Trajnimi i komunitetit për ZRF në fusha të tilla si: pastrimin e kanaleve tretësore, menaxhimin e ekonomive pyjore, evakuimin e sigurt nga banesa, përgjigjen në rast tërmeti, zjarri, përmbytjeje etj.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë, OSHC, AKMC	20000		20000	
2.1.2	Fushata ndërgjegjësimi për pastrimin e kanaleve tretësore, menaxhimin e pyjeve, përgjigjen në rast fatkeqësie.	2024 - 2030	Fier	Bashkia	20000		20000	
2.1.3	Hartimi dhe aprovimi i një kalendari për zhvillimin e trajnimeve/workshopeve me grupet e interesit.	2024 - 2030	Fier	Bashkia	0		0	
2.1.4	Hartimi dhe aprovimi i moduleve/protokolleve të unifikuara të trajnimit të grupeve të interesit në bashkëpunim me AKMC.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, AKMC	0		0	
2.1.5	Zhvillimi i fushatave informuese derë më derë, me fokus tek zonat e ekspozuara ndaj risqeve, për të informuar qytetarët për procedurat të cilat duhet të ndiqen në rast fatkeqësie.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, OSHC	5000		5000	

Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit, me fokus grupet e cënueshme dhe gjithëpërfshirjen,

2.1.6	Zhvillimi, në mënyrë periodike i orëve mësimore, të lidhura me Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë me qëllim ndërgjegjësimin e brezave të ardhshëm.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Drejtoria Rajonale e Arsimit	10000		0	
-------	---	-------------	------	---------------------------------------	-------	--	---	--

	2.1.7	Rritja e bashkëpunimit me TV dhe Radio lokale të cilat mund të shërbejnë për njoftimin e popullatës në rast fatkeqësie.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, TV lokale	0		0	
	2.1.8	Përdorimi i rrjeteve sociale të bashkisë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për paralajmërimin në rast fatkeqësie.	2024 - 2030	Fier	Bashkia	0		0	
	2.1.9	Trajnimi i kryepleqve të fshatrave për të rritur kapacitetet e tyre në lidhje me ZRF.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, AKMC	10000		10000	
Ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve të cënueshme dhe grave.	M 2.2.1	Trajnime të cilat kanë në fokus grupet e cënueshme dhe gratë mbi përgjigjen në rast fatkeqësie.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë, OSHC, AKMC	10000		10000	
	M 2.2.2	Zhvillimi i seancave praktike të trajnimit mbi ndihmën e parë, procedurat e evakuimit nga ndërtesat publike e private me fokus të veçantë tek gratë dhe grupet e cënueshme	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Kryqi i Kuq	30000		30000	
	M 2.2.3	Zhvillimi i fushatave specifike ndërgjegjësuere për ZRF të cilat targetojnë grupet e cënueshme dhe gratë.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Kryqi i Kuq, OSHC	10000		10000	

	Konsolidimi dhe trajnimi i grupit të bashki.	M 2.3.1	Ngritja e një baze digjitale të dhënash për regjistrimin e grupeve vullnetare për ZRF.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Kryqi i Kuq	0		0	
--	--	------------	--	-------------	------	----------------------	---	--	---	--

			M 2.3.2	Trajnimi i grupeve vullnetare mbi ZRF në koordinim me modulet e përgatitura nga AKMC.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Kryqi i Kuq, AKMC	30000		30000	
3	Planifikimi i ndërhyrjeve në territor për të parandaluar dhe zbutur riskun, si dhe për të marrë masa për rimëkëmbje pas fatkeqësisë.	Rritja e gatishmërisë dhe kapaciteteve parandaluese ndaj përmbyrjeve	M 3.1.1	Hartimi i një protokollit të standardizuar për monitorimin e vazhdueshëm të kanaleve kulluese dhe vaditëse në pronësi të bashkisë.	2024- 2025	Fier	Bashkia	0		0	
M 3.1.2			Monitorimi periodik i kanaleve parësore (në pronësi të bashkisë), dytësore dhe tretësore duke u bazuar në një kalendar të unifikuar (sektori i mbrojtjes civile, drejtoria e bujqësisë, bordi i kullimit dhe ujitjes).	2024 - 2030	Fier	Bashkia	0		0		
M 3.1.3			Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së argjinaturave të lumit Seman dhe Vjosë. Vlerësim përshkrues nga ana e stafit të bashkisë e cila më pas i dërgohet në formë zyrtare bordit të kullimit në nivel Qarku	2024 - 2030	Fier	Bashkia	0		0		
M 3.1.4			Hartimi i një plani evakuimi të banorëve të fshatit Ferras në rast përmbyrjeje. Në rast përmbyrjeje, përmbyten mesatarisht 300-400 ha tokë. (kërkesë nga banorët).	2024- 2025	Fier	Bashkia	10000		0		
M 3.1.5			Hartimi i pasaportës së gjendjes së rezervuarve dhe digave në pronësi të bashkisë; (Një vlerësim vizual nga ana e stafit të bashkisë për gjendjen e digës)	2024- 2025	Fier	Bashkia	0		0		
M 3.1.6			Vlerësimi teknik i digave dhe rezervuarëve në pronësi të bashkisë	2024- 2026	Fier	Bashkia, Donatorë	75000		50000		

	M 3.1.7	Vlerësimi teknik i digës së rezervuarit të Libofshës. Në rast pamundësie për ti kryer për të gjithë digat në territorin e bashkisë nga vlerësimi i riskut kjo digë është cilësuar si prioritare nga ana e banorëve.	2024-2026	Fier	Bashkia, Donatorë	15000		15000	
	M 3.1.8	Vlerësimi teknik i digës së rezervuarit të Lalarit. Në rast pamundësie për ti kryer për të gjithë digat në territorin e bashkisë nga vlerësimi i riskut kjo digë është cilësuar si prioritare nga ana e banorëve.	2024-2026	Fier	Bashkia, Donatorë	15000		15000	
	M 3.1.9	Studim inxhinierik për gjendjen e urave në pronësi të bashkisë.	2024-2026	Fier	Bashkia, Donatorë	80000		80000	
	M 3.2.1	Studim gjeologjik i strukturës së tokës me rrezik rrëshqitje, referuar të dhënave historike në NjA Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz;	2024-2026	Fier	Bashkia, Donatorë	50000		50000	
	M 3.2.2	Aplikimi i masave për reduktimin e rrëshqitjeve në NjA. Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz.	2024-2026	Fier	Bashkia, Donatorë	Sipas studimit			

M

	Zvogëlimi, zbutja e pasojave të mundshme negative të rrëshqitjeve	M 3.2.3	Aplikimi i masave për zbutjen e erozionit në NjA Cakran, Frakull, Levan dhe Portëz.	2024 - 2027	Fier	Bashkia	Sipas studi mit			
--	---	------------	---	----------------	------	---------	--------------------	--	--	--

M

3.3.1

Parandalimi dhe përmirësimi i menaxhimit të riskut nga

M 3.3.2	Hartimi i planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor.	2024 - 2030	Fier	Bashkia	0		0	
M 3.3.3	Ndërtimi i kullave të vëzhgimit në zonat më problematike të territorit të NjA Cakran, Dërmenas, Levan.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë, OSHC	50000		50000	
M 3.3.4	Ripyllëzimi i zonave të dëmtuara nga zjarret ndër vite.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, donatorë, OSHC, MTM	250000		250000	
M 3.3.5	Pajisja e sektorit të Shërbimeve të Mbrojtjes nga Zjarri, MZSH me mjete si pompa shpine, motosharra, sëpata, lopata, veshje mbrojtëse, makina.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë, AKMC, OSHC	150000		150000	
M 3.3.6	Pozicionimi i hidrantëve për furnizim me uji të mjeteve të MZSH në brendësi të zonave të mbrojtura dhe atyre zonave me potencial të lartë për rënien e zjarreve.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Ujësjiellësi Rajonal Fier	25000		20000	
M 3.3.7	Hapja e rrugëve pyjore të për të aksesuar më lehtësisht ekonomitë pyjore.	2024 - 2030	Fier	Bashkia	Sipas studimit		Sipas studimit	

M

	M 3.3.8	Trajnimi I stafit të MZSH.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, AKMC	25000		25000	
--	------------	----------------------------	----------------	------	---------------	-------	--	-------	--

Përgatitja e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve;

zjarri

2024 -
2030

Fier

Bashkia, Donatorë,
Agjencia
Kombëtare e
Pyjeve

60000

50000

M

Rritja e gatishmërisë Fier	M 3.4.2	Studim sizmik për ndërtesat me rëndësi të veçantë (godina në pronësi të bashkisë, monumente kulturore, infrastruktura kritike)	2024-2030	Fier	Bashkia, Donatorë, AKPT, Ministria e Kulturës	250000		250000	
	M 3.4.3	Studim sizmik për ndërtesat informale në territorin e bashkisë.	2024-2030	Fier	Bashkia, Donatorë, AKPT	5000 (për ndërtesë)		5000 (për ndërtesë)	
	M 3.5.1	Vlerësimi dhe hartëzimi i pikave të nxehta/hot-spotëve teknologjike në territorin e bashkisë Fier.	2024 - 2025	Fier	Bashkia, Agjencia Kombëtare e Mjedisit	0		0	
	M 3.5.2	Vendosja e këndeve të informimit në qendrat e fshatrave për afishimin e njoftimeve për ZRF.	2024 - 2026	Fier	Bashkia, Donatorë, OSHC	5000		0	

M

Zbutja e impaktit të ngjarjeve me shumë risqe/multirisik	M 3.5.3	Kryerja në mënyrë periodike e matjes së cilësisë së ajrit, ndotjes së tokave bujqësore dhe ujërave sipërfaqësore nga bashkia Fier.	2024-2030	Fier	Bashkia, OSHC, AKM	10000		0	
--	------------	--	-----------	------	--------------------	-------	--	---	--

dhe përgjigjes së bashkisë ndaj rrethit sizmik

3.4.1

Studim sizmik për ndërtesat me moshë mbi 50 vjeçare me fokus kryesor NjA Fier. (Rreth 4,455 ndërtesa të ndërtuara përpara vitit 1990 vetëm në NjA Fier).

2024-2030

22775000

22775000

Fier

Bashkia,
Donatorë, AKPT

M

Kryerja e një studimi pilot për të

M 3.5.5	Vlerësim i impaktit mjedisor i puseve të shpimit në territorin e bashkisë Fier	2024-2026	Fier	Bashkia, Donatorë	30000		3000	
M 3.5.6	Krijimi i rezervave ujore në rast fatkeqësie. Duke qenë se një pjesë e territorit të bashkisë Fier furnizohet me ujë nga burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësorë pranë lumenjve kryesor të bashkisë ato mund të jenë subjekt ndotjeje teknologjike e bakteriologjike. Ndotja e tyre do të linte një pjesë të popullsisë pa ujë sanitar. Marrja e masave për krijimin e rezervave ujore për fshatrat NjA më të ekspozuara do të ishte një masë parandaluese e cila do të adresonte problematikën e ujit sanitar për banorët.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Ujësjiellësi Rajonal Fier	75000		75000	
M 3.5.7	Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve shëndetësore në territorin e bashkisë Fier për përballimin e një epidemie të mundshme (bashkëpunim sektori i mbrojtjes civile, shëndetësia).	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Drejtoria Rajonale e Shëndetit	15000		15000	

3.5.4 evidentuar problematika të shëndetit të

M

banorëve të cilët banojnë pranë

vendburimeve të naftës me fokus të 2024-

veçantë gratë dhe grupet e cenueshme 2026 Fier Bashkia, Donatorë 40000 40000

M

Vlerësimi teknik i stacioneve të

M

M 3.5.9	Vlerësimi mjedisor i gjendjes së Ish Uzinës së Plehrave Azotike në Fier për shkak se në të janë depozituar mbetje të lëndëve si bakër dhe amoniak.	2024 - 2026	Fier	Bashkia, Donatore, OSHC, AKM	20000- 25000		20000- 25000	
M 3.5.10	Vlerësimi i zonës përreth ish Zonës Industriale Fier, në të cilën ushtron aktivitetin Rafineria e Naftës.	2024 - 2026	Fier	Bashkia, Donatore, OSHC, AKM	20000- 25000		20000- 25000	
M 3.5.11	Vlerësimi i të gjithë pus shpimeve, në pronësi të bashkisë, për ujë të pijshëm në territorin e bashkisë Fier për të vlerësuar cilësinë e ujërave	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë, ISHP	150000		150000	
M 3.5.12	Vlerësim i ndotjes së tokave bujqësore dhe kalimit të elementëve të ndotjes potenciale tek zinxhiri ushqimor.	2024 - 2027	Fier	Bashkia, Donatorë, AKM, ISHP	50000		50000	
M 3.5.13	Vlerësimi i impaktit të risqeve nga fatkeqësitë në objektet e trashëgimisë kulturore në varësi të bashkisë.	2024 - 2027	Fier	Bashkia, MK	45000		45000	
M 3.6.1	Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në burimet natyrore (toka, uji, pyjet) të bashkisë Fier	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë	250000		250000	

M

Vlerësimi i impaktit të ndryshimeve klimatike në territorin e bashkisë dhe aplikimi i zgjidhjeve të	M 3.6.2	Vlerësimi i impaktit të ndikimit të rritjes së nivelit të detit në komunitetet dhe vijën bregdetare në Bashkinë e Fierit. Fokus i veçantë përparimi i detit në grykëderdhjen e lumit Seman.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë	300000		300000	
	3.5.8	pompimit për sigurimin e ujit të bashkia)	2024 - 2026	Fier	Bashkia, URF	0	pijsëm. (kjo mund të bëhet edhe nga	0	

M 3.6.3	Vlerësimi i riskut të thatësirave në sektorin bujqësor në kontekstin e ndryshimeve klimatike në bashkinë Fier.	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë	100000		100000	
M 3.6.4	Vlerësimi i ndikimit të ishujve të nxehtë urban në bashkinë Fier	2024 - 2030	Fier	Bashkia, Donatorë	50000		50000	
M 3.6.5	Studim mbi implementimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë (NbS) për reduktimin e riskut nga rrëshqitjet, përmytjet, erozionin lumor etj.	2024 - 2026	Fier	Bashkia, Donatorë, OSHC	100 000		100 000	
M 3.6.6	Hartimi i Planit Lokal të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike	2024 - 2027	Fier	Bashkia, Donatorë, OSHC	40,000		40,000	

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

6. Zbatimi i strategjisë

Pas miratimit të Strategjisë në Këshillin Bashkiak, sektori i mbrojtjes civile në bashki ngarkohet me zbatimin e saj. Dokumenti i strategjisë është hartuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe përtej angazhimit të sektorit të mbrojtjes civile është e nevojshme që të koordinohet me të gjithë sektorët e tjerë sipas angazhimit të tyre në Komisionin e Mbrojtjes civile dhe grupin e punës për hartimin e strategjisë.

Shumë prej projekteve të cilat janë pjesë të planit të veprimit dhe plotësojnë kuadrin strategjik kërkojnë përfshirjen e sektorëve të ndryshëm për zbatimin e tyre. Kjo përfshirje nuk nënkupton thjesht angazhimin e kapaciteteve teknike, por edhe të atyre financiare. Pra, është e rëndësishme që në momentin që hartohet Plani Buxhetor Afat-mesëm dhe më pas Buxheti Vjetor, të ketë një koordinim të mirë të sektorëve në mënyrë që të përdoren të gjitha burimet dhe kapacitetet teknike e financiare.

Është e qartë që bashkia me kapacitetet e saj financiare nuk mund të mbulojë të gjitha kostot e zbatimit të strategjisë. Për këtë arsye është e nevojshme që sektori i mbrojtjes civile të punojë ngushtësisht me njësinë e projekteve në bashki në mënyrë që të jenë të përgatitur për t'ju përgjigjur thirrjeve të ndryshme për projekt propozime në fushën e mbrojtjes civile. Në seksionin 2.3 të kësaj strategjie janë paraqitur disa nga burimet kryesore të financimit ku bashkia mund të aplikojë për projekte.

Po ashtu, bashkia duhet të synojë që të rrisë bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, institucione kërkimore, universitete etj. në mënyrë që të krijojë sinergji të aktiviteteve të cilat ndodhin në territorin e saj në kuadër të mbrojtjes civile. Krijimi i partneriteteve me institucione të tilla shërben jo vetëm për nisma të përbashkëta dhe koordinimin e aktorëve në territor, por edhe për të rritur mundësinë për aplikimin për projekte të ndryshme.

Së fundmi, pas miratimit të kësaj strategjie, lind nevoja që të studiohen në detaj strategji të tjera vendore dhe të përshtaten sipas përcaktimeve të kësaj strategjie. Veçanërisht është e nevojshme që të shihet Plani i Përgjithshëm Vendor në mënyrë që të përshtatet me nevojat e riskut të fatkeqësive dhe me parashikimet e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut.

7. Monitorimi

Sa i përket monitorimit të zbatimit të strategjisë ajo do të duhet të monitorohet nga stafi i Bashkisë Fier dhe njëkohësisht nga AKMC për të ndjekur ecurinë e zbatimit të saj. Për të monitoruar në mënyrë të thjeshtë zbatueshmërinë e strategjisë referuar projekteve strategjike apo masave specifike për secilin projekt në tabelën më sipër në kapitullin 4 parashikohen disa indikatorë të cilët janë lehtësisht të matshëm. Indikatorët janë për procese që duhet të kryhen vetëm një herë, për tu përsëritur më pas mbas disa vitesh (5-10 vite) për masa të tilla si hartimi i

studimeve. Nga ana tjetër ka masa të tjera të cilat duhet të kryhen në mënyrë të përvitshme dhe duhet të

monitorohen vit pas viti, të tilla siç janë zhvillimi i trajnimeve për punonjësit e bashkisë apo komunitetin. Tërësia e realizimit të masave specifike do të japi më pas një pasqyrë të qartë për përqindjen e realizimit të projektit e objektivit strategjik e më pas në tërësi të strategjisë.

Nga ana tjetër janë renditur disa indikatorë të cilët shërbejnë për të matur impaktin që ka pasur zbatimi i masave të strategjisë në Bashkinë Fier.

Indikatorët e matjes së strategjisë:

1. Zvogëlimi i humbjeve të drejtpërdrejta ekonomike nga fatkeqësitë;
2. Zvogëlimi i numrit të personave të prekur nga fatkeqësitë;
3. Zvogëlimi i numrit të banesave të prekura nga fatkeqësitë;
4. Zvogëlimi i numrit të ndërmarrjeve ekonomike të prekura nga fatkeqësitë;
5. Zvogëlimi i numrit objekteve publike me rëndësi të veçantë të prekura nga fatkeqësitë;
6. Zvogëlimi i sipërfaqeve të infrastrukturave kritike të prekura nga fatkeqësitë;
7. Zvogëlimi i sipërfaqeve natyrore të prekura nga fatkeqësitë;
8. Zvogëlimi i sipërfaqeve bujqësore të prekura nga fatkeqësitë;
9. % e zbatimit të masave të Strategjisë për ZRF në Bashkinë Fier në investime;

10. % e zbatimit të masave të Strategjisë për ZRF në Bashkinë Fier në numër projektesh të zbatuara;
11. Mbështetje në ngritjen e kapaciteteve për ZRF në numër pajisjesh dhe lloj pajisjesh;
12. Mbështetje në ngritjen e kapaciteteve për ZRF në numër trajnimesh dhe persona të trajnuar kundrejt stafit të bashkisë;
13. Investime të ardhura nga donatorë apo projekte ndërkombëtare në (ALL);
14. Numër projektesh nga donatorë apo projekte ndërkombëtare;
15. Numër marrëveshjesh bilaterale me institucione të tjera në nivel Vendor, Kombëtare dhe Ndërkombëtare në lidhje me ZRF;
16. % e popullsisë së mbuluar me trajnime në rast emergjence;
17. % e popullsisë së mbuluar me sisteme të hershme të alarmit nga fatkeqësitë.

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

8. Referenca

- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore. (2018). *Programi Kombëtar Sektorial i Ujit / Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore*. AMBU.
<http://www.ambu.gov.al/programi-kombetar-sektorial-i-ujit/>
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore. (2019, June). *Plani Përfundimtar i Menaxhimit për Basenin Ujor Seman*. AMBU.
http://ambu.gov.al/public/Semani%20Final%20RBMP_Final_Albania_June2019.pdf
- Ali, E., E. Cramer, J. Carnicer, E. Georgopoulou, N.J.M. Hilmi, G. Le Cozannet, and P. Lionello, 2022: Cross-Chapter Paper 4: Mediterranean Region. In: *Climate Change 2022: Impacts, Adaptation and Vulnerability. Contribution of Working Group II to the Sixth Assessment Report of the Intergovernmental Panel on Climate Change* [H.-O. Pörtner, D.C. Roberts, M. Tignor, E.S. Poloczanska, K. Mintenbeck, A. Alegría, M. Craig, S. Langsdorf, S. Lösschke, V. Möller, A. Okem, B. Rama (eds.)]. Cambridge University Press, Cambridge, UK and New York, NY, USA, pp. 2233–2272, doi:10.1017/9781009325844.021.
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. (2017, June 16). *Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore*. Konsultimi Publik.
https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_40_PROJEKTVENDIMIN%20E%20K%20C3%8B%20SHILLIT%20KOMB%20C3%8BTAR%20T%20C3%8B%20UJIT.pdf
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. (2017a, May). *STRATEGJIA E UJITJES DHE KULLIMIT NË SHQIPËRI*. bujqesia.gov.al.
https://www.bujqesia.gov.al/ep-content/uploads/2017/12/Strategjia_U_K_korrik2017_kOonsultim-1.pdf

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. (2019). *Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit*. turizmi.gov.al. https://turizmi.gov.al/ep-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor-2019_-1.pdf
- *PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN e MBETJEVE TË NGURTA*. (2020, January 13). Ministria E Infrastruktures Dhe Energjise. <https://ëëë.infrastruktura.gov.al/ep-content/uploads/2020/07/PLANI-KOMBETAR-SEKTORIAL-PER-MENAXHIMIN-E-MBETJEVE-TE-NGURTA.pdf>
- SASPAC. (2022, October). *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030*. Konsultimi Publik. https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf
- UNDP. (2022, November 10). *The fourth National Communication of Albania on Climate Change*. <https://www.undp.org/albania/publications/fourth-nationalcommunication-albania-climate-change>
- *WorldRiskReport 2022*. (2022). Bündnis Entëicklung Hilft. https://weltrisikobericht.de/ep-content/uploads/2022/09/WorldRiskReport2022_Online.pdf

9. Aneksë

Aneks 1 – Projekte të nxjerra nga plane dhe strategji kombëtare dhe sektoriale

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030

Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë me shumë risqe

Projekti strategjik 4: Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Bashkinë Divjakë

1. Sigurimi i furnizimit me mjete, automjete dhe pajisje për sektorin e MC dhe Shërbimin e MZSH-së;
2. Rritja e formimit profesional të stafit të MZSH-së

Projekti strategjik 7: Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)

1. Zbatimi i bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë
2. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave

Projekti strategjik 8: Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut

1. Kryerja e një studimi për përfshirjen në programet shkollore të njohurive të Mbrojtjes Civile,
2. Zbatimi i planit të veprimit për përfshirjen në programet shkollore të njohurive të Mbrojtjes Civile.
3. Zhvillimi i një programi ndërgjegjësimi publik për ZRF dhe të planit të veprimit
4. Zbatimi i planit të veprimit të ndërgjegjësimit publik për ZRF

Projekti strategjik 9: Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile

1. Zhvillimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile bazuar, ndër të tjera, në Planin e ri Kombëtar për Emergjencat Civile
2. Mbështetja e konsultimeve ndër-institucionale dhe miratimi i programit të trajnimit
3. Implementimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile

Projekti strategjik 10: Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje (JICA) *(tregon aktivitetet e projektit me qeverinë japoneze; aktivitetet e mundshme tek projektet strategjike për riskun e zjarreve)*

Projektin strategjik nr.4 të Zjarreve në pyje: “Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit”;

Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje: “Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve”

Projekti strategjik 12: Forcimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm

1. Blerja dronëve të nivelit mesatar;
2. Trajnimi i nevojshëm për përdorimin e dronëve
3. Identifikimi i mangësive të tjera duke pasur parasysh investimet në vijim ose Zhvillimi i Listës Kontrolluese të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm
4. Në afat të shkurtër: blerja e një softueri që do të ndihmojë sistemin e paralajmërimit të hershëm të tipit Katwarn, Nokia
5. Blerja e Licencave përkatëse për Software, Instalim, Integrim

6. Parashikimi i kostove të mirëmbajtjes dhe llogaritja e kostove përkatëse për tarifën vjetore për kompanitë që blejnë licenca.

Projekti strategjik 14: Forcimi i gatishmërisë financiare të vendit përmes miratimit të një Programi Kombëtar të Financimit të Riskut nga Fatkeqësitë

1. Transparenca e shpenzimeve pas fatkeqësisë dhe ofrimi i likuiditetit të shpejtë
2. Rregullimi i procesit të financimit pas fatkeqësisë
3. Rritja e disponueshmërisë së fondeve për qeveritë vendore
4. Qasje në shërbimet financiare pas fatkeqësisë nga familjet, fermerët dhe bizneset dhe të varfrit
5. Sigurimi nga tërmetet për familjet
6. Mbrojtja sociale e përshtatur
7. Menaxhimi i risqeve të lidhura me fatkeqësitë e sektorit financiar dhe privat dhe mobilizimi i financave për forcimin e aftësisë ripërtëritëse (investime të gjelbra dhe të qëndrueshme)

Projekti strategjik 17: Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave

1. Punime të mundshme për qendrat e operacionale dhe qendrave të trajnimit
2. Zhvillimi i procedurave standarde operacionale
3. Trajnime

Projekti strategjik 22: Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcimi i kapaciteteve monitoruese të AKMC-së; sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.

1. Ndërgjegjësimi dhe ngritja e organizatave vullnetare;
2. Forcimi i teknologjisë për monitorimin operacional;
3. Sistemi për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore;
4. Mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.

Projekti strategjik 1: Rritja e sigurisë së mbrojtjes nga përmbytjet e lumenjve, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave të reja

1. Kryerja e studimeve të fizibilitetit për të përmirësuar mbrojtjen nga përmbytjet
2. Rehabilitimi/Rikonstruksioni dhe ndërtimi i argjinaturave kundër përmbytjeve dhe strukturave mbrojtëse nga erozioni
3. Rritja e kapaciteteve operacionale, mirëmbajtjes dhe monitoruese të sigurisë së argjinaturave në strukturat përkatëse të MBZHR dhe Bashkive

Projekti strategjik 2: Rritja e sigurisë së digave të rezervuarëve të ujitjes, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të digave ekzistuese

1. Kryerja e studimit të fizibilitetit të digave
2. Kryerja e projekteve të zbatimit për grupin prioritar të digave
3. Programimi buxhetor për ndërhyrjet strukturore në diga
4. Rehabilitimi/Rikonstruksioni i digave ekzistuese sipas prioritetit të përcaktuar 5. Ngritja/Konsolidimi dhe trajnimi i Grupeve të Sigurisë së Digave për çdo bashki.

Projekti strategjik 3: Vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm

1. Analiza e hidrologjike e prurjeve në lumenj
2. Ndërtimi i një modeli hidrologjik për parashikimin e përmbytjeve.

Projekti strategjik 9: Përmirësimi i Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet

1. Studimet e fizibilitetit dhe projektimi i mbrojtjes strukturore dhe jostrukturore nga përmbytjet, me prioritet zgjidhjet e bazuara në natyrë
2. Punime ndërtimi/rehabilitimi
3. Planifikimi i mirëmbajtjes dhe prokurimi i pajisjeve të nevojshme
4. Trajnime

Rrëshqitjet e tokës

1. Projekti strategjik 2 : Identifikimi i rrëshqitjeve të tokës në të gjithë territorin e X bashki dhe krijimi i një inventari për rrëshqitjet, i cili përmban të gjitha të dhënat e tyre.

2. Përgatitja e një harte të konsoliduar të zonave/akseve rrugore të rrezikuara historikisht nga rrëshqitjet (zonimi i rrëshqitjeve);
3. Përgatitja e një plani emergjence në rast të përballjes me një fatkeqësi natyrore/rrëshqitje toke

Zjarret në Pyje

Projekti strategjik 1: Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet

1. Ngritja, Pajisja, Trajnimi i Moduleve të Mbrojtjes Civile të Shuarjes së zjarrit nga toka

Projekti strategjik 4: Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit

2. Studimi i zonave pyjore me risk të lartë nga zjarri në Shqipëri.
3. Studimi i nevojave të kapaciteteve njerëzore në lidhje me sistemin e vrojtimit - sinjalizimit në nivel kombëtar.
4. Studimi i kostove dhe burimeve financiare të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të vrojtimit-sinjalizimit.

Projekti strategjik 7: Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe

Shpëtimit

1. Vlerësimi i vendndodhjeve, funksionalitetit dhe sigurisë së stacioneve ekzistuese të MZSH-së në bashki.
2. Krijimi i Qendrës së re Kombëtare Operacionale të MZSH-së

Tërmetet

Projekti strategjik 7: Ngritja e kapaciteteve për zbutjen e riskut sizmik në vendet e trashëgimisë kulturore:

1. Trajnimit të ekspertëve në fushën e restaurimit dhe transmetimit të njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim
2. Përpilimit të manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit;
3. Përmirësimin të normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit.
4. Rritja e numrit të ekspertëve të fushës në administratën vendore;
5. Kryerja e vlerësimeve sizmike të digave, shkollave, spitaleve dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë funksione kolektive
6. Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të monitorimit sizmik
7. Konsolidimi i stafit të Mbrojtjes Civile në administratën lokale; 8. Përfshirja e informacionit bazë për tërmetet në kurrikulat shkollore.

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit

1. Reformim të strukturave për të bërë një përdorim më efikas të ujit, një menaxhim më intensiv, si edhe procedura financiare më të besueshme.
2. Sa i takon kullimit, është shumë e rëndësishme të gjenden mënyra dhe teknologji të reja për përmirësimin e rrjeteve të kullimit.
3. mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve ekzistuese të ujitjes si edhe hapjen e kanaleve të reja.
4. Administrimi më i mirë i lumenjve dhe sigurie digave.
5. Kapaciteti i digës ka rënë për shkak të mbushjes së vëllimit me sediment, dhe kështu është rritur edhe risku i përmbytjeve.
6. Për përmbytjet e shkaktuara nga lumenjtë është e rëndësishme të bëhet një administrim më i mirë i lumenjve, përfshirë modelimin hidraulik, sipas qasjeve dhe sistemeve kompjuterike më të reja.
7. Përmirësimi i infrastrukturës dhe mirëmbajtja e saj për t'u bërë ballë ndryshimeve në regjimin e reshjeve dhe sedimentit të shkaktuara nga ndryshimet klimatike (kullimi, siguria e digave dhe përmbytjet).
8. Zhvillim i një plani për pakësimin e erozionit nëpërmjet bimëve
9. Forcimi strukturave të monitorimit të sigurisë së digave
10. Rehabilitimi dhe rritja e sigurisë së digave

Titulli i veprimit prioritar nr.14 Rritja e nivelit të gatishmërisë së mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive natyrore

1. Përgatitje e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për përmbytjet dhe përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave në nivel qarku
2. Ndërgjegjësim /dukshmëri / komunikim: të përmirësohet ndërgjegjësimi publik për përmbytjet nëpërmjet informimit për rrezikun, sistemeve të sinjalizimit të hershëm dhe planit që duhen ndjekur në rast fatkeqësie

1. Zëvendësim/riparim pajisjet e vjetra dhe të paefektshme të përdoren për pastrimin e kolektorit dhe kanaleve kulluese kryesore; (Kullimi)
2. Një standard mirëmbajtje rutinë në shumicën e sistemeve të ujitjes që redukton ritmin e përkeqësimit në nivele të papërfillshme. (Vaditja)

Komponenti strategjik 3: Siguria dhe operacionet e digave

1. Përmirësim i standardeve të sigurisë së digave në përputhje me standardet e BE-së;

Komponenti strategjik 4: Mbrojtja nga përmbytjet

1. Rehabilitim dhe modernizim i infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytjet;
2. Për të ndërtuar infrastrukturë shtesë për mbrojtjen e përmbytjeve aty ku është e nevojshme;

Aneks 2 – Minutat e takimeve të realizuara me kryetarët e 6 bashkive të Qarkut Fier

Minutat e takimit hapës për projektin “Hartimi i Strategjive Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planet e Veprimt për 6 Bashkitë e Qarkut Fier”

Mbështetur nga: Forcimi i Aftësive Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL UNDP

Zhvilluar pranë Prefektit të Fierit, Fier, Shqipëri

18.12.2023

Pjesëmarrës në takim:

- Prefekti i Fierit – Z. Lefter Shehaj
- Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së – Z. Haki Cako
- Oficere e programit, SIDA – Znj. Linda Gjermani
- Përfaqësuese e UNDP-së në Shqipëri – Znj. Monica Merino
- Koordinator kombëtar i projektit RESEAL – Z. Doreid Potoshati
- Kryetarët e bashkive të qarkut të Fierit
 - Bashkia Fier – Z. Armando Subashi
 - Bashkia Lushnje – Znj. Eriselda Sefa
 - Bashkia Roskovec – Znj. Majlinda Bufi
 - Bashkia

Divjakë – Z. Josif Gorrea ○ Bashkia Patos – Z. Fation Duro ○ Bashkia Mallakastër – Z. Qerim Ismailaj

- Ekipi i punës së firmës konsulente MetroPolis dhe Co-PLAN

Takimi nisi me fjalët hapëse të prefektit të Fierit, si një ndër aktorët kryesorë në projekt por edhe si moderator i takimit hapës. Gjatë fjalëve hapëse, u theksua përparimi i Shqipërisë në sektorin e mbrojtjes civile dhe në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në 2 vjeçarin e fundit nëpërmjet përparimeve ligjore, instrumenteve në dispozicion, hartimit të dokumentit të vlerësimit të riskut dhe strategjisë në nivel kombëtarë nga aktorët ndërkombëtarë dhe kombëtarë prezent në takim (Sida, UNDP, AKMC). Gjatë këtij procesi u evidentua qarku Fier dhe bashkitë e saj për të pilotuar hartimin e këtyre dokumenteve edhe në nivel rajonal dhe vendor, duke qenë se është një territor ku gjejmë të 6-ta risqet e evidentuara edhe në nivel kombëtar (risku nga zjarret, përmytjet, biologjik, sizmik, teknologjik/industrial, rrëshqitjet). Në këtë kontekst, faza e parë e projektit, hartimi i dokumenteve të riskut për 6-të bashkitë e qarkut të Fierit, është mbyllur dhe janë miratuar pranë këshillave bashkiak përkatës. Me këtë takim fillon procesi i hartimit të strategjive për zvogëlimin e riskut në këto bashki me synim ndërmarrjen e masave konkrete për parandalimin, paralajmërimin, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë.

Më pas takimi vijoi me një prezantim mbi procesin që do të zhvillohet për hartimin e strategjive në këto 6-të bashki nga udhëheqësi i ekipit të punës së firmës konsulente MetroPolis & Co-PLAN, Z. Ledio Allkja. Në këtë prezantim u parashtrua përmbajtja e dokumentit dhe procesi i bashkëpunimit me bashkitë.

Pas prezantimit u zhvillua një diskutim i hapur me kryetarët e bashkive prezentë në sallë, të cilët theksuan rëndësinë e projektit dhe gatishmërinë e tyre maksimale për të bashkëpunuar me ekipin e punës në procesin e hartimit të strategjisë. Kryetarja e bashkisë Roskovec, Znj. Majlinda Bufi, sugjeroi që takimet e tjera të përbashkëta me të gjithë aktorët e interesit në projekt të zhvillohen në bashki të ndryshme. Kryetari i bashkisë Fier, Z. Armando Subashi, u ndal tek risku i përmytjeve specifiku të shkaktuara nga dalja e Lumit Vjosë nga shtrati si pasojë e urës së autostradës, konstatim i mbështetur në studime. Adresimi i këtij problemi evidentohet si një projekt strategjik nga bashkia e Fierit në kuadër të Zvogëlimit të riskut nga përmytjet, dhe shpreh gatishmërinë e bashkisë për të kontribuar në bashkëpunim me donatorë të tjerë. Gjithashtu ngreh edhe problematikën e digave si një potencial i lartë risku për shkak të degradimit të infrastrukturës. Specifikisht për këtë problematikë, drejtori i përgjithshëm i AKMC-së shprehet se është krijuar një fond i dedikuar për vlerësimin e gjendjes së digave dhe kryerjen e investimeve përkatëse. Pas mbylljes së diskutimit të hapur përmytjet edhe takimi i parë i kësaj faze të projektit.





Titulli i aktivitetit:	Takim me kryetarët e bashkive të Qarkut të Fierit
Data e zhvillimit të aktivitetit:	27/06/2024
Vendi:	Bashkia Roskovec
Objektivi kryesor:	Takim me titullarët e bashkive të Qarkut Fier për të zhvilluar diskutimin mbi projektet e propozuara dhe strategjinë për zvogëlimin e riskut sipas bashkisë.

<p>Përshkrim i aktivitetit:</p> <p>(maksimumi 1 faqe)</p>	<p>Takimi u zhvillua në ambientet e Bashkisë Roskovec dhe në këtë takim ishin prezent kryetarët e bashkive Patos, Roskovec, dhe Divjakë si edhe sekretarët e përgjithshëm të bashkive Lushnje, Fier dhe Mallakastër. Në takim po ashtu morën pjesë Drejtori i përgjithshëm i AKMC z. Haki Çako, koordinatori i projektit RESEAL Albania Doreid Petoshati, përfaqësues nga ekipi i ekspertëve të Co PLAN dhe MetroPOLIS si dhe drejtues të grupeve të punës në bashkitë e Qarkut Fier.</p> <p>Takimi nisi me fjalën hapëse të Kryetares së Bashkisë Rockovec Majlinda Bufi e cila shprehu falënderimet e saj për projektin dhe</p>
--	---

donatorin si dhe për procesin mjaft të rëndësishëm që ky projekt ka ndjekur për të përmbushur detyrimet e tij por edhe duke përmbushur të gjitha interesat e komunitetit lokal e bashkisë

Më pas fjalën e mori drejtori i AKMC z. Haki Çako i cili vuri theksin e tij në rëndësinë që kanë këto dokumente në ndërmarrjen e hapave direkt për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive në territoret e bashkive të cilat po përfundojnë procesin e hartimit të Strategjive Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë.

Koordinatori i projektit RESEAL z. Doreid Petoshati u shpreh se Hartimi i Strategjisë së Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë duke përfshirë edhe projektin e mëparshëm të Vlerësimit të Vulnerabilitetit në bashki si dhe Planet për Emergjencat Civile plotësojnë të gjithë bazën e dokumenteve strategjike për bashkitë e Qarkut Fier. Këto dokumente kanë dalë nga një proces koordinimi ndërmjet ekspertëve të CoPLAN dhe MetroPOLIS me bashkitë dhe prezantojnë nevojat reale të komuniteteve dhe bashkive respektive në mënyrë që të rritet aftësia ripërtëritëse në kuadër të fatkeqësive që përfshijnë këto territore.

Dy kryetarët e Bashkive Patos dhe Divjakë z. Fation Duro dhe z. Josif Gorrea shprehën vlerësimin e tyre për ekipin e ekspertëve të Co_PLAN dhe MetroPOLIS gjithashtu shprehën se këto dokumente do të japin mundësi të mira institucioneve të rrisin kapacitetet njerëzore për të zvogëluar riskun nga fatkeqësitë në bashkitë e tyre. Pas fjalës hapëse të titullarëve të institucioneve Koordinatori i Projektit nga Co-PLAN Z. Ledjo Allkja zhvilloi një prezantim të përbashkët për 6 bashkitë e qarkut Fier ku fillimisht u shpjegua procesi nëpër të cilin kanë kaluar këto strategji dhe takimet që janë realizuar në këtë kuadër.

Si hap i dytë i prezantimit u shpjeguan vizionet e përgjithshme të strategjive vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, objektivat strategjike, programet dhe projektet si dhe plani i

veprimit. Hapi tjetër ishte shpjegimi i metodologjisë së kostimit të projekteve dhe kostot totale që ka secila bashki për të implementuar këtë strategji si dhe shpjegimi në mënyrë të hartëzuar i projekteve dhe ndërhyrjeve në territor. Prezantimi u mbyll me shpjegimin e planit të monitorimit dhe treguesve të monitorimit të strategjisë.

Seksioni i diskutimeve filloi me shpjegimin e ekspertit të CoPLAN për kohën që bashkive u duhet të bëjnë komentet e fundit në lidhje me strategjitë dhe në këtë rast u la një periudhë 15 ditore për të marrë komentet e fundit. Ndërkohë bashkive u ishte lënë edhe një periudhë e mëparshme për komente dhe bashkitë kishin sjellë disa komente në lidhje me projektet në secilën bashki.

Koordinatori i punës me strategjinë në Bashkinë Patos shpjegoi që institucioni i tyre ka çuar komentet dhe janë në pritje të përgjigjes së skuadrës nga Co-PLAN dhe metroPOLIS për të verifikuar përshtatjen e dokumentit sipas komenteve të tyre.

Përgjigja e ekspertëve të hartimit të strategjisë ishte se dokumenti i rishikuar në këtë rast do jetë gati deri ditën e hënë dhe më pas ekipi i bashkisë do ketë kohe edhe 2 javë të tjera për të patur edhe një rishikim të fundit të dokumenteve.

	Fjalën përmbyllëse e bëri përfaqësuesi i Prefekturës së Qarkut Fier i cili shprehu edhe një herë konsideratën për dokumentet strategjike të draftuar nga ky proces si dhe nivelin e lartë të koordinimit ndër-institucional për këtë projekt.
Nr. i pjesëmarrësve	<p>Pjesëmarrës: Nëse ka përfaqësues të organizatave të ndryshme apo institucione publike të çfarëdolloj duhet të përmenden specifikisht.</p> <p>Përfaqësues nga Bashkia Lushnjë: 1 Përfaqësues nga Bashkia Fier:1 Përfaqësues nga Bashkia Divjake:2 Përfaqësues nga Bashkia Patos:2 Përfaqësues nga Bashkia Roskovec: 3 Përfaqësues nga Bashkia Mallakastër: 2 Përfaqësues nga Prefektura Fier: 2 Përfaqësues nga organizata/institucione MetroPOLIS/Co-PLAN:3 UNDP:2 AKMC:3 Të pranishëm total: 20 Femra pjesëmarrëse – 7 Meshkuj pjesëmarrës – 13</p>

Aneks 3 – Minutat e takimeve të zhvilluara me grupin e punës në bashki. Takim hapës për njohjen me grupin e punës në Bashkinë Fier

Titulli i aktivitetit:	Takimi hapësor për zvojtimin e Bashkisë Fier
Data e zhvillimit të aktivitetit:	19.12.2023
Vendi:	Bashkia Fier
Objektivi kryesor:	Prezantimi i grupeve të punës ndërmjet MetroPOLIS/Co-PLAN dhe grupit të punës të ngritur në bashki për hartimin e Strategjive vendore për ZRF.
Përshkrim i aktivitetit: aksimumi 1 faqe)	Takimi u zhvillua në ambientet e Bashkisë Fier dhe në këtë takim ishin prezent përfaqësues nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile. Më pas fjalën e mori eksperti i UNDP, z. Petoshati i cili bëri një përmbledhje të qëllimit të projektit RESEAL, punën e bërë si dhe hapat që do të ndiqen në vijim për hartimin e Strategjive për ZRF.

m

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

Në vijim fjalën e mori eksperti i grupit të punës nga MetroPOLIS/Co-PLAN z. Allkja i cili bëri një përshkrim të shkurtër të metodologjisë dhe hapave që do të ndiqen lidhur me hartimin e Strategjive të ZRF si dhe procesin gjithëpërfshirës që pritet të zhvillohet.

Më pas takimi u fokusua në çështje më teknike ku ekspertët e MetroPOLIS/Co-PLAN kishin përgatitur disa pyetje të strukturuar për të vlerësuar kapacitetet e strukturën e bashkisë lidhur me MC.

Në mënyrë të përmbledhur më poshtë paraqiten të dhënat e përfuara.

Në bashki ka një drejtor për MC dhe përbëhet nga 5 persona, drejtori

(1 pozicion është vakant) dhe 4 SNL, 3 nga të cilët kanë

formim ushtarak dhe 2 juridik. Këta ekspert kanë përshkrime pune dhe kryesisht janë përgjegjës për një rrezik specifik, dhe kanë një zyrë dhe mjetet e nevojshme për të ushtruar funksionin e tyre.

Në Bashkinë Fier nuk ka një qendër operationale të Emergjencave Civile.

DMC nuk ka mjetet e saj në dispozicion për të lëvizur në territor por përdor mjetet e përbashkëta të bashkisë, ndërsa sa i përket mjeteve të rënda të cilat nuk janë në përdorim të kësaj drejtorie por të Bashkisë Fier.

Sa i përket trajnimeve ata shprehen se kanë marrë pjesë në trajnime të lidhura me vlerësimin e dëmeve në bujqësi si dhe për ligjin për MC. Ata

shprehen se janë të hapur për të marrë pjesë në trajnime të mund të organizohen nga projekti por edhe më gjerë.

Sa i përket dokumenteve bashkia ka një Plan për Emergjencat dhe një plan veprimesh sezonal.

Sa i përket financimit ata shprehen se fondi për MC përdoret dhe në PBA është parashikuar një projekt për rehabilitimin e argjinaturës së ujëmbledhësit të Libofshës dhe një skrap për të kryer punime të ndryshme. Nga ana tjetër ata deklarojnë se fondi për EC shkon kryesisht për dëmshpërblimin e të dëmtuarve nga përmytjet apo zjarret.

Përfaqësuesit e bashkisë deklarojnë se kanë një dokument i cili ka të arkivuar fatkeqësitë në vite por është në formën hardcopy. Ata deklarojnë gjithashtu se raportojnë çdo datë 25 të muajit tek AKMC në formatin e dërguar nga agjencia.

Në planet e veprimit ka një listë vullnetarësh ku është e specifikuar emër mbiemër nr. telefoni të cilët angazhohen në rast emergjence, megjithatë ata deklarojnë se në rast fatkeqësish ka angazhim të vogël nga komuniteti dhe kryesisht angazhohen persona të cilët punojnë në sektorë të ndryshëm të bashkisë të cilët banojnë në NjA

Si kanal kryesor komunikimi përdoret telefoni dhe faqja në Facebook e Bashkisë në disa raste edhe TV lokale Apollonia. Në këtë drejtim ata shprehen se lajmërimi me telefon nga bashkia te administratorët kryepleqtë është shumë funksional.

	<p>Në përfundim përfaqësuesit e bashkisë shprehen se ndër problematikat kryesore është siguria e digave/rezervuarëve dhe duhet kryer një vlerësim për të parë situatën e tyre, zjarret gjithashtu janë një problem gjatë sezonit të verës.</p> <p>Duhet të ndahet me përfaqësuesit e bashkisë një draft strukturë për ngritjen e grupit të punës pasi ka pasur disa ndryshime në burimet njerëzore gjatë kësaj periudhe.</p>
--	--

<p>Nr. i pjesëmarrësve</p>	<p>Pjesëmarrës: Nëse ka përfaqësues të organizatave të ndryshme apo institucione publike të çfarëdolloj duhet të përmenden specifikisht.</p> <p>Përfaqësues nga Bashkia 5 Përfaqësues nga Prefektura Fier 1 Përfaqësues nga organizata/institucione 4 MetroPOLIS/Co-PLAN, 2 UNDP, 1 AKMC</p> <p>Të pranishëm total 13 Femra pjesëmarrëse – 2 Meshkuj pjesëmarrës – 11</p>
-----------------------------------	---

<p>Titulli i aktivitetit:</p>	<p>Takim me grupin e punës në Bashkinë Fier</p>
<p>Data e zhvillimit të aktivitetit:</p>	<p>18/03/2024</p>
<p>Vendi:</p>	<p>Bashkia Fier</p>
<p>Objektivi kryesor:</p>	<p>Takim me grupin e punës, prezantim i projekteve strategjike dhe diskutim mbi detajimin dhe përmirësimin e projekteve potenciale për parandalimin dhe adresimin e riskut nga fatkeqësitë.</p>
<p>Përshkrim i aktivitetit: (maksimumi 1 faqe)</p>	<p>Takimi u zhvillua në ambientet e Bashkisë Fier dhe në këtë takim ishin prezentë përfaqësues nga Bashkia Fier dhe grupi i punës nga MetroPOLIS/Co-PLAN.</p> <p>Takimet u zhvilluan individualisht me secilin sektor, në mënyrë që të kishte një qasje dhe diskutim më konkret në lidhje me secilin sektor pjesë të grupit të punës. Më konkretisht, sektorët me të cilët u diskutua në Bashkinë e Fierit ishin sektori i pyjeve dhe kullotave, sektori i mjedisit, sektori i bujqësisë dhe ujitjes dhe kullimit, mbrojtja civile si dhe sektori i financës. Grupit të punës ju bë një prezantim i projekteve potenciale të menduara nga MetroPOLIS/Co-PLAN, si dhe ju kërkua të bënin komentet e tyre mbi relevancën dhe konkretizimin e këtyre projekteve.</p> <p>Sektori i pyjeve dhe kullotave shprehen se më prioritare për ta është hartimi i planeve të menaxhimit të pyjeve. Gjithashtu, sa i përket ndërhyrjeve strukturore, më emergjente për ta është hapja e rrugëve</p>

	<p>pyjore dhe rehabilitimi i rrugëve ekzistuese. Sektori i mjedisit, si projektin më emergjent mendon kryerjen e analizave të tokë/ujë/ajër, kjo për shkak të ndotjes së lartë nga sektori hidrokarbur.</p> <p>Ndërkaq, sektori i bujqësisë projektin më prioritar mendon rehabilitimin e sistemeve vaditës dhe kullues, si problemin kryesor në bashki. Sektori i mbrojtjes civile sugjeron edhe kryerjen e trajnimeve për administratën, si dhe studime të mirëfillta gjeologjike apo sizmike.</p> <p>Sektori i fundit që u vizitua ishte sektori i financës, ku u shprehën se fondi i kushtëzuar për EC nuk disbursohet i gjithi, dhe se pjesa më e madhe e tij shkon për dëmshpërblime pas fatkeqësive, dhe një pjesë e vogël për blerje të mjeteve për parandalim.</p>
<p>Nr. i pjesëmarrësve</p>	<p>Pjesëmarrës: Nëse ka përfaqësues të organizatave të ndryshme apo institucione publike të çfarëdolloj duhet të përmenden specifikisht.</p> <p>Përfaqësues nga Bashkia: 7 Përfaqësues nga organizata/institucione 3 MetroPOLIS/Co-PLAN,</p> <p>Të pranishëm total - 10 Femra pjesëmarrëse – 6 Meshkuj pjesëmarrës – 4</p>



<p>Titulli i aktivitetit:</p>	<p>Takim me grupin e punës në Bashkinë Fier</p>
--------------------------------------	---

Data e zhvillimit të aktivitetit:	06/02/2024
--	------------

Vendi:	Bashkia Fier
Objektivi kryesor:	Takim me grupin e punës, diskutim mbi zhvillimin e vizionit dhe objektivave të Strategjisë Vendore si dhe diskutimi për projekte potenciale për parandalimin dhe adresimin e riskut nga fatkeqësitë.
Përshkrim i aktivitetit: aksimumi 1 faqe)	<p>Takimi u zhvillua në ambientet e Bashkisë Fier dhe në këtë takim ishin prezent përfaqësues nga Bashkia Fier, AKMC, UNDP, Prefektura Fier, grupi i punës dhe eksperti i ndërkombëtar nga MetroPOLIS/Co-PLAN..</p> <p>Takimi nisi me fjalën hapëse të Nën-kryetarit të bashkisë Fier, i cili shpreh rëndësinë e zhvillimit e strategjisë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe shprehet falënderues ndaj grupit të punës së bashkisë Fier si dhe grupit të punës nga MetroPOLIS/Co-PLAN, AKMC dhe UNDP.</p> <p>Më pas fjalën e mori eksperti i UNDP, i cili shprehu rëndësinë e këtij projekti dhe rëndësinë e gjithëpërfshirjes së të gjitha palëve. Z. Maksimiljan Dhima vuri një theks të veçantë mbi rëndësinë që ka përfshirja e grupeve të cënueshme dhe menaxhimi i saktë i fondeve. Në vijim fjalën e mori eksperti i grupit të punës nga MetroPOLIS/Co-PLAN z. Ledio</p> <p>Allkja i cili bëri një përshkrim të shkurtër të axhendës së ditës dhe ecurinë e punës që nga takimi i kaluar. Eksperti i ndërkombëtar, z.. Panteleon Skayannis, bëri një prezantim të</p> <p>Koncepteve themelore të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore duke u vendosur theksin mbi rëndësinë e masave për parandalimin dhe më pas menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë.</p> <p>Më pas, z. Allkja bëri një prezantim të shkurtër të projektit si dhe profilit të bashkisë Fier bazuar te dokumenti i vlerësimit të riskut për këtë bashki. Në vijim u prezantuan, vizioni, objektivat për hartimin e Strategjisë vendore ZRF si dhe një listë me projekte potenciale për parandalimin dhe Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Diskutimi për pikat e forta dhe të dobëta të bashkisë u zhvillua në formën e një diskutimi të hapur i zili u moderua nga Z. Allkja.</p> <p>Gjatë diskutimit përfaqësuesit e grupit të punës ngritën problematikat si më poshtë:</p> <p>Spektori i financave shprehen se fondet në bashki janë të kufizuara. Gjithashtu u shprehën se ata e ruajnë fondin për EC, dhe se nuk e ezaurojnë gjithmonë të plotësisht.</p> <p>Më pas, përfaqësues nga sektori i bujqësisë u shprehën se përballen me disa problematika, të cilat janë kryesisht sezonale, për shembull gjatë dimrit përmbetje nga Lumenjtë Vjosa dhe Seman, ndërsa gjatë verës, temperatura të larta dhe thatësira të tejzgjatura, të cilat me raste shkaktajnë dhe zjarre. Nga ana tjetër ata shprehën se në raste sporadike ka edhe zjarre të qëllimshme. Sektori i bujqësisë ka si problematikë edhe uljen e kapacitetit të rezervuarve të cilët janë përdorur për qëllim ujitje dhe për shkak të thatësirës dhe nivelit të pakët të ujit nuk arrijnë të furnizojnë kanalet vaditëse.</p>

m

	<p>Sa i përket kanaleve, përfaqësues nga bashkia shprehen se bashkia bën pastrimet e kanaleve kullues dhe vaditës. Gjithashtu, përfaqësuesi shprehet se analiza të tokave janë bërë dhe se ndotje të tokës ka vetëm pranë azotikut dhe vendburimeve të naftës.</p> <p>Në takim kishte dhe përfaqësues të njësive administrative, si Topojë apo Cakran. Në NjA Topojë përfaqësuesi shpreh problematikën e gërryerjes masive në Lumin Seman dhe deformim të argjinaturës nga ndërhyrjet njerëzore. Në NjA Cakran, përfaqësuesi shprehet se NjA ka probleme me përmbytjet që vijnë si pasojë e lumit Vjosa. Në NjA Darëzezë, ndërhyrja në ekosisteme dhe në duna ka bërë që deti të përparojë drejt tokës dhe të kërcënojë banesa apo biznese në afërsi të vijës bregdetare. E kundërta ndodh në zonën e Pishë Poro, ku deti është tërhequr.</p> <p>Përfaqësuesi i zjarrfikësve ngriti problematikën e mungesës së mjeteve zjarrfikëse; mungesën e bazës materiale, lopata, veshje etj.; si dhe mungesën e rrugëve për të aksesuar zona te caktuara te pyllit etj.</p> <p>Në Darëzezë, si rrjedhojë e incidencës së lartë të zjarreve, propozohet stacionimi i një mjeti zjarrfikës në periudhën e thatësirës.</p> <p>Gjithashtu, shprehet një interes i madh për formimin dhe trajnimin e grupeve vullnetare për komunitetin. Përfaqësues nga Kryqi i Kuq shprehen se ata e kanë të formëzuar grupin e tyre të vullnetarëve, por nuk mundën ti trajnojnë për raste zjarri apo përmbytje, prandaj duhet një metodologji e unifikuar për trajnimin e vullnetarëve, në bashkëpunim me sektorin e zjarrfikësve.</p>
<p>Nr. i pjesëmarrësve</p>	<p>Pjesëmarrës:</p> <p>Nëse ka përfaqësues të organizatave të ndryshme apo institucione publike të çfarëdolloj duhet të përmenden specifikisht.</p> <p>Përfaqësues nga Bashkia: 25 Përfaqësues nga Prefektura Fier 1 Përfaqësues nga organizata/institucione 6 MetroPOLIS/Co-PLAN, 1 UNDP, 2 AKMC</p> <p>Te pranishëm total 35 Femra pjesëmarrëse – 7 Meshkuj pjesëmarrës – 28</p>

Aneks 4 – Pyetësor për validimin e të dhënave në bashki

Projekti: Hartimi i Strategjive Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planeve të Veprimit për 6-të Bashkitë e Qarkut Fier.

Ky projekt zbatohet nga konsorciumi MetroPOLIS/Co-PLAN dhe financohet nga UNDP në kuadër të projektit: “Forcimi i aftësisë ripërtëritëse në Shqipëri” RESEAL i cili mbështetet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Projekti RESEAL financohet nga Qeveria Suedeze dhe ajo Portugeze.

Ky pyetësor ka për qëllim përfitim të informacionit lidhur me strukturën, operimin, financimin e Emergjencave Civile në këtë Bashki. Të dhënat e përfuara prej këtij pyetësori do të përdoren vetëm për qëllime analitike në kuadër të këtij projekti. Faleminderit paraprakisht për bashkëpunimin tuaj!

Pyetësor

Struktura e mbrojtjes civile në Bashki.			
1	A ka një strukturë për mbrojtjen civile në bashkinë tuaj?	Po	Jo
2	Nëse po, a është ajo një drejtori/sector i veçantë apo është e përfshirë në një nga sektorët e tjerë të bashkisë?		
3	Sa persona punojnë në këtë drejtori/sector dhe si është e organizuar ajo nga pikëpamja hierarkike?		
4	Çfarë formimi akademik, profesional kanë punonjësit të cilët punojnë në këtë drejtori/sector.		
5	A kanë punonjësit përshkrime pune?	Po	Jo
6	A angazhohen punonjësit e kësaj drejtorie/sectori edhe në punë të tjera në bashki?	Po	Jo
8	A ka në bashkinë tuaj një Qendër Operacionale të Emergjencave Civile?	Po	Jo

9	Nëse po, sa persona punojnë në të dhe cilat janë mjetet që përdorin.		

81

Mjete			
1	A keni një zyrë në bashki?	Po	Jo

2	A keni mjetet e nevojshme për të zhvilluar detyrat tuaja të tilla si: tavolina pune, kompjuter, pajisje kancelarie, etj.?	Po	Jo
---	---	----	----

3	A keni mjete (motorike) për të kryer vizita në terren në rast emergjencash? Nëse po, listoni tipologjinë dhe numrin.	Po	Jo
---	--	----	----

4	A keni ju si drejtori/sector mjete të tilla si ekskavator, fadroma, makina transporti të cilat mund ti përdorni në rast fatkeqësie? Nëse po, specifikojeni.	Po	Jo
---	---	----	----

5	A bëni ju një përditësim të inventarit të logjistikës së transportit përfshi këtu edhe një vlerësim të gjendjes?	Po	Jo
---	--	----	----

6	Nëse po, sa shpesh e bëni këtë inventar?		
---	--	--	--

Formimi dhe trajnime

1	A keni kryer trajnime lidhur me fatkeqësitë natyrore?	Po	Jo
---	---	----	----

2 Nëse po, ju lutem specifikoni kur dhe cila ka qenë tematika e trajnimeve.

3 A mund të listoni disa tema trajnimesh për të cilat do të kishit nevojë?
Legjislacion, GIS, vlerësimin e riskut, grumbullimin dhe lizimin e të ana dhënave, etj.

Dokumente në nivel lokal

1	Ka bashkia juaj një Plan për Emergjencat	Po	Jo
---	--	----	----

2	A ka bashkia juaj Plan Veprimesh Sezonal	Po	Jo
---	--	----	----

Financimi

1	A keni projekte te parashikuara ne PBA ne lidhje me ZRF?	Po	Jo
---	--	----	----

2	A keni projekte te parashikuara ne buxhetin vjetor ne lidhje me ZRF?	Po	Jo
---	--	----	----

3	Si e përdorni fondin e Mbrojtjes Civile?	Po	Jo
---	--	----	----

4	A keni kryer projekte /ndërhyrje nëpërmjet këtij fondi?	Po	Jo
---	---	----	----

5	A keni marrë grante nga donatorë në lidhje me MC?	Po	Jo
---	---	----	----

6	A keni marrë projekte me grante konkurruese nga Qeveria Shqiptare?	Po	Jo
---	--	----	----

Grumbullimi dhe përditësimi i të dhënave

1	A keni një bazë të dhënash lidhur me fatkeqësitë në vite?	Po	Jo
---	---	----	----

2	Nëse po, në çfarë formati është baza e të dhënave?		
---	--	--	--

--	--	--	--

3	Si i grumbulloni këto të dhëna? Me anë të një formati të standardizuar?		
---	---	--	--

--	--	--	--

4	Cilët janë persona apo institucionet përgjegjëse për grumbullimin dhe dërgimin e të dhënave?		
---	--	--	--

--	--	--	--

5	A përdorni aplikacionin GIS për të ruajtur dhe përpunuar të dhënat?		
---	---	--	--

--	--	--	--

Vullnetaret

1	A ka bashkia juaj një bazë të dhënash për persona, subjekte private të cilat mund të angazhohen në rast fatkeqësie?	Po	Jo
---	---	----	----

2	A janë këta persona/subjekte të trajnuar për tu angazhuar në rast emergjence ?	Po	Jo
---	--	----	----

3	Si kryhet lajmërimi i këtyre vullnetarëve?		

Kanalet e komunikimit ne rast emergjence (TV, Radio etj.)

Si bashkëpunoni me drejtori/sectorë të tjerë brenda bashkisë për ZRF? e cilat drejtori/sectorë bashkëpunoni më së shumti?

1	Si kryhet informimi i popullatës në rast fatkeqësisë?		
2	Përafërsisht sa ditë/orë para se të ndodhi ngjarja lajmërohen banorët?		
3	Me cilat institucione të tjera komunikoni në nivel Qarku apo Bashkie në rast emergjencash?		
4	Cilat janë kanalet e komunikimit të cilat përdorni për tu vendosur në kontakt me institucionet e sipërpërmendura?		

Sistemi i paralajmërimit te hershëm

1	A ka bashkia juaj një sistem të paralajmërimit të hershëm në rast fatkeqësish?	Po	Jo
---	--	----	----

2	Cili është sistemi që përdorni?
Për 3	cilat nga rreziqet funksionon kryesisht sistemi i paralajmërimit të hershëm?

Aneks 5- Kuadri- Ligjor

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen drejtpërsëdrejti me mbrojtjen civile:

- VKM 807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile"
- Ligji Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"
- VKM nr. 747, Datë 20.11.2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile".
- VKM nr. 431, Datë 15.07.2021, "Për përbërjen dhe detyrat e njësive organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e mbrojtjes civile në ministritë e linjës".
- VKM nr. 1162, Datë 24.12.2020, "Për përcaktimin E procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi".
- VKM nr. 923, Datë 25.11.2020, "Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstucional të institucioneve dhe të strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile".
- VKM nr. 1186, datë 24.12.2020, "Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit".
- Udhëzim i Ministrit të Brendshëm nr. 81, datë 6.3.2020, – "Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e certifikatës së sigurisë nga zjarri".
- VKM nr. 168, datë 24.3.2023, "Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror", (Fletore Zyrtare nr.51/2023)".
- VKM nr. 94, datë 22.2.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe planit të veprimit", (Fletore Zyrtare nr.31, 24.02.2023).
- VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 "për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive"
- VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

- VKM Nr. 414 datë 8.7.2021 'Për Miratimin e Procedurave dhe Krieteve të Ndarjes dhe të Përdorimit të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile'
- VKM Nr. 290 datë 17.5.2023 'Për një Ndryshim në Vendimin Nr. 414, Datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Procedurave dhe Krieteve të Ndarjes dhe të Përdorimit të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile'
- VKM Nr. 2060 datë 27.4.2023 'Për Miratimin e Projekteve Fituese të Financuara nga Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, si dhe të Autoritetit Kontraktor për Zbatimin e Projekteve, Sipas Njësive të Vetëqeverisjes Vendore'
- Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore" miratuar me Ligjin Nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".
- Vendimi nr. 158, datë 17.03.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e krieteve dhe të procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore".
- Vendimi nr. 775, datë 15.12.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive".
- Vendimi nr. 667, datë 10.11.2021 i Këshillit të Ministrave "Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive"

- Vendimi nr. 345, datë 26.05.2022 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”.

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me ndryshimet klimatike:

- Ligj nr. 75/2016, Datë 14.07.2016, Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit në kuadër të konventës së Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimaterike;
- Ligj Nr. 155/2020 "Për ndryshimet Klimaterike" Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me qeverisjen:
- Ligji nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin 107/2016 “Për prefektin e qarkut”
- Ligji nr.139 / 2015 Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 84/2022 ‘Për buxhetin e vitit 2023’, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024"
- Udhëzim Nr. 35 datë 29.12.2022 ‘Për Procedurat Standarde të Raportimit dhe Monitorimit të Risqeve Fiskale nga Njësitet e Qeverisjes së Përgjithshme dhe Njësi të Tjera të Sektorit Publik’
- Akt Normativ Nr. 1, datë 21.2.2024 Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2023, “për buxhetin e vitit 2024”

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me planifikimin e territorit:

- Ligj nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar
- Ligji Nr. 9290, dt. 7.10.2004 “Për Produktet e ndërtimit” i ndryshuar me Ligjin nr.9825, datë 1.11.2007 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”
- VKM nr. 881, datë 14.12.2016, “Për miratimin e planit të përgjithshëm kombëtar të territorit”. Fletore Zyrtare nr. 248, datë 23.12.2016.
- VKM Nr. 796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar
- VKM Nr. 232 date 17.04.2019 "Pe disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me energjinë dhe burimet natyrore:

- Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”.

- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.
- Ligj nr. 116/2013 datë 15.04.2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP).”
- Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
- Ligj Nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”
- Ligj Nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”
- Ligj Nr. 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme”
- V.K.M. nr. 477, datë 16.7.2004 “Për miratimin e Marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos Marinzë”.
- VKM nr. 410, datë 13.5.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”. Fletore Zyrtare nr. 137, datë 01.09.2015.
- VKM Nr. 480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030”. Fletore Zyrtare nr. 119, datë 9.08.2018.
- VKM nr. 87, datë 14.2.2018, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Fletore Zyrtare Nr. 23, datë 20.02.2018.
- Urdhër i Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nr. 148, datë 20.4.1999, “Për Kushtet dhe Normat Teknike, që duhen respektuar në impiantet dhe instalimet e tregimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me mjedisin:

- Ligji, 91/2013, dt. 28/02/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
- Ligji Nr. 57/2020 “Për Pyjet” (i riu)

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore:

- Ligji Nr. 111/2012, Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar.
- Ligji nr.24/2017 ”Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”
- Ligj Nr.8102, datë 28.3.1996 Për Kuadrin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura; i azhurnuar me: Ligjin nr.9352, datë 03.03.2005; Ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 (i ndryshuar me ligjin nr.9845, datë 17.12.2007); Ligjin nr.9915, datë 12.05.2008

- VKM nr. 147, Datë 18.03.2004, "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave".
- VKM Nr. 431, datë 11.7.2018 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me infrastrukturën e transportit:

- Ligji nr.8378, datë 22.7.1998 i Kodit Rrugor Të Republikës Së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.10 488
- VKM nr. 811, datë 16.11.2016, "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe planit të veprimit 2016 – 2020". Fletore zyrtare Nr. 220, datë 25 nëntor 2016.
- Vendimi nr. 53, datë 1.02.2023 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me infrastrukturën e informacionit:

- Ligji Nr. 72/2012 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".
- VKM Nr. 1034, Datë 24-12-2020, "Për miratimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planin e veprimit 2020-2025".
- VKM nr. 553, datë 15.7.2020, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit".
- VKM nr. 148, datë 24.02.2016 "Për ngritjen dhe funksionimin e Sistemit të Integruar të Informacionit dhe Statistikës së Këshillit të Ministrave"

Ligje dhe akte nënligjore që lidhen me sektorë të tjerë, relevante edhe për çështje të ZRF:

- Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social"
- Ligj Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"
- Ligji nr.9244 datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar

Aneks 6- Kuadri Institucional

Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Zhvillimit të Territorit, 2015 - 2030 (PPK) – është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke parë territorin shqiptar si një të tërë. Duke pasur këtë dokument si referencë hartohen edhe planet sektoriale, planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare, zhvillimit rajonal dhe planet e përgjithshme vendore. PPK ofron kornizën strategjike referuese për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, me qëllim sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të vendit, menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit. duke siguruar njëkohësisht edhe përdorimin racional të tokës. Sa i përket Bashkisë Fier, ai është pjesë e polit të zhvillimit rajonal Vlorë-Fier-Berat, ku Fieri evidentohet si një qendër primare urbane në të cilat mund të përqendrohen funksione me rëndësi primare të kujdesit shëndetësor, arsimore dhe zhvillimit ekonomik e social. Ndër potencialet kryesore të këtij poli përmendet fusha e Myzeqesë, porti i Vlorës, Laguna e Nartës, vija bregdetare, kalimi i akseve kryesore rrugore e hekurudhore në vend si dhe kalimi i Trans Adriatik Pipeline (TAP) dhe Ionian Adriatik Pipeline (IAP).

Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar 2016 – është dokumenti i cili shoqëron PKK. Ky dokument është instrumenti kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe ato të zhvillimit të qëndrueshëm në procesin e planifikimit strategjik si dhe në vendim-marrje. VSM është dokumenti i cili siguron që konsideratat mjedisore të merren në konsideratë gjatë vendim-marrjes në nivel qendror, rajonal e lokal duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe në respekt me mjedisin duke marrë në konsideratë tendencat mjedisore, efektet që politika, plane, projekte të ndryshme mund të kenë në mjedis dhe propozuar masa për të shmangur, zvogëluar, apo zbutur efektet negative në mjedis dhe burimet natyrore.

Dokumenti i Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020 – 2035, (Dokumenti i Politikave Strategjike) – është dokumenti kryesor i planifikimit, i cili rregullon menaxhimin e mbetjeve bashkiake, jo bashkiake dhe të rrezikshme. Dokumenti i Politikave Strategjike merr në konsideratë zhvillimet e planifikimit dhe infrastrukturës në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe përfshirjen e bizneseve private. Dokumenti është zhvilluar mbi vizionin ose perceptimin e konceptit “zero mbetje”, në mënyrë që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë e parë dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin dhe parimet e sistemit të ekonomisë qarkulluese për të mundësuar mbrojtjen sa më të plotë të burimeve natyrore dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të produkteve.

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta⁴ - përfaqëson dokumentin e nivelit të dytë të planifikimit në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, i cili përcakton kuadrin e planifikimit në lidhje me investimet infrastrukturore kombëtare, rajonale dhe vendore. Dokumenti për çështje menaxhimi të mbetjeve e ndan vendin në 10 zona mbetjesh, ku Qarku i Fierit konsiderohet si një zonë mbetjesh, dhe parashikon potencialisht zona specifike për secilën bashki në të cilën mund të zhvillohet infrastruktura e menaxhimit të mbetjeve (incenerator , landfill-e, stacione transferimi etj.).

Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, SKMIBU 2017-2027 miratuar me VKM Nr. 73, datë 7.2.2018 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027” – është dokumenti i cili do të shërbejë si udhëzues për politikat për ujën, dhe të nxisë zhvillime operationale dhe investime ndërmjet të gjithë sektorëve brenda një afati kohor 10 vjeçar. Kjo strategji zhvillohet në përputhje me legjislacionin vendas dhe atë evropian në sektorin e ujit dhe bazohet në ² shtylla strategjike: ‘uji për njerëzit’, ‘ujë për ushqim’, ‘ujë për industrinë’ dhe ‘ujë për mjedisin’. Me qëllim menaxhimit të ujit, Strategjia e Ujit e ndan vendin në 8 basene ujore kryesore, ku Qarku i Fierit bën pjesë në Basenin Lumor të Semanit. Sa i përket rreziqeve që mund të shkaktohen nga uji objektivi strategjik nr. 3 i Strategjisë së Ujit parashikon disa element kryesorë të cilët janë: a) menaxhimi i katastrofave natyrore në vend; b) sigurimi i mbrojtjes nga përmytjet; c) përgatitja për përballje me thatësitat dhe kufizimet e ujit; d) plane kontrolli dhe masa për përballjen me ndryshimet klimatike. Këto element duhet të merren në konsideratë në kuadër të hartimit të strategjive apo planeve të veprimit në kuadër të ZRF.

Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018 - 2030³ - është një dokument paraqet një qasje të integruar për zhvillimin e sektorit të ujit me synim orientimin e investimeve drejt objektivave kombëtarë, përmirësimin e procesit të planifikimit, rritjen e investimeve dhe të ardhurave në sektor, monitorimin e burimeve si dhe mbrojtjen e ekuilibrave mjedisorë. Ky program bëhet i zbatueshëm nëpërmjet planeve të veprimit të cilët përditësohen çdo tre vite dhe përfshijnë masa e aktivitete të cilat propozohen nga aktorët kryesorë në sektor. Ky program i ndan burimet ujore dhe infrastrukturën nga pikëpamja e përdorimit, impaktit të shkaktuar dhe atij të pësuar në tre shtylla kryesore: a) përdorimi i ujit; b) mbrojtja e ujit; c) mbrojtja nga uji, ku fokus të veçantë marrin monitorimi i ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, liqeneve, vijës bregdetare të lidhura këto me ndotjen, erozionin, sigurinë e digave etj.

Strategjia e Ujitjes dhe Kullimit 2019–2031 dhe të planit të veprimit miratuar me VKM nr. Nr. 345, datë 22.5.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të ujitjes dhe kullimit” është një dokument i hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dha ka për qëllim evidentimin e situatës sa i përket sistemit të ujitjes dhe kullimit, digave dhe rezervuarëve për mbrojtjen nga përmytje. Strategjia synon optimizimin e investimeve në ujitje, kullim dhe mbrojtjen

² <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/PLANI-KOMBETAR-SEKTORIAL-PER-MENAXHIMIN-EMBETJEVE-TE-NGURTA.pdf>

³ <http://ambu.gov.al/public/PROGRAMI%20KOMB%20SEKTORIAL%20I%20UJIT%202018-2030.pdf>

nga përmbytjet me qëllim zgjerimin dhe bërjen të qëndrueshme të sistemeve të ujitjes, përmbytjet e nevojave për kullim dhe mbrojtjen e popullsisë dhe pronave nga përmbytjet.

Strategjia Kombëtare e Strehimit Social, 2016-2025 - qëllimi i strategjisë është përmirësimi i kushteve të jetesës të 25,000 familjeve shqiptare me të ardhura të ulëta dhe të mesme, që nuk mund të përballojnë një shtëpi në treg të lirë përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm. Strategjia e strehimit social i adreson këto çështje nëpërmjet 6-të programe të strehimit social: Programi i Banesave Sociale me Qira (BSQ); Programi për përmirësimin e kushteve të banesave deri në një ndërtim të ri (PPKB); Programi i banesave me kosto të ulët (BKU); Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi; Programi për krijimin e strehëve të përkohshme; Programi për ndërtimin e banesave të specializuara. Në kuadër të ZRF-së, programet më të rëndësishme janë PPKB-ja i cili mundëson ndërhyrje në strukturë për të përmirësuar cilësinë e saj duke e bërë objektin më të qëndrueshëm ndaj fatkeqësive dhe programi i strehëve të përkohshme që mundëson strehimin e familjeve që kanë mbetur pa strehë në rast fatkeqësie për një periudhë maksimalisht 2-vjeçare.

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimtë është hartuar për të mbështetur zbatimin e legjislationit të BE-së për mjedisin dhe klimën, duke synuar përfundimin e koordinimit ndërsektorial në Shqipëri për masat mbi klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky dokument ka një qasje ndër-sektoriale dhe synon të përmbledh pikësynimet dhe objektivat politike të fokusuar të zbutja e efektit të ndryshimeve klimatike të parashikuara në planet dhe strategjitë ekzistuese. Strategjia fokusohet në 4 sektorë kryesorë: a) energjia me fokus kryesor b) transportin, c) bujqësia, d) ndryshimet e përdorimit të tokës dhe pylltarinë të cilët janë edhe baza e raportimeve për inventarin e gazrave serrë në Shqipëri. Me përfshirjen e këtyre sektorëve mbulohet rreth 80% e shkarkimeve të Shqipërisë.

Vizioni kombëtar i strategjisë fokusohet në 3 komponent kryesorë të ndryshimit të klimës: masat zbutëse, adaptimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, ku janë identifikuar edhe 6 përparësi të strategjisë së masave zbutëse:

- SP.1 Sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë;
- SP.2 Ngritja e një sistemi monitorues, raportues dhe verifikues të GES-it;
- SP.3 Forcimi i kapacitetit të institucioneve përkatëse dhe bashkëpunimit ndërinstitucional;
- SP.4 Përmirësimi i ndryshimeve klimatike në planifikimin strategjik sektorial;
- SP.5 Forcimi i kapacitetit dhe ndërgjegjësimi mbi çështjet e ndryshimeve klimatike;
- SP.6 Afrimi me kuadrin ligjor të BE-së për ndryshimin e klimës në të gjithë sektorët.

Plani Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Energjinë dhe Klimën 2021-2030 (Draft) - bazohet te Strategjia Kombëtare e Energjisë dhe te Kontributi i Dakordësuar Kombëtar (NDC-të) e para dhe është harmonizuar me draftin e NDC-ve të rishikuara. Strategjia adreson pesë dimensionet e Unionit të Energjisë: siguria e energjisë; tregu i brendshëm i energjisë; eficienta e energjisë; dekarbonizimi; kërkimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria. Për dimensionin e dekarbonizimit synohet minimizimi i shkarkimeve të gazeve të efektit serrë (GES) dhe rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme. Në kontekstin e eficientës energjetike synohet të përmbushen standardet e BE-së (të paktën 32.5% deri në 2030), bazuar në konsumin primar ose final të energjisë, konsolidimi i kuadrit legjislativ për eficientën energjetike, hartimi i strategjisë së rinovimit të stokut të ndërtesave, me objektivin e përgjithshëm rinovimi i 2% të stokut të ndërtesave çdo vit. Për dimensionin e sigurisë energjetike objektivi kryesor është garantimi i një furnizimi afatgjatë,

⁶ https://turizmi.gov.al/ep-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor2019_-1.pdf
Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

të sigurt dhe cilësor për të gjitha sistemet e prodhimit dhe furnizimit të energjisë. Parashikohet nxitja dhe diversifikimi i përshtatshëm i prodhimit të energjisë përmes investimeve të reja, përforcimin e bashkëpunimit dhe integritit rajonal dhe ndërlidhjen me rrjetet evropiane dhe rajonale të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me Acquis e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Përsa i përket dimensionit të kërkimit, inovacionit dhe konkurrueshmërisë, synon që shpenzimet vjetore publike për kërkim shkencor dhe inovacion të arrijnë në total 2% të PBB-së çdo vit.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, SKZHIE III, 2021 -2030 miratuar me VKM Nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian 2022–2030” është dokumenti kryesor strategjik i cili drejton përparësitë e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit duke i hapur rrugën integritit të vendit në Bashkimin Evropian duke e ndërlidhur atë gjithashtu me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Nga ana tjetër ky dokument pararend miratimin e fondeve vjetore të buxhetit të shtetit, duke përcaktuar objektivat e politikave, që përfshihen në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit nga të gjitha institucionet shtetërore. Ky dokument i shërben të gjithë partnerëve ndërkombëtarë të cilët mbështesin vendin në proceset e integritit në BE.

Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar PINs Bregdeti 2015 – 2030 është dokumenti kryesor i planifikimit sa i përket Brezit të Bregdetit dhe shërben për të orientuar hartimin e dokumenteve të tjerë të planifikimit për zonat bregdetare. Dokumenti vendos theksin e trajtimit të zonës bregdetare si një binom det-tokë me fokus menaxhimin e harmonizuar të nevojës për zhvillim dhe nevojave lokale duke mbrojtur asetet kulturore, historike e natyrore për ta kthyer atë në një destinacion turistik. Sa i përket Bashkisë Fier në këtë dokument përmendet se kjo bashki rrezikohet nga përmytjet si pasojë e Lumenjve Seman e Vjosë si dhe nga depërtimi i ujit të detit në tokat bujqësore dhe erozioni detar elementë të cilët duhet të kihen parasysh për ZRF.

Plani Përfundimtar i Menaxhimit për Basenin Ujor Seman Qershor 2019⁷ - ka për qëllim identifikimin e një sërë masash për përmirësimin e menaxhimit dhe përdorimit të burimeve ujore të lidhura me Basenin e Lumit Seman duke zhvilluar analizuar gjendjen fizike të burimeve ujore, inventarizimin e burimeve, përdorimin e ujit, identifikimin e sfidave kryesore të lidhura këto edhe në kushtet e ndryshimeve klimatike. Një ndër elementët kryesorë të planit të lidhur edhe me Strategjinë Vendore ZRF është edhe plani i masave të parashikuara në këtë dokument për të parandaluar përmbytjet potenciale, përdorimin e mirë të ujit, monitorimin e vazhdueshëm si dhe sinjalizimin e hershëm në rast rreziku element të cilët duhet të merren në konsideratë nga institucionet përgjegjëse të parashikuara edhe në dokument.

Komunikimi i Katërt Kombëtar i Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike, Shtator 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit⁸ (The Fourth National Communication of Albania on Climate Change, September 2022, Ministry of Tourism and Environment) – është një dokument i hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet Klimatike si një detyrim i Marrëveshjes së Parisit. Ky dokument jep një panoramë të përgjithshme të vendit lidhur me sektorët të cilët emetojnë më shumë gaze serrë në vend e nga ana tjetër jep indicie për impaktin që do të kenë ndryshimet klimatike në vendin tonë në temperaturat mesatare vjetore, intensitetin dhe frekuencën e reshjeve, përparimin e detit, presionin ndaj burimeve ujore etj. Ky dokument shërben për të kuptuar situatën aktuale në vend lidhur me ndryshimet klimatike dhe impaktin që ato kanë mbi burimet natyrore dhe gjithashtu jep të dhëna mbi impaktin që do të kenë në vitet e ardhshme duke sugjeruar masa potenciale për të parandaluar apo adaptuar efekteve të ndryshimeve klimatike.

⁷ http://ambu.gov.al/public/Semani%20Final%20RBMP_Final_Albania_June2019.pdf

⁸ <https://www.undp.org/albania/publications/fourth-national-communication-albania-climate-change>
Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

Aneks 7 – Strukturë/Raport Monitorimi

(Strukturë) Raport Monitorimi

Kapitulli 1- Hyrje

Ky kapitull shërben si hyrje për raportin e monitorimit. Në këtë kapitull përshkruhen shkurtimisht sa më poshtë:

- 1- Kush e ka hartuar raportin dhe kujt i drejtohet ky raport;
- 2- Cila është periudha e raportimit;
- 3- Cilat kanë qenë ngjarjet kryesore (fatkeqësi) në territorin e bashkisë;
- 4- Struktura e raportit.

Kapitulli 2 – Zbatimi i Strategjisë

Fillimisht, në këtë kapitull jepet një përshkrim i shkurtër narrativ në lidhje me masat dhe projektet që bashkia ka zbatuar gjatë periudhës së raportimit. Në këtë përshkrim mund të përfshihen dhe nisma ose aplikime që bashkia ka kryer për projekte të ndryshme por që mund të mos kenë rezultuar të suksesshme ose që janë ende në proces vlerësimi. Gjithashtu, mund të përshkruhen projekte apo masa të cilat janë në vazhdimësi. Pas përshkrimit narrativ, plotësohet tabela e mëposhtme:

Objektivi Strategjik	Projekti Strategjik	Masa	Statusi i Zbatimit	Tregues Monitorimi
OS1	PS1	MS1	- Zbatuar - Në Zbatim - Nuk ka filluar Vendos statusin e zbatimit	

Kapitulli 3- Zvogëlimi i Riskut

Në këtë kapitull përshkruhet impakti që ka pasur zbatimi i strategjisë në zvogëlimin e riskut. Pas një përshkrimi narrativ të shkurtër ku përshkruhet impakti i masave të ndërmarra plotësohet tabela e treguesve të mëposhtëm të monitorimit.

Treguesi	Vlera në vitin paraardhës	Vlera Aktuale

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2024-2030

Kapitulli 4 – Konkluzione dhe Rekomandime

Në këtë kapitull shënohen arritjet kryesore gjatë vitit të monitorimit si dhe mangësitë. Hartuesit e raportit përtej evidentimit të arritjeve duhet edhe të shpjegojnë:

- cilat kanë qenë vështirësitë në zbatimin e strategjisë;
- cilat procese kanë hasur vështirësi;
- cilat kanë qenë mësimet e nxjerra (pozitive dhe negative);
- cilat janë rekomandimet për përmirësimin e zbatimit të strategjisë apo zvogëlimit të riskut.

